

BASHKIM SHEHU:

Rënia e interesit për leximin nuk vjen nga zhvillimi i kinematografisë, por nga komercializimi i kulturës, i shndërrimit të saj në spektakël zbavitjeje

Bisedoi Ardit Mehmetaj

HELENISTI GJON SHLLAKU, SIÇ E KAM NJOHUR

Nga Xhahid Bushati

(fq. 3)

SHËNIME MBI LIBRAT

Vëzhgime kritike mbi romanin e Mira Meksit
"Puthja e Amazonës"

DIMENSIONET METAFORIKE TË NJË ROMANI

Nga Vladimir Muça

(fq. 4)

Ismail Kadare, "Sorkadhet e trembura"

DRAMA LINDORE E MIQËSISË PERANDORAKE

Nga Kosta Nike

(fq. 13)

Shënime për romanin e Namik Dokles "Vajzat e
mjegullës", botuar në Spanjë

TREGIMI I FILLESËS DHE KUPTIMI I BOTËS QË E RRETHON

Nga Emilio Sola

(fq. 10)

Shënime për romanin "BU - Si nuk u bëra anëtar
i Bibliotekës Universale" të Virgjil Muçit

MAKTHI I PRITJES SË PAFUNDME

Nga Namir Lapardhaja

(fq. 11)



Luran Osmani, autori i grafikës

Në një çast meditimi te shtatorja e Skënderbeut në Shkup, lindi kjo grafikë

Bisedoi Nurie Emrullai

Artisti ka rol kyç në shoqëri sepse atij i duhet të mbajë gjallë kujtesën historike. Përcjellja e vlerave kombëtare duhet të jetë dhe interesi kryesor në ditët e sotme. Ndonëse arti merr suaza të ndryshme, në varësi të vendit që krijohet, ne si shqiptarë duhet të jemi me këmbë në tokë, të vetëdijshëm për historinë që përfaqësojmë.

(fq. 14)



"PINOKU" ORIGINAL ËSHTË NJË HISTORI RADIKALE KUNDËR PUNËS

Nga Alessandro Delfanti

(fq. 22)

Këto ditë u nda nga jeta në moshën 95-vjeçare

ylli i kinemasë italiane dhe botërore

NJË GËNJESHTËR E BARDHË ME XHINA LOLOBRIXHIDËN

Nga Piro Milkani

(fq. 20)



BIBLIOTEKË

Charles Simic

(fq. 18)

Dyndja e Reve

(Përktheu Gëzim Basha)

Istref Haxhillari

(fq. 6)

Enigma

Granit Zela

(fq. 12)

Guaska

Irena Dragoti

(fq. 17)

Stina e pestë

Enver Kushi

(fq. 16)

Letrat

Mehmet Elezi

(fq. 15)

Kthimi i gjeneralit

Impresione nga një shfaqje e tragjedisë "Makbeth"

TROKITJET NË DERË...

Ese nga Rudolf Marku

(fq. 21)

ROSKOVECI -

LIRIKA E SHPIRTIT

Reportazh nga Xhevair Lleshi

(fq. 8)

BASHKIM SHEHU:

Rënia e interesit për leximin nuk vjen nga zhvillimi i kinematografisë, por nga komercializimi i kulturës, i shndërrimit të saj në spektakël zbavitjeje

Bisedoi Ardit Mehmetaj



në disa kujtime, është bazuar gjerësisht në dokumente arkivore, por nuk është vepër letrare, është një refleksion mbi politikën, mbi totalitarizmin, me një përpjekje argumentuese të konkluzioneve analitike.

A.M.: Mario Vargas Llosa kur e interviston Gabriel García Márquez-in, pyetjen e parë që ia bën është “Për çfarë, sipas teje, duhesh ti, si shkrimtar?”, sikur Llosa këtë pyetje t’ua bënte juve, cila do të ishte përgjigjja?

B.Sh.: Përgjigjja më e mirë, për mendimin tim, është ajo që ka dhënë para njëzet e tre shekujsh Aristoteli, se arti nuk i shërben asgjëje dhe se, njëkohësisht, është gjëja më e vyer. Do të shtoja, nga vetja, diçka edhe më arrogante: çështja nuk është se për çfarë duhem, po është se kështu dua, apo më saktë nuk mund të mos dua.

A.M.: Kishim dy vite të pandemisë Covid-19, ku thuajse në të gjithë botën karantinimi u bë i obligueshëm. Si e kaluat atë kohë karantinimi? Çfarë bënit?

B.Sh.: Këtu në Spanjë patëm 48 ditë karantinë, gati-gati arrest shtëpie. Gjatë asaj periudhe kam përkthyer, jam marrë me përgatitjen e një numri të një reviste kulturore online dhe gjithashtu konceptova romanin që jam duke shkruar tani.

A.M.: Cila është sfida e të qenit shkrimtar në ditët e sotme?

B.Sh.: Mendoj se njëra nga sfidat për shkrimtarin, dhe kryesorja, është ajo që ka qenë gjithmonë: të shkruajë mirë. Ndërkaq, ekzistojnë edhe sfida të tjera, më specifike, që ndryshojnë jo vetëm nga një kohë në tjetrën, po edhe nga një vend në tjetrin. Për vende si Shqipëria, apo si Spanja, si dhe për vende të ngjashme, është ajo e përballjes me komercializimin e theksuar të kulturës. Gjë që, në fund të fundit, lidhet me sfidën e përhershme, pra me cilësinë e të shkruarit.

A.M.: Shkrimtari katalunas Javier Cercas e ka një prirje të shkruajë romane pa fikson, tipar ky pak a shumë i njëjtë me mënyren tuaj të shkrimit. Nga buron dëshira për të shkruar romane pa fikson?

B.Sh.: Ato lloj tekstesh përbëjnë një pjesë të vogël në krijimtarinë time dhe kam njëzet vjet që nuk shkruaj të tilla. Në ato raste, ndodhitë reale i ngjajnë fiksonit: pikërisht kjo më shtyu që t’i shkruaja. Por kjo ngjashmëri shfaqet rrallë, ose shquhet rrallë, prandaj dhe u bë kohë që nuk shkruaj më të tilla. Ndërkohë, kam ndjekur një rrugë tjetër, paraqitjen e fiksonit si ndodhi reale, po gjithsesi duke vënë poshtë titullit fjalëzën “roman”, çka përbën licencën për të trilluar.

A.M.: Shumë nga veprat e juaja qëndrojnë mes të vërtetës dhe trillit. Të tilla janë “Vjeshta e ankthit”, “Loja, shembja e qiellit”, “Liri Belishova dhe koha e saj” e të tjera, ku ju bëni gërshetim mjaft të arrirë mes fact & fiction. Sa i ka shërbyer dhe sa i ka ndihmuar krijimtarisë suaj letrare dokumentariteti?

B.Sh.: Do të thosha se, në këtë prizëm, këta tre libra janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. “Vjeshta e ankthit” nuk është fikson, ose përmban disa fragmente fikcioni që janë qartazi dhe qëllimshëm të dallueshme si të tilla, kështu që, në tërësi, nuk është fikson. Po as është e bazuar në dokumente, bazohet vetëm në kujtesën time. Ndërsa “Loja, shembja e qiellit” është fikson. Vërtet, në dy kapituj, i referohet një ngjarjeje historike, siç është futja e armëve nga Sigurimi në kuvendin françeskan të Shkodrës, për çka jam bazuar në kujtimet e pater Zef Pllumit. Por kjo ngjarje historike, ndonëse e ruajtur në thelbin e saj, është plotësuar me detaje të trilluara dhe është e përfshirë në një kontekst ndodhish të trilluara, nëpërmjet një bashkëpajtimi të ndërsjelltë midis përmasës historike dhe fiksonit. Së fundi, “Liri Belishova dhe koha e saj”, përveçse



B.Sh.: Po, vazhdoj të kem kontakte me Kadarenë. Dhe Kadareja, natyrisht, nuk më mbajti mëri aspak për gjëra që thoshin dhe bënin të tjerë njerëz kundër tij, qoftë dhe kur njëri prej këtyre të tjerëve ishte im atë. Fajësimi i bijve për shkak të prindërve ka qenë kriter i atij sistemi, po Kadareja, në shpirt dhe në krijimtari, ka qenë kundër atij sistemi.

A.M.: Në veprën “Loja, shembja e qiellit”, një pjesë të rrëfimit e mbështesni tek historia e at Zef Pllumit. E njihnit Pllumin edhe para rënies së sistemit dhe a u takuat ndonjëherë pas rënies së sistemit?

B.Sh.: Jo, nuk e kam njohur. Mbas rënies së diktaturës, jo shumë kohë pasi dola nga burgu, jam përpjekur ta takoj. Kishim një mik të përbashkët, një bashkëvuajtës, dhe unë shkova një pasdite me mikun në kishën ku shërbente pater Zefi, që ishte në Tiranë. Po nuk e gjetëm aty, ishte në një udhëtim. Asokohe s’kisha dijeni për ato që ka shkruar pater Zefi për jetën e tij, por kisha një kureshtje intelektuale, ose ndoshta më të thellë, që të njihesha me një prift katolik.

A.M.: Petro Marko në librin e tij autobiografik “Intervistë me vetveten”, ndër shumë personazhet që trajton, e pranishme është edhe figura e Mehmet Shehut. Jeni takuar ndonjëherë me Petron? Nëse po, si ishte si person?

B.Sh.: Librin s’e kam lexuar, po me Petro Markon jam njohur. Më ka lënë përshtypjen se ishte njeri i mirë, njeri me dramë dhe njeri stoik.

A.M.: Kishte disidencë letrare në Shqipëri gjatë komunizmit?

B.Sh.: Po. As që mund të vihet në dyshim. Një diktaturë mund ta zhdukë disidencën letrare vetëm duke ndaluar çdo lloj letërsie, sikurse në Kamboxhën e Pol Potit apo në Afganistanin e talibanëve.

A.M.: Krijimtaria e juaj letrare direkt e indirekt lidhet me sistemin autoritar që ishte i pranishëm në Shqipëri. Sikur të ekzistojë në një vend e në një kohë tjetër, si mendoni që do të dukej vepra juaj?

B.Sh.: Nuk e di, sepse do të isha njeri tjetër, nuk do isha ky që jam.

A.M.: Përveç intervistave jo të pakta, keni shkruar edhe dy libra autobiografik për babain tuaj. Pra, e keni shkruar librin “Vjeshta e ankthit” dhe “Rrëfim nga një varr i zbrazët”. Nëse babai i juaj do t’i lexonte këto libra, cili mendoni se do të ishte gjykimi i tij për to e për ju në veçanti?

B.Sh.: Atë do dëshiroja të dija edhe unë.

A.M.: Cila ishte Kosova në kujtimet e babait tuaj? Ishte temë ndonjëherë?

B.Sh.: Aty nga vitit 1980, shikuam së bashku filmin “Kur pranvera vonohet”, të regjisorit Ekrem Kryeziu, bazuar në kujtimet e Fadil Hoxhës. Tim eti i pëlqeu filmi. E pyeta nëse fakti që bazohej në kutimet e Fadil Hoxhës mund ta pengonte shfaqjen e filmit në kinematë e Shqipërisë dhe më tha se nuk përbënte kurrfarë problemi, duke shtuar se Fadil Hoxha gjithmonë ka punuar për shqiptarët. Dhe, nuk më kujtohet, a në këtë rast apo më vonë, më tha se Kosova herët a vonë do bashkohet me Shqipërinë dhe s’ka rrugë tjetër. Ndërsa në vitin ’81 i ka pasur në qendër të vëmendjes protestat e Kosovës dhe i konsideronte të drejta në mënyrë absolute.



A.M.: Po kontaktet e juaja me Kosovën cilat ishin dhe janë? Sa e njihni produksionin letrar të Kosovës?

B.Sh.: Në kohën e autoizolimit të Shqipërisë, këto kontakte kanë qenë shumë të kufizuara: kam takuar disa nga figurat e fushës së letrave, Ali Aliun, Rexhep Ismailin, Ekrem Kryeziun, dhe herë pas here lexoja libra të botuar në Kosovë, kur më binin në dorë, gjë që nuk ndodhte shpesh. Nga botimet e atëhershme kosovare, konstatoja se te ju kishte më shumë liri krijimtarie dhe botimesh letrare sesa te ne. Me hapjen e Shqipërisë, kuptohet, dhe aq më tepër mbas çlirimit të Kosovës, kontaktet i kam pasur ku e ku më të dendura. Me botën letrare të Kosovës kam pasur lidhje të vazhdueshme bashkëpunimi, madje gjatë njëfarë kohe e kam pasur në Prishtinë botuesin e librave të mi. Dhe për krijimtarinë letrare të Kosovës mund të them se e njoh pak a shumë po aq sa atë të Shqipërisë.

A.M.: Po zhvillimin e letërsisë në Shqipëri që nga rënia e sistemit komunist e tutje si e shihni?

B.Sh.: Dy gjëra do të përmendja në veçanti: larminë, si dhe konvergimin përherë e më të spikatur me zhvillimet letrare të botë së madhe. Për këtë të dytën, do të thosha se, në fillimet e hapjes, kishte një prirje të theksuar eksperimentalizmi

letrar që në botën madhe është lënë pas prej dekadash. Por tashmë letërsia në Shqipëri po e kapërcen këtë gjendje, çka është një tregues pjekurie.

A.M.: Letërsisë shqipe i mungon Çmimi Nobel. A parashikoni që në një të ardhme të afërt ta gëzojë edhe letërsia jonë këtë çmim dhe cili mendon se është problemi që nuk e fituam deri sot?

B.Sh.: Do të thosha se Çmimit Nobel i mungon letërsia shqipe. Ndërkohë, letërsia shqipe, me autorin e saj më të shquar, Ismail Kadarenë, ka marrë çmime letrare ndërkombëtare që më duken më të rëndësishme se Nobeli. Për shembull Man Booker Prize, qysh në edicionin e parë, ose Çmimi “Princi i Asturias”. Dhe mendoj se janë më të rëndësishme duke pasur parasysh kandidatët e tjerë dhe fituesit e edicioneve të tjera. Ndërkaq, nuk e di cili mund të jetë problemi që nuk ka një fitues shqiptar të Çmimit Nobel për letërsi, ngase, duke pasur parasysh fituesit e këtij çmimi së paku në njëzet vjetët e fundit, nuk e kuptoj çfarë kriteresh ndiqen.

A.M.: Në Shqipëri çdo fundvit ndahen çmime e thujse asnjëherë ato nuk i fiton ndonjë autor nga Kosova. Për këtë, vitin e kaluar pati reaguar edhe studiuesi Rexhep Qosja duke thënë se “me emërtimin letërsi shqipe nuk mund të quhet vetëm letërsia e krijuar në Shqipëri por e gjithë letërsia shqipe e krijuar prej atyre që shkruajnë

shqip, pavarësisht ku jetojnë”. Bazuar në këtë, a mendoni që po e distancojnë Shqipëria letërsinë shqipe që bëhet në Kosovë dhe a po kontribuon në qëllimin e disave për krijimin e letërsisë kosovare?

B.Sh.: Letërsia shqipe është një, pavarësisht se ku krijohet. Kjo ka qenë gjithmonë teza e Kosovës letrare, ndërsa në Shqipëri, në kohën e komunizmit, kundërshtohet, çka shpjegohet me faktin se këto dy treva të letërsisë shqipe i ndante muri i zhdanovizmit të Tiranës. Po sigurisht që teza “një gjuhë, një letërsi” është e drejtë, aq më tepër në rastin shqiptar, përderisa themeli i identitetit tonë kombëtar, ose më mirë baza objektive e tij, është pikërisht gjuha. Po kështu, identitetin e letërsisë shqipe e përcakton gjuha. Ndërsa çmimeve letrare që ndahen s’duhet t’u jepet kaq rëndësi në këtë mes.

A.M.: Keni punuar për një kohë të gjatë edhe si skenarist, si e shihni raportin e letërsisë me filmin, si dhe paraqitja e zhvillimi i filmit a e kanë zbehur leximin e librit?

B.Sh.: Rënia e interesit për leximin nuk vjen nga zhvillimi i kinematografisë, por nga komercializimi i kulturës, i shndërrimit të saj në spektakël zbavitjeje.




A.M.: Përveç shkrimtar, jeni edhe përkthyes. Sot në vendet tona shqiptare përkthehet më shumë se kurrë, si i vlerësoni për nga cilësia përkthimet e kohës sonë?

B.Sh.: Sigurisht, gjejmë përkthime shumë të mira edhe sot, por janë gjithsesi të rralla. Pjesa më e madhe janë shumë të dobta, edhe kjo për shkak të komercializimit të kulturës, konkretisht për shkak të përparësive të një pjese të madhe të botuesve, të atyre që rendin mbas fitimit dhe e harrojnë cilësinë.

A.M.: Ju ka rënë të lexoni shumë autorë të huaj, por edhe vendorë. Ku qëndron arti ynë shqiptar në relacion me atë ballkanik, evropian e botëror?

B.Sh.: Në një pozicion dinjitoz.

A.M.: Jetoni në Barcelonë prej kohësh dhe besoj ju ka rënë të shihni mjaftueshëm se sa e si lexohet atje. Cila është kultura e leximit tek ne nëse e krahasojmë me kulturën e leximit në Evropë?



B.Sh.: Kam përshtypjen se janë të ngjashme. Dhe, po të nisemi nga shifrat, nëse këtu shitja e një libri arrin në 3000 ekzemplarë, libri konsiderohet i përligjur nga pikëpamja e tregtimit. Përpjesëtimisht me popullsinë, i bie që kuota në Shqipëri të jetë rreth 200 ekzemplarë dhe në Kosovë 150. Kjo tregon se kemi një bërthamë solide lexuesish. E kam fjalën për letërsinë serioze. Ndërsa për ata libra synimi i të cilëve nuk është cilësia letrare, por shitja, nuk e kam të qartë.

A.M.: Jeni autor i shumë librave, por a mund ta veçoni njërin nga to me të cilën do të doje të mbaheshe në mend?

B.Sh.: Do të doja të ishte ndonjë nga librat që ende s'i kam shkruar.

A.M.: Secili autor ndikohet nga dikush. Kjo mund të ndodhë qëllimshëm, por edhe në mënyrë të tërthortë e të pavetëdijshme. Nga intervistat tuaja e vërejmë një pëlqim që keni për Kafkën, Danilo Kishin e autorë të tjerë. Mund të jeni ndikuar me ose pa qëllim nga ta?

B.Sh.: Siç thoni ju, çdo autor ndikohet nga dikush. Ose, më mirë të themi, nga disa “dikushër”. Kjo sigurisht ndodh në mënyrë të vetvetishme, të paqëllimshme. I qëllimshëm nuk është ndikimi, po imitimi.

A.M.: Nietzsche thotë se e kemi artin që të mos vdesim nga e vërteta. Ç'është arti në tërësi e letërsia në veçanti për ju? Ikje nga realiteti i mundimshëm?

B.Sh.: Më mirë të themi, është shprehje refuzimi i të qenit heteronom. Por ky refuzim nuk është një ikje nga bota reale në një botë imagjinare: tekefundit, jemi dhe kemi qenë gjithmonë të ikur nga bota reale, jemi të huaj në këtë botë. Pikërisht kjo tëhuajtje, që ka si bashkudhëtare ngulmimin që të jemi në botën ku jetojmë, ndoshta përbën arsyen pse ekziston diçka e tillë si letërsia, sikurse forma të tjera, jo vetëm artistike, të imagjinatës në veprim: për të gjetur një kuptim ose një ngushëllim të qenies sonë në këtë botë, e cila nuk është bërë për njeriun dhe njeriu nuk është bërë për t'u ndier si në shtëpinë e tij në këtë botë.

A.M.: Për dallim nga koha e Nietzches që s'është e largët, studimet sot vlerësojnë se më shumë lexohet proza dokumentare e biografite e ndryshme, se sa veprat puro-fiksionale të mbushura me figura mitologjike e histori magjike. Si e shihni këtë fenomen?

B.Sh.: E shoh të lidhur me fenomenin e ndjekjes masive të programeve televizive me *reality show*. Mendoj se ky fenomen përbën formën vulgare të leximit të asaj lloj letërsie jofiksion për të cilën e keni fjalën, sikurse kjo e fundit përbën formën kulte të fenomenit që përmenda.

A.M.: Dhe për fund duam një këshillë nga ju për shkrimtarët e rinj, të cilët sot nuk janë pak...

B.Sh.: Të jepja këshilla në përgjithësi, më duket paternalizëm ndaj të rinjve. Do të parapëlqejja bisedën individuale, si koleg me kolegun, në të cilën mund të jepja ndonjë mendim duke u nisur nga ndonjë shkrim i tjetrit, në mënyrë të natyrshme dhe në përshtatje me rastin individual.

Vëzhgime kritike mbi romanin e Mira Meksit “Puthja e Amazonës”

DIMENSIONET METAFORIKE TË NJË ROMANI

Nga Vladimir Muça

“Lumturia u përket atyre
që mjaftojnë vetëveten”
ARISTOTELI

1. DIJE MITIKO-LIRIKE ME NJË STRUKTURË TË NGJESHUR

Indjellë nga disa kapituj të botuar në gazetën letrare “ExLibris”, në panairin e librit në Durrës 2022, ngulmova të gjeja nëpër stenda romanin e Mira Meksit “Puthja e Amazonës”. Me një ballinë intriguese, më së fundi e gjeta kopjen e fundit tek stenda “Onufri”, një institucion botues i cili qëmtan në shtapën e tij kulturore, vlerat nga më të mirat kombëtare e ndërkombeëtare.

Që në leximin e parë telegrafik, romani të josh me trillin fantastik e fantazinë, magjistrinë që rrjedh nëpër faqet e librit nga një varëse kamë e lashtë sa vetë etnia pellazge, nga ku si një përrua malor, rrjedh jetësimi mitologjiko-ilir, më një strukturë të ngjeshur romaneske.

Një stil i veçantë, do të thoja hispanik, me aranzhimin e figurave të shumta, në mbartësi me njëra-tjetrën, në një unison artistik. Vokabolari i përzgjedhur, pasurimi i fjalorit me neologjizma, fjalë të përbëra, plot harmoni dhe detaje të goditura përmes një loje të mitikës dhe të tashmes, ku lexuesi zbavitet dhe përfiton dije mitiko-historike, të sociologjisë së vet etnike, në substanca të ndryshme kohore.

Lexuesi rrugëton me personazhet, mes një atraksioni të një dramaciteti liriko-tragjik, mes jetës e vdekjes, mes reales e surreales, duke eksploruar ndërlidhjet mes dy botëve. Përmes detajeve jetësorë, autorja djalizon këto dy botë, njërin të nxjerrë nga zhguni mitik, tjetrën përftuar nga përjetimet dhe trilli romanesk.

Meksi loz bukur, me mençuri artistike, me këto dy botë, sa reale aq edhe mitike, fantastike, herë-herë edhe misterioze.

Në leximin e dytë, me pasionin që më ushqen romani “Puthja e Amazonës”, siç e kam bërë zakon në shumë libra, ngulmova me laps në dorë, anë fletëve të përqas disa dukuri të cilat i sillte ky roman, me arkeologjinë e tij letrare, në “drejtimin e ri letrar”, në kulturën e botës shqiptare të letrave.

Rrëfimi romanor, duke shtjelluar përmes një drame lirike, dashurinë e Teutës- Glaukia dhe Skerdit-Amorgesit, rrit dukshëm valencat e një kontradite shpirtërore, në absurdin moral të mosmbajtjes të betimit biblik, në shenjtërinë e një lidhjeje shpirtërore. Një përplasje e tërë ndjesishë dhe vizionesh, që nga zhgënjimi për dashurinë e premtuar, dëshpërimi, ulëritja shpirtërore, si në fundin e një bote ku covidit dhe indet patogjene, kanë mbërthyer si në një humbellë, dashurinë në tërë kompleksitetin e saj.

Në këtë betejë për jetën është Alefi dhe Kaméa me gurin e Agatës, të trashëguar brez pas brezi, si një diell jete, që vjen nga thellësia e shekujve, me kumtin e tyre jetësor, si realitete në themel të jetësimit njerëzor.

Dyaliteti Glaukia-Teuta dhe Amarges-Skerdi, do jenë filli me të cilin do thuret tunika romanore e “Puthja e Amazonës” ku “Harku i mbijetesës” do jetë vegla çudibërëse që artikulon dramacitetin liriko-tragjik.

Ky dyalitet do të hapërojë nëpër rrëfimin romanesk përmes një britme të zëshme shpirtërore, e cila në absurdin e sotëm të shpërbërjes së familjes nga epidemia e divorceve, britmon të çlirohet, të pastrohet nga vuajtjet dhe mëkatet që i ka sjellë ky absurditet shoqëror, të çlirohet nga frika e një nënshtrimi moral e shpirtëror për hir të ndjesive të larta dashurore.

Mira Meksi, përmes një fluide ankthi, rrëqethjeje të Glaukias për në malet e Kolkidasve, në kërkim të Amorgesit, në një udhëtim të pafund, sa real aq edhe irreal, në mitikën e saj, mes jetësimit dhe vdektarisë të dhuntimit trupor, gjen ndjesitë dhe emocionet më të larta njerëzore, ku dashuria e çiltërt, e thellë shpirtërore “nuk vdes, por vret”.

Gjithçka njehsohet me sentencën shekspiriane “të rrosh a të mos rrosh, kjo është çështja”. Rreth këtij qerthulli në filozofinë e jetës, endet Teuta në sallën e operacionit të klinikës “Saint Jean de Djer” të Parisit, nën efektin e narkozës, mes një bote mitike të përngjashme me të sajën, portat e së cilës i hapen nën dritësirën e gurit të Agatës, nën harkun e mbijetesës.

2. UNIFIKIM I ARTIT ROMANOR ME ARTIN POETIK

Qasja e letërsisë së sotme është drejt një unifikimi me artin poetik, si aftësi për të krijuar diçka më ndjenjësore, një buranë më inkandeshente, e cila buron nga subkoshienca njerëzore, duke strukturuar gjithçka universale jashtë unit tonë.

Qasja poetike nënkupton që krahas përzgjedhjes së gjuhës, mbarështrimit estetik të figuracionit dhe të një komunikimi me lexuesin, përmes një vokabolari, sa autentik, aq dhe të përveçëm në arealin përjetues.

Në artin shkrimor, duke folur me disa tipa njerëzorë, në mënyrë që në përbashkësi, arrijmë të krijojmë një prototip artistik, duke perceptuar diçka thelbësore mbi atë metafizike, duke arritur në një perceptim të plotësuar artistik: se gjithçka përbën letërsi, gjithçka mund të ketë frymë poetike, se sipas Aristotelit, veprimi poetik është gjithmonë veprim aktiv. Si sugjerim i një aranzhimi të tillë konkludon esteti i antikitetit: “Lumturia i përket atyre që mjaftojnë vetëveten”.

Në romanin “Puthja e Amazonës” lexuesi ndjehet këndshëm me pasazhet e një ligjërimi poetik. Gjithçka e stisur artistikisht, vjen si një dukuri e romanit modern, si një instrument gjuhësor, vegla e të cilit qëndron si një solfezh brenda rrëfimit, në rolin e një “organizmi” dytësorë, si një nëntekst në të gjithë vokabolarin autorial.

Hera herës, kjo gjuhë e zgjedhur poetike, ngrihet mbi çdo kompleksitet elementësh artistikë, siç janë metaforat, simboli, parabola, paralelizmi figurativ. Kjo bën që gjuha e romanit të jetë e ngritur mbi kapriatat e një figuracioni kompleks, shumëfunksional, të cilat në përmbajtje të rrëfimit përmbajnë në bërthamë gjuhën natyrale të përpunuar artistikisht.

Ky vokabolar i mbarështruar në rrëfimitarinë e romanit, në thelb është një risi e modernitetit bashkëkohor, mbështetur fortas në traditën e krijuar në fillimet letrare



të shekullit 20-të, si një model artistik globalistik.

Nga kjo madhështi e të thjeshtës prozatore, duke maturuar fenomenet e kumtet njerëzore gjer në detaje, del në pah dhe natyra e një drejtimi të ri letrar në të shprehurit hispanik: shkurt, thjesht mendimet në një vepër letrare.

Në këto koncepte, letërsia vjen para lexuesit dhe si një lojë e këndshme jetësore, ku lexuesi ndjen përjetime, kënaqësi shpirtërore, mbushet me aroma ndjenjash.

Në këtë aspekt, duke lexuar pasazhe të tilla si nocione të shumëfishta metaforike ku: “*Aulosi heshti, sepse nga disku i hënës zunë të rridhnin gjer poshtë tinguj të argjendte harpe, që ndillnin page shpirti*” “*gjersa një llavë vullkani shpërtheu fuqishëm nga vetja, duke përmbytur të dy pa shpëtim, duke e rrokullisur honeve pa emër të dëshirës*”.

Gjithçka vlerëson, jo vetëm mjeshttrinë artistike, teknikën narrative të shkrimtares Mira Meksi, por edhe subjektivitetin, mesazhet në të cilat lexuesi inspiron për një substanciale të dëshiruar shoqërore. Në këtë mënyrë, përmes një dramaciteti liriko-tragjik, romani i kryen më së miri funksionet qëllimore, duke paraprirë zhvillimet shoqërore në kompleksitetin familjar, duke e shtrirë si një paradigme të vetme funksionin dobiprurës dhe kënaqësinë e ndjesive, si bashkë ekzistencë.

3. PSIKO-TERAPEUTIKA E EKZISTENCIALIZMIT NË ROMAN

Romani “Puthja e Amazonës” në “drejtimin e ri letrar”, me inteligjencë, sjell përvoja dhe dije gjeneratore, në lidhje me “zgjimin”, shpirtëzimin e miteve dhe të legjendave, me autoktoninë e tyre. Autorja bën që ato të flasin në mënyrë drejtimore mbi kumte njerëzorë, në kontekste të problemeve të reja shoqërore, drejt për drejt, duke pikasur në thelbin e tyre. Ndaj ky gjenimerim shoqëror romani, reflekton një varg misionesh në shoqëri, duke shërbyer me qëllimin e formimit estetik, edukativ, shoqëror, qoftë në sensin pozitivist, qoftë në kuptimin negativist.

Si të gjithë letërsitë avangardë bashkëkohore, edhe këtë roman, me të drejtën time, mund ta quaj, si një njohje e një kumti sa të vjetër mitik, aq të ri në absurdin e sotëm jetësor, ku “dashuria kur nuk vdes, vret”.

Ekzistencializmi pas braktisjes së Teutës nga Skerdi, si shkak i shfaqjes së sëmundjes, përkundër tkurrjes, merr gjenimerim më të fortë shpirtërorë ku retorika : “*A është luftë kjo? – Nëse është luftë kundër sëmundjes, kundër vdekjes, atëherë gjymtimet në këtë luftë janë krenari*”.

Si deduksion psiko-analitik, shfaqet një ekzistencializëm i cili merr rëndësi përmes një psiko-terapeutike. Në këtë aspekt jetësor, duke letrarizuar konceptet frojdiste nën frymën Jung-ut dhe Lakant-it, autorja gjen fillin e mbijetesës ku Teuta: “*Të dëgjonte fjalët e tij të ngrohta, paskëtaj t'i qetohej zemra, të kremtonin jetën dhe dashurinë, të ulërinin në kupë të qiellit: “Në djall sëmundja dhe gjymtimi! Rroftë jeta!*”

Në nëntekst, autorja me dukuritë metaforike, fsheh në diskursin e saj letrar, një sentencë gjeniale, mbi jetën dhe familjen të

Viktor Hygoit ku: “Mjerë ai që ka dashur vetëm frymën, trupin dhe pamjen, vdekja ia rrëmben të gjitha. Dashuronit shpirtin se do ta rigjeni”.

Teuta e gjen këtë forcë dashurie tek clochardët, në kohën kur ata kishin marrë arratinë, si në birat e dheut nga mortja covid. Ajo (Teuta) “U krodh sërishmi në filmim e Hitchcock-ut, si në një realitet që tani ia kish huajtur Zoti, dhe vijoi lehtësisht vozitjen si një fluturim përmes tij, duke mos ja ndarë vështrimin që sipër taksisë së saj e cila udhëtonte rrugëve, shesheve dhe bulevardeve hënorë të Parisit”.

Një ekzistencializëm i qëmtuar artistikisht, përmes një kinematike të Hitchcock-ut e cila përqs lexuesin drejt një dramaciteti të egër shoëqror.

Paralelizmat figurativë, përdorur artistikisht si kundravers i gjendjes shpirtërore, në psiko-analizë, mpleksin historinë e tashme me mitikën, legjendaren, duke e rigjallëruar atë me ndjesitë njerëzore, duke e “ushqyer”prozën romanore me impute artistike.

4. KUR MITIKA NË SUBSTANCËN E SAJ PRESUPOZON REALITETE HISTORIKE

Metafora, herë si një shtjellë që vjen nga Andromedat e shekujve, dhe herë si një rrymim artistik, rrugëton në kapitujt e romanit duke shpërvjelë nëpër to dramacitete lirike. Kjo është një nga gjetjet më të bukura të autores, në arkeologjinë e saj letrare. Metafora është ai madem artistik, i cili i ka dhënë bukurinë e fiksionit rrëfimit romanor. Roli dhe konceptimi i tyre në lëmin realist-ekzistencial, merr një rëndësi të fuqishme në funksionin artistik, si një lëvizje njerëzore në kontekste të ndryshme kohore e shoqëore. Gjithçka përmes ringjalljes mitike, metafora vjen herë përmes një rrëfimi të thjesht jetësor dhe herë e veshur me tunikën poetike. Poetika e ndërthurur me këto kontekste vjen si risi e prozës moderne, e ngjeshur me një stilizim, veshur me lloje figuracionesh.

Në këtë konceptim metaforik, romani i vjen lexuesit me dukuritë e një stacioni mitiko-historik, në plazmën e të cilit dritëson Kamea me gurin e Agatës ku: gjithçka e trashëguar që nga mitika, nëpërmjet Alefit, ka ardhë në historinë e këtij vendi, definon autorja përmes El Grekos (tatuazhist) “si një mesazh mistik, fetar, magjik, një lloj armature mbrojtëse fizike dhe shpirtërore”.

Këtë ekzistencializëm tradishent, Mira Meksi e sjell që nga mitika, stërgjyshja, gjyshja, përmes medalionit të Alefit, si një trashëgimi e një kulture të lashtë Pellazgo-Ilire, e cila ruan me fanatizëm etno-kulturën brez pas brezi. Suporti rrëfimor, me sentenca të tilla si: “Merreni, hajeni, ky është trupi im! Merreni pijeni, ky është gjaku im!” të përfutuara nga librat e shenjtë, të cilat janë burimi i zanafillës së artit shkrimor, janë majaja e brumëzimit romenesk, ia shtojnë huret regjimitare romanit.

Mitet e sjella në kontekste të reja kohore, me gjenerimin e tyre artistik, vijnë si një dukuri e feminilitetit pentesilian, brenda së cilës fshihet një botë magjike, ku dhe në çastet më tragjike: “Në çastin kur shpata e Akilit hyri në krahërorin e bardhë të Pentesileas, Zotat mbajtën frymën. Afërdita doli vrik në breg që nga shkuma e detit dhe e padukshme për vdekatorët, nisi të afrohej. Po ato çaste dora e heroit nisi të dridhej; zemra përdesh i doli nga gjoksi dhe sytë iu verbuan nga bukuria e pashoqe e mbretëreshës së amazonave që po jepte shpirt”.

Me poliedrikën e saj, Mira Meksi me arkeologjinë letrare që i bën mitikës, depërton në mikrokozmosin shoqëror, duke “vjelur” nga andej gjithçka të trashëguar Pellazgo-Ilire. E natyralizon mitikën me anë të metaforës dhe të simbolit, duke u rrekur të na sjellë nga kjo thellësi shekullore, ide të bekuara të cilat mëkohen nën zhgunin e shekujve të etnisë, e cila u ka dhënë frymë dhe jetë miteve dhe legjendave.” –Legjendat thonë se burimi i gjakut tonë, përpara se të përzihej me atë të Hyut Ares, kanë qenë Pellazgoit”. “ – Harku i mbijetesës gjer në pafundësi të kohrave – Është mbijetesa e gjakut tonë, kohrave që do

të vijnë- plotësoi Otrere, gjyshja e Glaukias, nëna e Pentesileas”.

Në këto koncepte estetike, moderniteti borgesian e ai kafkian, përbashkohen me mitin e legjendat rrjedhshëm, pa palimpsestet e stilizimit modern, duke ardhë në kontekste të reja kohore si pjesë e zhvillimit kulturor, historik e social.

Nga një përqsaje e tillë estetike vjen dhe një dukuri e romanit, siç është trajtimi artistik i fiksionit dhe i realitetit përjetues, si një surreale drejt një realiteti të dëshiruar, si në aspektin metafizik dhe të botës shpirtërore.

Shembulli më bindës është se në ato çaste nga më të vështirat jetike, Teuta (Glaukia) me atë Alef: “ U ndje e fortë. Gjeti kthjelltësinë e mendjes, njohu shëmbëlltërynë e saj të tretur në muzgun e mijëra viteve të shkuara”.

Në funksion të plotë artistik, autorja si një suport, sjell pasazhin mitologjik, ku shpata e Akilit (bisturia e kirurgut) hyri në krahërorin e Pentesileas (gjirin e Teutës). Dyluftimi për jetën kish filluar si dikur. Akili në zjarrin e betejës nuk kish patur sy të shihte krijesën e madhërishe Amazonë me trupin e mbuluar me tatuazhin magjik ku: “...një vrujim përvëltonjës gjaku shpërthen nga kraharori i Pentesileas, duke përmblytur të dy luftëtarët, me një llavë dashurie vdekjeprurëse”.

Burimoren këto potenciale krijuese e kanë në kurajon hulumtuese, evidentimin e të vërtetave historike, përmes zgjimit të kujtesave etnike, ku një element i së vërtetës e kanonizuar, mund të gllabërojë tërë mistën e saj.

Gjithçka në roman vjen si një futilizim i të vërtetave, ku përmes tyre, Meksi evidenton se historia e vërtetë ngandonjëherë sfumohet dhe humb; por asgjë nuk humb, çdo gjë transformohet në artefakt në Kimean me gurin e Agatës, i cili ruan me gjuhësinë e kohës gjithçka nga ai dramacitet Pellazgo-Ilire-historik, sepse siç na mësojnë ligjet e dialektikës, asgjë s’humbet, por çdo gjë transformohet.

Legjenda, miti presupozojnë në substancën e tyre të vërteta historike, duke u bërë vetë një realitet historik. Jo më kot, si një meteor, nëpër rrymimin prozator, Kimea me anë të gurit të Agatës dhe harkut mbijetesës, vijnë si metafizikë e palcës së etnisë së këtyre miteve e legjendave.

Nga analizat e arkeologjisë letrare, ardhja e tyre vjen e përputhur me ADN-në e sotme historike. Unë mendoj se ky është edhe mesazhi, qëllimi, misioni që i ka vënë vetes shkrimtarja Mira Meksi në nocionin atdhetar.

Autorja me “zhbirimet” mendimore nxjerr në pah ekstratet përfaqësuese të etnisë pellazgo-ilire, ku gjallon historia me të vërtetat e saja, në të cilat sot, në analet divulgative, për fat të keq, vakumet historike e mjegulluan në Andromedat pagane.

Me devotshmërinë e një ngulmimi letrar, krahasueshmërinë dhe sinonimitetin që autorja i bën ngjarjeve dhe fenomeneve përmes metafizikës, është një “instrument”, jo vetëm bindës por dhe shkencërisht i pranueshëm ku: “...shoh një lloj shkrimi” – thashë kur pikasa nën këmbët e Pentesileas dhe Akilit germa si kokrrizat e rërës”.

-Po, - u përgjigj El Greko, - kam përshtypjen se është një kumt i shkruar në gjuhën trako-ilire”, definon bindshëm autorja si sintezë të vetme të një gjuhe të trashëguar nër shekuj, ku gjer në shekujt 18-19, në të ashtuquajturën Republika e Moresë (Peloponezi i sotëm) gjuhë zyrtare ishte gjuha ilirishte.

Trilli i të qëmtuarit të miteve dhe legjendës, detajet e jetësimit në kontekst të ri kohor e personazheve, hipotekohën në arshivën romaneske, përmes artit shkrimor në një mënyrë të atillë saqë e kalon cakun e pabesueshmërisë, jetësohen në substanciale të re kohore, duke u zhveshur nga zhguni i përfaqësimit mitik, duke vendosur një detantë midis letërsisë së mirëfilltë dhe kronikave, të trioruara në laboratorin mendimor.

5. GJUHA FOSILE E ARKIFAKTEVE NË ROMAN

Me mjeshturinë e narracionit, përmes skrupolozitetit të përfolur nga komunikimi letrar globalist, përmes t’holllimit të palimpsesteve mitike legjendare, autorja zbërthen në produkte letrare nënkuptimin e fosilizuar, duke bërë të kuptueshme për lexuesin gjuhën e tyre, heshtjen shekullore të kanonizuar në art.

Në artin e saj romanesk, ajo flet shumë përmes gjuhës fosile, për kulturën, artin, gjenezën e etnisë ne raporte ndëretnike.

Kriptologjia romaneske, me fiksionin e saj, me anë të lojëcakërisë rrëfimore, veçori e Meksit në këtë roman, sjell hapësira nga një e kaluar e largët e Glaukias dhe Amorgesit, në një të tashme të përjetuar të Teutës dhe Skerdit, duke përqsuar një irrealitet, në realitete absurde, duke i zhvendosur ata nga papajftueshmëria ndaj njëri-tjetrit. Realja dhe irrealja në këtë papajftueshmëri, krijojnë një simbiozë sa mitike, aq edhe bashkëkohore.

Mira Meksi, kjo arkeologe letrare, do e bënte paradigme romaneske kumtin referencial, “ah ku brezi i ri” duke ngulmuar me sprovën e lartësuar të një letërsie me sharm botëror, duke shpjeguar në psiko-analitikë, rregullsinë që ndjekin popujt me autentiken e tyre në të gjitha kohërat.

Sipas mendimit estetik të Mira Meksit, në roman ekziston një lidhje e përhershme midis mitikës, epit të shkruar dhe atij të kahmotshëm gojor, me kohën tonë dhe shkencën humane të letrave. Të gjithë në përmbajtësi, vijnë si palcë e artit shkrimor.

Duke u mbështetur në saktësinë e origjinës, autorja përjashton mundësinë e çdo lloj plagjiature në kuadrin botëror, shpreh autentikën bio-shqiptare, duke ruajtur me fanatizëm personalitetin si krijuese.

Në këtë roman, si në romanet “Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë”, “E kuqja e dasmave”, “Profida ballo në Versajë”, “Frosina e Janinës”, aplikimi i artit të krijimit për Meksin nuk vjen me boshllëqe, me fragmentarizime si në artin mitik apo gojor. Duke sjellë në këtë krijim romanesk përvojat botërore dhe ato autentike gojore, proza vjen e artikuluar përmes një moderniteti bashkëkohor.

Në kompleksin psiko-analitik, në terapeutikën e saj, autorja merr ato detaje jete të cilat kushtëzohen nga kumte njerëzorë; ndaj përgjithësisht romani në planin epiko-mitik, e sjell historinë në sensin e një dramaciteti liriko-tragjik, me lëndën e trioruara në laboratorin mendimor, me përgjithësim artistik.

Këto elemente vijnë të ndërldhura, duke reflektuar dhuntinë e ndodhur brenda tyre. Në këtë kompleksitet, futja e personazheve historikë dhe e vendeve me begraund të plotë historiko-shoqëror e artistik, ia ka shtuar dukshëm vlerat romanit si dhe rrit kërshtësinë e lexuesit, duke e futur në mendime, siç është historia e bërjes së tatuazhit të Teutës, të cilët vijnë si një dukuri e veçantë, në estetikën e saj rrëfimore.

Një fjalor i tërë mitologjik rrymon në prozatorinë romaneske i veshur me tunikën e kohës së sotme, më njerëzore, më e shpirtëzuar.

Ky shtjellim i mitikës në realitetet e sotme jetësore, me personazhe jo të ngurtësuar në mermer, siç jemi mësuar t’i shihnim, por të dyalizuara, të njehsuara me personazhe të sotme realë, duke shmangur disi boshtin legjendar, e ka bërë ndodhinë mitike, më jetësore në substancën e sotme kohore duke binjakëzuar personazhet Teuta-Glaukia dhe Skerdi –Amorges.

Gjuha që përdorin këto personazhe nuk vjen e referencuar në arealin përjetues të kohërave, por me polifoninë e saj, ajo del këndshëm nga harpa dhe timpanet e shpirtit, me emocionin që përcjell përmes ndjesive të aromave shpirtërore.

Çdo ngacmim përjetues nga areali, i çojnë personazhet në shpalimin e diksionit shpirtëror, ku përjetimi është magjeja ku brumëzohet ky atraksion shpirtëror, duke na dhënë portretin e gdhendur të shpirtit si një Alef.

Nëntor-dhjetor 2022



Shpesh kam menduar për ty...

Çuditërisht, kur vinte pranvera në qytetin tim. E kishte disa vite që ajo vinte me një lagështirë të bollshme e të mërzitshme. Të dukej se çdo gjë ishte prej uji: udhët, pemët, ajri, qielli dhe njeriu. Pra, një qytet i lagështirtë. I çuditshëm ky qytet! E çuditshme, por e vërtetë. Kjo që po ndodhte në Shkodrën time nuk ndodh në asnjë qytet tjetër në botë. E, kjo në Shkodër, se i thonë: Shkodër!

Lagështira e pakursimtë i humbte bukurinë stinës së luleve dhe të zogjve, vjollcave fshehurake dhe shermashekut andrrimtar. Sikur e “harronte” si pakuptuar dhe ‘pa jetuar’ stinën shpesh të ëndrrave, vinte papritur vera. Një verë e nxehtë që kërkonte shi e, që pranvera në ikjen e saj, çuditërisht nuk i kish falur asnjë pikë lagështirë.

Shpesh kam menduar për ty...

Çuditërisht, edhe kur vinte vjeshta. Binin gjethet, iknin zogjtë dhe ndjehej herë pas here murrani drithërues. Ëndërroja një pyll si në poemthin e Zorbës. ‘Një shtëpi prej druri!’

Shpesh kam menduar për ty...

Çuditërisht, edhe kur vinte dimri. Një dimër, pakëz migjenian. Jetohej edhe në këtë dimër, kur hundën picrrake ta skuq era e duart t’i mardhë... Kur, edhe pema ndiehej e braktisur... Edhe ëndrra... Bardhësia e pafund e dëborës më kujtonte mbretërinë antike greke të “Iliadës”, teksa ti, i përkulur gjer në dhimbje, herë me lupë e herë jo, kërkoje nëpër errësirën e shekujve fjalët e çmuara geqe. Të dritshmet fjalë! Të mermertat fjalë, për t’i vënë si monument në monumentin e epikës së lashtë, që verbëria e një poeti i fliste njerëzimit mbi luftën e njerëzve me njëri-tjetrin, mbi luftën e perëndive me njëra-tjetrën...

Shpesh kam menduar për ty!.. Kush je në të vërtetë Gjon Shllaku? Nuk ke dalë nga legjendat e mitet shqiptare? Nuk ke dalë as nga legjendat e mitet greke? Po pse kam menduar që je legjendë dhe mit (!) Në të vërtetë je një legjendë dhe mit shkodran. Në të vërtetë je miku im! Po përtej...? E, mendoj që në letërsinë shqipe, avangardistët keni qenë ju, përkthyesit. Gjeneratat e përkthyesve të mirë që u përulëm me respekt. Keni qenë shqiptarë, por më parë keni qenë evropianë. Shijen, aromën, kulturën evropiane e keni ndjerë të parët. Më parë se të tjerët! Keni vazhduar të përktheni sa në heshtje sa në revoltë, sa në përndjekje sa në terror, sa në dhimbje sa në paditje për t’i treguar kulturës evropiane që shqipja e Buzukut, Budit, Bogdanit, Bardhit e Nolit e Hafiz Ali Korçës etj., ka aq margaritarë-fjalësh e termash, sinonime e shprehje frazeologjike, struktura e ndërtime të larme fjalish; sa është e aftë jo vetëm t’i shpërfaq dinjitetshëm veprat e autorëve që kanë bërë epokë, por edhe t’i nderojë poaq sa gjuha e tyre e vendlindjes.

M’u kujtove ti, Gjon Shllaku... dhe mblodha ca shënime për ecjen e rrugës tënde jetësore e letrare (shqipëruese e përkthimore), rrugë me shtigje, me të papritura e humbëtira; rrugë me tallaze valëdeti e me tallaze shiu vrulltar, me netë pis të zeza ku yjet ishin mërguar, me ftohtësinë e thekshme të ditëve që të çmendin... Me...

M’u kujtove ti, Gjon Shllaku me një buzëqeshje si hënë e vonuar, kur netëve gjumin ia falje hënës...

M’u kujtove ti, Gjon Shllaku me fytyrën tënde si një gjethe e artë vjeshte që i bën karshillëk Diellit... Ajo gjetja që mbart aromë të artë!..

M’u kujtove ti, Gjon Shllaku me at’ kuqëlimin purpuror që të digjej përbrenda fytyrës dhe ti ngjaje si një perëndim dielli, si një përflakje! I tillë ishte kozmosi yt!

M’u kujtove ti, Gjon Shllaku...

Miku im, a kishte jeta jote thërime drite? Apo...

Ashtu siç e thashë edhe më herët në këtë tekst, përsëri, pas 13 vitesh ikjeje, po

HELENISTI GJON SHLLAKU, SIÇE KAM NJOHUR

Nga Xhahid Bushati

mundohem të mbledh ca fjalë, ca shënime, ca gjurmë të botës së artit tënd, si shqipëruet të kolosëve antikë e më gjerë për të ndërtuar sadopak “Iliadën” e jetës tënde...

Miku im, po kthehem vite e vite pas, në rininë tënde. Ndonëse ti kishte një rini tjetër, një rini që sytë i kishte tek raftet e librave të bibliotekës. Në njërën dorë mbaje librin, në dorën tjetër fjalorët e gjuhëve të huaja. E kuptuan, jo vetëm prindërit e tu të shtrenjtë, por edhe mësuesit e Seminarit Papnor të Shkodrës, që ti kishe prirje për gjuhë të huaja. Një botë ku nuk mund të shkelë kushdo. Por ti ecje me guxim, sepse

zotëroje shumë mirë latinishten, greqishten e vjetër, frëngjishten dhe italishten. Në këtë kohë përktheve romanin “Ben Hur” të Wallasit. Profesorët të admiruan dhe të vlerësuan. Por... miku im, e paske pasur edhe një “POR...”, ndonëse ti ishe i pafajshëm, koha dhe rendi socialist të bënë të fajshëm. Nuk ishe më shumë se 23 vjeç, dhe ishte viti 1946. Vit famëkeq për ty. Ishe student në vitin e tretë të fakultetit Teologjik, kur të arrestuan. T’i prenë ëndrrat në mes. Shumë ëndrra! Ata që të arrestuan ishin më të zinj se nata. Të akuzuan si anëtar i organizatës “Bashkimi Shqiptar” dhe të dënuan me 101



vjet burgim. Të dënuan ty, që në vitin 1960 do të botoje “Iliadën” e famshme dhe ti duhej të ishe i famshëm, por egërsirat që janë pjesë e natës pis të zezë u munduan të mos i jepnin lavdi emrit tënd. Por harruan se Koha ta dha lavdinë. E meritoje, ndonëse pak me vonesë.

Tani miku im, do të punoje si i burgosur te fusha e avionit në Rinas, tek Ura Vajgurore, në miniera e tharje kënetash. Në burgun famëkeq të Burrelit ku jeta ishte a nuk ishte sa një rrishtë qiell, ku hëna dhe yjet nuk lejoheshin të hynin në këtë burg ogurzi, ti miku im në errësirë të plotë mësoje anglishten, gjermanishten, spanjishten dhe greqishten e re. Dhe në moshën 34-vjeçare del nga burgu. Ndoshta në historinë e një daljeje të tillë të burgulogjisë, zor se ka ndodhur në botë. Njeriu del i lodhur, i trumhasur, i leckosur, me një torbë varfanjake në dorë. Dikush të pret te porta, ose nuk të pret?! Ti dole ndryshe, dole me 18 gjuhë të mësuara. Me diej gjuhësh nga bota. Ti mbaje në shpirt shumë botë. Botë nga bota. Këtë s’mund ta kuptonte askush. Jo, jo askush. Dhe ti miku im, pa pretendime, ishe modest, shumë modest sa s’mund të thuhet; po filloje një “jetë të re” në atë dhomë e vogël ku jetoje bashkë me prindërit, atë të nisjes së një rruge të gjatë, të vështirë por fisnike të përkthimit. Po përktheje kolosët e letërsisë botërore. E çuditshme, po aq dhe e habitshme. Ti “bisedoje” me këto kolosë nga që edhe ti ishe një kolos i tillë, ndërsa në të vërtetë, në fillim ishe punëtor e më pas si normist në ndërmarrjen e Zukth-Kashtës në Shkodër. Ndryshe nga të tjerët ti kishe një orë tjetër, në mund ta quaj “Orë Përkthimi”. Jo shumë kush e ka. Kjo ishte ekzistenca e kohës tënde. Me këtë orë e matje kohën. Kështu ‘jetonte’ koha jote: brenda në shtëpi, ‘vetëm’ (në të vërtetë jo vetëm) duke përkthyer deri në mesnatë. Pas kësaj punë të mundimshme, filluan të vinin buzëqeshjet e para. Me ndihmën e poetit Llazar Siliqi e të poetit e kritikut Drago Siliqi, i cili ishte Drejtor i Shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, të botohet kryevepra “Iliada” e Homerit. Shumë do të kisha pasur dëshirë ta shihja dhe ta jetoja atë çast fatlum. E marr me mend, nga që të njoha, miku im. E marr me mend... Qielli i dashurisë tënde rrallë gjendet. Dhe ky qiell ishte “pronë” e shpirtit tënd të dliër. “Iliadën” ta mirëpritën. Të përgëzuan, edhe pse e kishe shkruar gegënisht. “Iliada” u ribotua më 1997-ën në standartin letrar, po të përkthyer nga ti miku im. Më pas u botua edhe dy herë në Kosovë, më 1971 dhe 2000.

Po bëjmë edhe pak historik të jetës tënde, për të zbuluar margaritarë të tjerë rrezatues. Më 1966 të botohet “Historia e Skënderbeut” e Sansovinos, përkthyer nga origjinali në italisht. Por një vit më pas, nuk do të botojnë asnjë përkthim. Edhe ndaj teje ka filluar përsëri kryqëzata famëkeqe e

HOMERI



ILIADA

Onufri

luftës së klasave. Sa mallkim aq dhe dramë, më saktë tragjedi për shumë njerëz. Edhe për ty, miku im! Por e kishin të kotë. Titanët nuk mund të ndalohen. Po ashtu rrjedha e fuqishme e lumit. Ti vazhdon të përkthesh si më parë. Shkruan dhe vetë dhe ndoshta pret vitin 1990. Përkthimet e kolosëve të antikitetit do të botohen në Shqipëri, Greqi, Itali, Francë, Amerikë. Një ambasador i vërtetë! Ashtu, përsëri i heshtur, e lavdiplotë, do të botojnë një prej veprave të tua të fundit të përkthyer nga dora e mendja jote e artë, “Kënga e Rolandit”. Botimi u bë i mundur nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Ti atëhere festoje 80-vjetorin e lindjes. 80-vjeç ahere ishte ti, miku im. “Kënga...”, kjo vepër e eposit francez u përkthye dhe u botua për herë të parë në Shqipëri.

Ti, tashmë, Profesor ishte 80 vjeç!
Ti, tashmë, Mjeshtër ishte 80 vjeç!

I bërë të flasin shqip: Homerin, Eskilin, Sofokliun, Euripidin, Virgjilin, Ovidin, Shatobrianin, Shekspirin, Hygonë, Rasinin, Aldred De Mysenë e deri Papa Gjon Pali.

Por Mjeshtër, të përkthesh për 63 vjet nuk është një fjalë goje. Është një rrugë e gjatë, e mundimshme, e stërmundishme. Lodhje. Dhe ti, miku im ia arrite qëllimit. Kalove nga njëri epos në tjetrin dhe u ktheve, vetë, në EPOS. Janë të rrallë njerëzit që panteonin e tyre kanë EPOSIN.

Tani, të ishte lodhur zemra...
Zemra!...


Tik-tak-et e saj u shuan një nga një pa e jetuar edhe përfundimin e Fjalorit me 65 mijë fjalë, latinisht-shqip. Ishte puna jote e fundit.

E fundit, por ndryshe nga herët e tjera po e shihje me sytë e zemrës. Në amëshim.

Nderim, Mjeshtër!

Gjon Shllakun, bashkëqytetarin tim shkodran e bashkëkohës, e njoha në fillim të viteve '90. Jetonte në një hyrje modeste pallati, në lagjen “Qafardhi”. E kujtoj edhe tani atë pasdite, kur vjeshta ishte në të hyrë. Ndihej freskia e shiut të lehtë që sapo kishte pushuar. Muret e lagështitura të asaj fasade gri të murrëtyer që pashë, sikur e plaknin më shumë pallatin. Ca rreze të diellit në ikje që u shfaqën papritur, fokusuan një tendë nazike hardhie, ku ca degëza ishin zgjatur, kërkonin hapësirë dhe në mënyrë tinëzare kishin mbështjellur ca antena televizive e s'i lëshonin dot. Kjo ‘performancë’ nuk ishte një instalacion, as dhe një subjekt përralle, por një realitet tragjiko-lirik, qiellor, me një shpërthim e harlisje gjelbërimi.

Ngjita shkallët, ca shkallë të rënë suvaje. Trokita dhe prita. Nga mënyra se si u hap dera dhe sytë e trembur të gruas që u shfaqën në të, kuptova menjëherë se nuk kishte trokitur ndonjë gazetar, aq më shumë siç isha unë, i Radio Shkodrës, i Shkodrës, vendlindjes sonë. Por më tej kuptova, teksa hyja brenda, se isha gazetari i parë që, përmes trokitjes sime kisha trazuar ‘qetësinë’ e asaj shtëpie, ku jetonin të patrazuar e donin të jetonin ashtu: në një botë pleqërie a si në një baladë, një burrë e një grua. Veçanërisht burri donte të jetonte larg zhurmave trembëse, të bërtiturave tronditëse e fjalëve të kota, që dëgjoheshin parreshtur pranë e rreth e rreth pallatit të vjetër, të asaj lagjeje pakëz në periferi. Jo se e trembnin, por ky burrë kishte një ‘botë’ të tijën, që e kishte krijuar që kur kishte qenë 17 vjeç; atëhere kur kishte nisur udhën e vështirë, por fisnike të përkthimit me romanin “Ben Hur” të Wallasit dhe zotëronte gjuhët: Latinisht, Greqisht të vjetër, Frëngjisht e Italisht. E nuk do të pushonte së përkthyeri... 63 vjet! – e nuk është një fjalë goje, por përpjekje titanike për të njohur të panjohurat e gjuhëve dhe dalje faqebardhë para tyre. Mburrrja, pazotësia, dëshpërimi, paafësia dhe koritja ishin ‘të jashtëligjshme’ e nuk kishin ‘tapi’ në mbretërinë ndershmërisht të tij përkthimore. Heshtja, fjalëpakësia, modestia ishin



miqtëbashkudhëtarë të përkthyesit të madh.

Më vonë, kur fillova të shpeshtoja vizitat si një mik në shtëpinë e tyre, kuptova se ajo grua (ishte gruaja e dytë e përkthyesit, se e para i kishte vdekur shumë kohë parë), ndonëse kishte qenë mësuese e fliste ngadalë si ato mësueset e dala në pension, sikur nuk e kuptonte plotësisht botën që kishte krijuar i shoqi. Ai jetonte gjithnjë me një të kaluar të largët, shumë të largët që vetëm ai e njihje dhe e njihje në çdo ind të saj. Ajo e kaluar pikënisjen dhe lidhjen e kishte me Homerin dhe Iliadën. Ky burrë gegë, me talentin e tij të pashoq, i kishte dhënë shpirtin e tij si përkthyes, për t'i dhënë Eposit grek pavdekësinë edhe nëpërmjet Gjuhës Shqipe. E, ata, jetonin në sajë të dimensionit dituror të patriarkut Gjon Shllaku, sa fisnik aq dhe klasik.

Kishte muaj që vizitat i shpeshtoja, ashtu siç kishte muaj që vizitat i rralloja në shtëpinë e Gjon Shllakut. Për mos t'u bërë të largët me njëri-tjetrin, shpesh flisnim në telefon. Nuk ndryshonte zëri i tij. Mirësi e dritë kishte ai zë. Më bëhej sikur fliste Dielli.

Teksa bisedonim, veçanërisht për veprën e tij të fundit, për Fjalorin diakronik latinisht – shqip me 65 000 fjalë e, që kishte 16 vjet që nuk lodhej, por kërrusej para makinës së shkrimit; me atë zërin e tij të vogël, të pafajshëm fëmijëror më tregonte se dosjes së trashë iu shtua edhe një faqe e re... Në fakt, ato nuk ishin faqe, por enciklopedi, ku një burrë i zoti dhe i palodhur, i pagjumë dhe vltetar linte shenja diturie një enciklopedie të re. Ia ndieja gëzimin e brendshëm që i lodronte në kopshtin e shpirtit të tij. Mendoja: “O udhëtar, që nuk di se ç'është pushimi, edhe sa rrugë ke për të bërë... Këndo, o muzë, këndo...”

Teksa bisedonim në telefon, gjithëherë më fanitej ai burrë, që kur përmendte dashurinë e parë nuk përmbahej e ngashërehej në vaj, që pranonte ngrohtësinë e kapuçit të zi në kokë: i menduar e shpresëbesim, udhëtar që e vonuan në kohë e megjithatë e kapi diellin e mëngjesit, bard që këngën desh ia ngrinë në buzë por s'arritën, që shumë ditë nga jeta e tij ia trishtuan dhe ia pikëlluan... Por, ngaqë e njihja mirë, gjatë bisedës, shpesh i dridhej skuqur në fytyrë. Skuqej në pafajësinë e vet... Dhe se e ndiqte ende dashuria e nënës (edhe pse kishte ndërruar jetë) si “çati e botës...” – siç thoshte liriku i shquar i letrave shqipe Frederik Rreshpja.

Një ditë prej ditësh më tregoi se, sapo ishte kthyer nga Shiroka. E kishte ftuar kompozitori Zef Çoba për një kafe. Tregonte, dhe portreti i tij ishte tjetër... Kishte një lumturi të brendshme e një vrull djaloshar që së pari i “përkthehej” te sytë, që i qeshnin parreshtur... Ndaj dhe dita ishte një realitet

tjetër për të... Pastaj, në fund me keqardhje dhe hidhërim më tregoi se mungonte era e sherbelës dhe se Taraboshit i kishte humbur gjelbërimi.

E mendoj gjatë këtë bisedë. Kisha një hamendësim. Qoftë i gabuar ky: ndoshta ishte hera e parë që shkonte në Shirokë, ai që aq mirë njihje Eposin grek.

Një ditë prej ditësh, gjithashtu më tregoi se, i kishin premtuar drejtuesit vendorë ta zgjerorin me shtëpi. Unë e dija, ai donte një dhomë më shumë, ku të ‘strehoheshin’ biblioteka, dosjet dhe të kishte një studio të punës. Por... ah... vite kaluan dhe drejtuesit që i premtuan e zhgënjyen, e lavdëruan dhe e rrejtën, s'e kujtuan dhe e harruan...

Një ditë prej ditësh më tregoi se, kishte tri ditë që ishte kthyer nga Greqia. Ishte kthyer me trofe. Ishte fitues i ‘Diskut të Argjendit’ dhënë nga qeveria greke, si një ndër përkthyesit më të shquar të letërsisë antike greke.

Po citoj nga shënimet e mia, që kam vite që i ruaj dhe i kam nxjerrë nga shiriti i magnetofonit: “Nuk e merr dot me mend, i dashur mik, se çdo të thotë të marrësh ftesë nga Homeri. Atë natë nuk vura gjumë në sy. Më sillëshin nëpërmend vargje pa mbarim që disa i thoja me zë të brendshëm, skena, personazhe, beteja dhe netët e pafund dhe të vështira të përkthimit, që shpesh i thoja vetes: “O Zot, a do t'ia dal?..” Dhe tani ftesa... drejt... Po a do të më njohin vallë? Po a do t'i njoh vallë? Me të drejtën e Zotit, nuk kisha nevojë për përkthyes, për historian, për ciceron, për rrëfimtari... I njihja malet, ndonëse kurrë s'i kisha parë, i njihja vendet, ndonëse nuk i kisha parë, njihja e njihja... Se, mor i dashur mik, ato i kisha njohur në “Iliadë”. Se “Iliada”, o mik është pjesë e zemrës sime, është zemra ime, jeta ime! – dhe i shpëtuan ca rrëkeza lotësh mbi faqet e fishkura si shenja mbarësie të një bereqeti të lavdishëm...

Nuk më shqitet nga mendja takimi me Gjon Shllakun, i cili sapo ishte nderuar me Urdhrin “Naim Frashëri i artë”. Isha caktuar nga Radioja për t'i bërë intervistën, që do ta jepnim si speciale pas edicionit të lajmeve. Pyetjet ia dhashë një natë më parë në telefon. I mirëprit, por e kuptova që diçka nuk shkonte... Para intervistës e mësova se ai nuk kishte dëshirë të fliste për veten. E mundonte “uni”... I artikulonte fjalët me vështirësi. U detyrova ta ndërprisja dialogun, të këmbëngulja “pakëz me forcë” dhe çdo gjë shkoi për mrekulli. Ai, përsëri, në bisedë bëri një kthesë të papritur... Nisi të flasë për Homerin dhe Iliadën, Eskilin dhe Prometeun e lidhur, Sofokliun dhe 7 tragjeditë e tij, Euripidin dhe 4 tragjeditë e tij, Virgjilin dhe Gjeorgjikat (përkthim nga latinishtja), Virgjilin dhe Eneidën (përkthim, pjesë të zgjedhura), Ovidin dhe Metamorfozat, Lukrecin dhe De Renum natura, Shekspirin

dhe 7 tragjeditë e tij, Shatobrianin dhe Martirët, Kornejn dhe Sidin, Fjalorin Helenik (Greqishte e vjetër – Shqip, 20 000 fjalë), Fjalorin diakronik (Latinisht – Shqip, 65 000 fjalë). Në çast, m'u kujtua një përgjigje e Sigmund Freud-it, ndaj një pyetësi mbi leximin dhe mbi librat e mirë: “Ju më keni kërkuar t'ju këshilloj “dhjetë libra të mirë”, pa dhënë shpjegim. Kështu që më lini jo vetëm zgjedhjen e librave, por edhe interpretimin e kërkesës suaj. Duke qenë i mësuar t'u kushtoj vëmendje shenjave të vogla, atëherë duhet t'i besoj formulimit me të cilin ju keni shprehur kërkesën tuaj enigmatike. Ju nuk thatë: “Dhjetë veprat më të bukura (të letërsisë botërore); në këtë rast do të isha i detyruar t'ju përgjigjesha midis të tjerave: Homeri, Tragjeditë e Sofokliut, Fausti i Gëtes, Hamleti dhe Makbethi të Shekspirit etj.”¹

Çuditërisht, edhe pse larg njëri-tjetrit, edhe pse lindjet i ndanin prej 67 vjetësh e vdekjet i ndanin prej 64 vjetësh, edhe pse vinin nga dy shtete të ndryshme por me status evropian, ata po më flisnin më të njëjtën gjuhë të universit dhe të pavdekësisë letrare, po më flisnin për një bibliotekë me përmasa dhe rrezatim botëror, ku njëri pas tjetrit librat ngjanin si gurë të xhevahirtë.

Në fund profesor Shllaku psherëtiu thellë. Desh të fliste, por nuk foli... Buza iu dridh e një lot i ndriti në faqe.

Realisht, ngaqë ia njihja jetën, ia njoha dhe psherëtimën. Dhe tani po vazhdoj unë: “Po të ktheheshin librat e përkthyer, gjuhët e huaja, vitet e burgut dhe vitet e mundishme hekakeqe² në dosje, unë nuk e di se si do të bashkëjetonin... E, pra, ata kanë ‘bashkëjetuar’ në jetën e një përkthyesi të madh, që në një ditë gushti u nda nga kjo botë, kur ende bashkëkohësve dhe gjeneratave donte t'u fliste përmes Fjalorit, që mjerisht, mbeti i pa përfunduar.”

“Ja u ktheva përsëri në Shkodrën e mbretërve
Ngritur gurë-gurë
Mbi supet lakuriq të një gruaje,
Nga vëllezërit tradhtarë.

Mbi degët e shirave këndojnë zogjtë.
Nën pemën e madhe të mesditës,
Gjethet të verdha bien mbi shpirtin tim.

... ..
Shfaqen në muzg
Trëndafilat e thurur me diell;
Ah, tani edhe trëndafilat na kujtojnë
kamionët me djemtë e vrarë:

Sa të bukur dhe të rinj ishin, o Zot!
Mirupafshim o djem në një planet pa
diktaturë.”³

Ndërrimi i sistemit nga diktaturë në demokraci, helenistin Gjon Shllaku e gjeti më të plakur, më me shumë rrudha në fytyrë dhe në shpirt, me një lëvizje më të pakët të dorës mbi tastierën e makinës së shkrimit, me një shëtitje më të zvogëluar, me një bardhësi fytyre që vinte duke iu shtuar dita-ditës e, që ngjante si një hënë më e vetmuar dhe më e pikëlluar.

Shpesh e shfletoj “Iliadën”. E bëj se nuk dua të kujtoj verbërinë e Homerit dhe të humbas diturinë e një miku të çmueshëm siç ishte Gjon Shllaku.

“Iliada” jeton dhe u flet kohërave... Do të ishte e pafat, po të mos njihje helenistin e shquar, klasikun e fundit të shkollës letrare në fushë të përkthimit, njërin nga personalitetet e kulturës shqiptare, Gjon Shllaku. Ai “Iliadës” bëri Iliadë, kjo falë edhe leksikut të begatë të gegënishtes që edhe Eposet e famëshme botërore, i këndon me madhësinë e saj.

¹ Freud, Sigmund: Psikanaliza e artit dhe e letërsisë, Dituria, Tiranë, 2000; shkrimi: Përgjigje ndaj një pyetësi mbi leximin dhe mbi librat e mirë (1907), f.15. Titulli i origjinalit: “Antwort auf eine Rundfrage vom Lesen und von guten Buchern”.

² plot vuajtje

³ Rreshpja, Frederik: *Në vetmi* (poezi të zgjedhura), Arbëria, Tiranë, 2004; poezia: Kthim në vendlindje, f. 144-145.

1

Isha i sigurt se dy miqve të mi, Bajram Karabolli, një përkthyes me emër të madh dhe Petrit Çollaku, psikolog, do t'u pëlqente çdo thërmijë e qytetit të vogël të Roskovecit. Dhe «thërmijat» e një qyteti të vogël, apo edhe të madh, janë zotërime të vërteta: rrugët, sheshet, monumentet, ndërtimet e reja, shëtitorja pedonale, ngjyrat, lulishtet, trashëgimia kulturore, prodhimet, eksportet, po edhe Biblioteka e qytetit. Nuk më zhgënjeu intuita, se kur thua 'biblioteka' të duket se bëhet fjalë për një zbulim arkeologjik. Në Roskovec edhe ta kërkosh me qiri nuk do të gjesht asnjëri të ulur në një karrige, përballë stufës, me këmbët e këputura nga rruga; por, pa u mbushur ende me frymë, do të nxjerrësh nga shpirti një poezi lirike të Azem Shkrelit, atë më tingëlluesen, «Lirikë me shi», vargjet e së cilës dukeshin nga një e çarë e përndritur mali që ta jep gjuha e bukur shqipe për të parë e për t'u siguruar se atdheu është aty, shfaqur edhe si gjuhë e natyrës. Të tre ne e vështrojnë ngultas lirikën, aq të ngrohtë e goxha e madhe, që s'ka për t'u rrudhosur kurrë dhe as që mendohet e bërë pis, sepse këtu qëndron edhe thelbi i elegancës së saj...

Roskoveci është një lirikë e thurur enkas për të tashmen. Ai bashkë me një shesh të ri, disi i fshehur, si i zemëruar prej një gjëje që nuk shkon. Këtë shesh nuk e ka askush në vendin tonë: nuk e fsheh monumentalitetin dhe duket sikur thotë që i bën njerëzit të soditin një kohë dhe se aty mund të prisnin. E dija, muzeu priste të ngrihej në skaj, bashkë me Bibliotekën Evropiane për Fëmijë. Aty në qendër të sheshit, para shkallëve do të ishte obelisku i gjuhës shqipe me vargjet e Dom Ndre Mjedës. E di, aty do të vinin të gjithë, kur të ndienin se po u mbarohej vaji i jetës së kandilleve, me shtampën e njohur "Vaj ulliri - Roskoveci" që tashmë çan rrugët dikur të ndaluara të Evropës. Ky obelisk i gjuhës shqipe me vargje aq të ndjera, ka për të dhënë një kumt të madh atdhetarie po edhe zhvillimi: *Ku n'breg t' Cemit (të Semanit, të Vjosës) rritet trimi, me zbardh shqype zanin tand!*; duket se po thur një legjendë të re jete me shembëllime të mëdha.

Hall i madh ishte të gjeje gjërat e vogla. Nuk mund të mënjanoj asgjë, mjaft t'i drejtohesha atyre më të njohurave, të cilat secili i dëgjon dhe i sheh me një pamje krejt mospërfillëse, duke mos pasur asnjëherë fobi për to. Në Roskovec ka punëtorë, dhe kur e zë në gojë këtë s'ka pse të duket se po bën një ngërdheshje. Dhe pikërisht nga kjo askush s'do ta linte veten të mërzhitej, qoftë edhe për faktin se, ngado që të hysh, ty të dhurojnë një buqetë me lule. E çuditshme! Kjo nuk ndodh askund! Kushdo që udhëton për në Fier apo në Berat do t'i mbajë këmbët në Roskovec dhe psherëtin nga që lehtësohet prej një ndjenje të rënduar ardhur nga koha...

2

Dhe mbi të gjitha aty nuk mbetesh pa lëvizur nga vendi, as me një pamje të rëndë, e për më tepër as i zemëruar që po sheh një gjë ndryshe dhe ndërkohë të presin në shtëpinë ku s'ke pse të ndihesh i/e mërzhitur dhe as duke ngulur këmbët fort sidomos për paragjykimet e tua... Atë çast vjen Majlinda Bufi, kryetarja e bashkisë. Trupvogël, e zjarrtë, e dashuruar me qytetin dhe gjithë fshatrat rreth e qark tij, duke u ngjitur kodrave të Mallakastrës të vizatuara në mënyrë origjinale kur i sheh sidomos nga kisha mesjetare e Shën Nikollës, në një panoramë tunduese. Majlinda të sheh me sytë që të shpojnë, duke depërtuar nën lëkurën e tjetrit në mënyrë krejt origjinale. Ky mund të ishte kulmi, mbase edhe një bezdi e padurueshme, por ja që ty të vjen si

ROSKOVECI - LIRIKA E SHPIRTIT

Reportazh nga Xhevair Lleshi

një tufë me lule. Dhe janë lulet, buqeta me lirika e jetës së Roskovecit!

- Po të kishe Tiranën në vend të Roskovecit, ç'do të bëje?

Ajo hesht dhe bën disa hapa në atë shesh të mahnitshëm. Të duket sikur shkon të hapë një derë. Në të vërtetë hap dyert e mendimit të saj me një pamje plot seriozitet, duke u ngritur me një ngazëllim që mund të merrej edhe si tërbim i xhindosur. Mirëpo, furia e zemërimit fashitet dhe kthehet në një puhizë... Dhe rri një çast pa thënë asgjë, duke zënë gojën në mënyrë të rezervuar, si ç'di ajo të ruajë një të fshehtë, për të shtuar me thjeshtësi:

- Do t'ia gjeja menjëherë damarin dhe do të hidhja vallen sipas rrahjeve të zemrës së saj. E kam fjalën për Tiranën, duke mbajtur në beben e syrit qelizën e Roskovecit...

Kushdo mund të ngrohej në ata thëngjij të ndezur që kishin mbetur ende aty, po edhe mund të mërmëriste sipas qejfit, veç më parë do të zhytej në aromën dhe shijen e veçantë që të lë edhe ky shesh i Roskovecit, si çdo gjë e tij, një lirisim i hollë i një ndjenje që nuk e gjen dot tjetërkund.

3

Megjithatë, Majlinda çuditërisht merr një pamje prej princeshe, sapo del në skenë, siç i pëlqente ta thoshte: çdo urim për të tjerët si për veten. Dritat e mbrëmjes së dhjetorit, pas një dite me diell dhe mikpritëse, dukeshin si një perde tyli e qëndisur që e bënte sheshin të binte në një gjysmëhije. Çfarë elegancë! Ajo mbrëmje e veshur me një stof ngjyrë të çelët, me një hapësirë si të mermertë dhe që shihej në një pasqyrë të zbkuruar me buzëqeshje dhe në saten ngjyrë blu. Pastaj buqetat e luleve, që herë-herë dukeshin si një rrënim mahnitë, parfumi i të cilave ishte i fortë e depërtues, kurse nëpër ajrin e lagësht përzier me zërat e gëzuar të njerëzve, sillte një kundërmim edhe më shpues.

Ishte një mbrëmje e butë ku qyteti dukej edhe e surprizuar, me lëkurën ende të lagur, i buzëqeshur, po edhe si i trembur në mes të dantellave të festës. Shpallëshin Njerëzit e

Vitit 2022. Dhe Majlinda bënte të thjeshtë. Ajo përgjigjej duke pranuar çdo sugjerim me ca lëvizje të lehta të kokës, po dhe duke u bërë njëkohësisht edhe e menduar.

Mbase sytë e dikujt edhe atë mbrëmje festive ishin tepër të djallëzuar. Megjithatë, nuk i duhej besuar edhe tjetrit, tëmthas e të cilit fryheshin së tepërmi; ai do të kishte dashur që të kishte ardhur krejt i vetëm. Ec në Kurjan, më tha, në Strum, në Luar, kudo do të gjesht një referim të tillë kulture. Një qendër të banuar e zbkurojnë njerëzit, të rinjtë e të rejt, nxënësit e shkollave, nuk mund ta merrni dot me mend se pas kësaj që them s'ka më vend mjerimi: sepse ku është njeriu është edhe ndihma e tjetrit, prej ndihmës dhe e liga doemos që largohet...

Në një çast tjetër ti e sheh që ajo ndjen aq keqardhje e mëshirë, sa lotët vërshojnë nga sytë e saj të bukur. Ndërkaq përkulet me një lëvizje, sido që pa e vëzhguar me kujdes veten e saj, për shkak të mallëngjimit që e kishte pushtuar. Mirëpo nuk arrin që ta çojë deri në fund fjalinë. Se befasi ndjehet e bezdisur, por që menjëherë bëhet sërish e zjarrtë, solide, me flokët e saj të dendur. Dhe gropëza e saj shumë e bukur, në mjekër, i bëhet edhe më e dukshme. Kishte marrë pamjen e asaj vogëlusheje të mirë, pa pozë, që mban në pëllëmbën e hapur mendimin e freskët, një cilësi e çmuar. Nga sheshi tek muzeumi i ri, te produktet e Roskovecit që eksportohen kudo, te Kurjani - një nga njëqind fshatrat turistike, afria me Semanin, liqenin e Kurjanit, kishën mesjetare të Shën Nikollës, peizazhit të mahnitshëm që të ndjell, rrugët e bukura, tarracat, vera, serrat, vaji i ullirit, marka e re e një sapuni që pret të certifikohet... Pra, edhe ti fiton nga kjo energji dhe sikur bëhesh tjetër. Madje edhe obelisku për gjuhën shqipe bëhet tjetër, më i shkathët, më i butë e i njomë, i cili të përcjell në trup një të drithëruar të shpejtë.

4

Përnjëherë m'u bë se Roskoveci ndihej vërtet i gëzuar dhe nuk pushonte së qeshuri.



Nuk është një buzëqeshje e zbehtë, po e përzemërt, e ngrohtë, ndaj netëve festive sikur i bie një hije që e bën më serioz. U ndjeva ngushtë ngaqë m'u bë sikur atij qyteti nuk i pëlqente që të shiheshin të ardhurit në shtëpinë e tij. Vetëm se këtë herë ajo shtëpi ende nuk ishte plot e përplot. Kështu që merre frymë i lehtësuar kur, më në fund, i mbështillte me të qeshurën dhe me vështtrimin e tij të pastër.

Në Roskovec ka njerëz! Gjen njerëz që punojnë dhe që i gëzohen jetës. Roskoveci ka edhe bibliotekë, si rrallë ndonjë qytet tjetër. Ndoshta edhe të tjerët e rrahin gjoksin (dhe e bëjnë gropë, thotë Bajram Karabolli, ndërsa Petrit Çollaku qesh pa zë!) përkulen lehtas, ndonëse të turbulluar e me përvojë të madhe shoqërore, ndiejnë se e kanë humbur disi ekuilibrin. Po edhe ata kanë nevojë për ajër ngaqë ndihen të shtypur nga një ndjesi marramendëse në atë hapësirë me libra, ku megjithatë edhe aroma e luleve dhe e femrave sikur i mbyt. Pastaj, për çudi, edhe pse të sigurt se nuk i ka parë kush, guxonin t'i shkëlpin syrin Roskovecit, gjithnjë po me të njëjtën fytyrë të mbushur me emocion papritmas dhe me tharmin në anë të buzëve. Prandaj para tyre Roskoveci me bibliotekë ndihet kryelartë dhe i bukur. Mendoni: pa bibliotekë qyteti edhe pse njëqindvjeçar, është edhe Tirana...

Nuk ndihej i zemëruar me askënd! Tek e fundit Roskoveci ka një Institut të gjuhëve të huaja falë punës së dy njerëzve të shquar të tij: Bardhyl dhe Rovena Dardha, të dy të La Sapienzës (Romë), dhe që s'përbën aspak çudi sesi ata kanë ardhur deri këtu me këtë aventurë kaq të bukur! Ndërkohë, humori mbetet aty, ndonëse gjithnjë në një pezulli ekstravagante. Dhe njerëzit, pasi e kishin duartrokatur punën e tyre, tani i dërgonin deklarata dashurie. Çdo gjë duket krejt e përshtatshme, edhe pse me kontraste të forta, çka i jep tjetër kundërmim e veçanërisht një gëzim të madh për të gjithë. Atë çast ti e sheh qytetin, si qenie e gjallë që është, duke përplasur duart i kënaqur. Çfarë fati! Aty çdo ditë do të qe e lirë dhe e bukur! Njerëzve, veçanërisht njerëzve të thjeshtë u pëlqen e lira dhe e bukura! Dhe lëshojnë një psherëtimë lehtësimi, sikur t'i kenë liru nga ndonjë torturë. Mendja u shkon menjëherë te gjallëria, optimizmi dhe e ardhmja. Me njerëz punëtorë e ardhmja është e sigurt,



edhe sikur në *Kënetën e Zezë* të bëhet qyteti i vjetër neolitik, duke bërë pllakat e shkrimit pa hieroglife e as kunja. Hygo Adolf Bernatzik, autori i librit ‘Shqipëria - vendi i shqiptarëve’ thoshte se edhe një kënetë e vetme sjell aq shumë turistë sa është e papërfytyrueshme ta mendosh ndryshe. Dhe s’ka pse të mbetet për këtë në mëdyshje. Gjërat e mëdha janë tepër të thjeshta. Ato e bëjnë të mundur të mos ndihesh i lodhur. Madje, të flesh një natë të tërë, gjumin më të ëmbël në botë. Dhe kjo, natyrisht do të ishte vërtet gjë e mirë! Ideja e një kënaqësie të madhe del kurdoherë fitimtare. Dhe për më tepër, kushdo mund t’ia premtonte vetes kaq gjë...

5

Mbrëmjes së bukur të Njerëzve të Vitit mund t’i shtohet një Qytetar Nderi i ri, edhe pse diplomat, iu shtua një buzëqeshje më shumë. Harilla Loni Goga, qytetari më i ri i nderit, të cilin prefekti, deputeti, kryetarja e qarkut, hynin e dilnin si me sustë në një lëvizje butaforike mundën ta kthenin në emblemë, saqë e bënë Harillën njeri të lumtur, po edhe më pranë se kurrë Roskovecit. Atë mbrëmje askush s’mund t’ia lejonte vetes që t’i bënte hapur vërejtje apo t’i jepte këshilla këtij qyteti; vetëm se gjithkush përpigje, me sa mundte, që qyteti i vjetër dhe aq i ri të përfitonte prej përvojës së tyre, përderisa kishte mjaft gjëra për të reflektuar. A nuk dëshironte ai, Roskoveci të ishte krenar që ta mbante larg rivalitetin e kotë, pa patur tërheqje, edhe pse nesër mund të kishte nevojë për të, duke thirrur kurdoherë me një gjest prej fëmije çapkën, herë duke qeshur dhe herë duke pulitur sytë, derisa të dukej tepër i hutuar, po edhe i pushtuar nga një admirim i papritur, duke i nxjerrë përjashta të ligat pa më të voglin hezitim, pastaj përulej me një pamje të urtë e të edukuar dhe me një tufë të madhe lulesh mbi gjunjë.

Roskoveci më ngjan me një djalosh të ri, të cilin kur e vë re, hidhet përpjetë, i skuqur si një lulëkuqe. Nuk di ku t’i çojë lulet që ka sjellë për të dashurën dhe i kalon ato sa në një dorë, në tjetrën, i mbytur nga emocionet. Ai, sigurisht është në një moshë tepër të re, aq sa gjithkush mund t’ia japë edhe një të qeshure të fortë. Mirëpo hutimi i tij, beteja e këndshme me tufën e luleve, bënin që të ftuarit dhe vizitorët të zbuteshin e të ndiheshin të prekur. Pa le, fëmijët! Befas mund të ligështoheshë disi, të bëheshe më i afërt, madje i shoqëruar nga një dhembshuri prej nëne që të kaplon të tërin, përplas duart te kofshët dhe pyet këdo për t’u bindur sesi ishte puna e dhuratës së fermerëve të Roskovecit dërguar Harkivit në

Ukrainë! Domethënëse dhe emocionuese. Dhe një certifikatë mirënjohjeje nga konsulli shqiptar i nderit në Harkiv.

Papritur e kapa veten duke e qortuar djaloshin (Roskovecin), ndërsa e vështroja sesi ishte bërë ngjyrë trëndafili dhe vazhdimisht buzëqeshte, rënë në mendime, i qetë, me një ide që sapo i shkrepse në kokë, duke i bërë njerëzit për vete krejtësisht, madje vazhdonte të tingëllonte fort e më fort në melodinë e jetës, saqë çdo gjë dëgjohej qartë me atë rregullsinë e një makinerie që funksionon si s’ka më mirë. Dhe gjithkush i numëronte sukseset si për t’u argëtuar. Ndërkohë, papritmas ato iu dukën të guximshme, që vibronin në peshën e ndonjë brutaliteti të ngutshëm, që përshkonin ajrin e sheshit të bukur dhe monumental me një dridhje të shpejtë, ndonëse si një kumbim i vërtetë kambanash, që trondit krejt vendin, duke u treguar mjaft bujar, me sa duket, për t’u dhënë të gjithë atyre që e kërkonin, një ritëm të lartë, sidomos për ata që do të vinin rishtas këtu, në shtëpinë e tyre, madje duke u turrur kush e kush të vinte para tjetrit.

Mirëpo askush nuk e humbiste durimin, prisnin të qetë, duke e patur të qartë se zotëronin goxha përvojë në kësi punësh. Estetika e gjërave të vogla i bën më të bukura të mëdhatë, u jep tjetër energji, ku të mundet, duke përdorur edhe sintaksën e dashurisë, kështu do të lirohet më shumë hapësirë! Dhe Majlinda, e mbyllur mirë në kutinë e estetikës fenomenale, e mbrojtur, zë e bën humor, duke moderuar edhe vetë mbrëmjen festive me ta, duke thënë se ajo i ndiente tek merrnin frymë atje prapa murit, të gjithë me tjetër mendim brenda vetes. Suksesi i saj në këtë shfaqje nuk kishte mbaruar akoma, pasi e nuhaste amën e parfumit të saj. Ç’fat që aty kishte mundësi të vallëzoje pa fund! Ajo është një tip që kurrë nuk kërkon gjë. Ndihej thjesht një mikeshë e të gjithëve, të cilëve u rregullonte si me magji punët e vogla të së përditshmes. Nga ana tjetër, këta njerëz të mirë nuk kërkonin gjë prej gjëje, përkundrazi, ata dëshironin t’i bënin komplimente zonjës së parë për suksesin e madh në punët e drejtimit të një qyteti që u bë bashki thjesht për të kënaqur raportet estetike të hapësirës dhe mirëqenies.

Dhe djaloshi Roskovec zë të qeshë, duke vënë nëpër vende krehtrat e punës së tij.

Më në fund, kushdo atë mbrëmje të bukur pranverore (edhe pse në palcë të dimrit!), ndihej i/e çliruar dhe i/e lumtur që do të kishte mundësi të gëzonte veten e tij/saj, pa rëndësi se ku, por pa u bezdisur prej atyre mundësive të pakta që s’reshten kurrë...

Tiranë, më 18 dhjetor 2022



Tregim nga Istref Haxhillari

Kisha rënë në dashuri, pse ta fshihja! Gjithçka më e bukur, më e dëlirë, më e qartë... apo ndoshta më e koklavitur?

- E lodhur?
- E rraskapitur.
- E kënaqur?
- Si kurrë ndonjëherë.
- Ndërgjegja?
- Eh!

Nëse gruaja që pyeste, shtruar këmbë mbi këmbë në kolltukun përballë, nuk ishte vetja ime dhe nuk shihja ëndërr, zoti e dinte çfarë ndodhte! U ngrita ndenjtur, fërkova sytë, i pulita radhazi... E kotë! As kishte ndërmend të largohej. Fytyra e ngrysur, natë me shi, kundronte si të isha djalli veshur me fustan. Sytë i dukeshin më të mëdhenj prapa syzeve të modës, lëkura i vinte erë errësirë.

Kuzhina nisi të vërtitej me gjithë mobilje.

- Mjaft i zgurdullove sytë ashtu, duhet të bisedojmë.

- Ç’farë të bisedojmë?

Më në fund pak zë! Pjesën tjetër ma kishte grabitur.

- Marrëzitë e tua.
- Përse e ke fjalën?

Ajri u bë qelq, për të filtruar dredhinë.

- Nuk më fshihesh dot.

- Si fillim të prezantohemi, - i zgjata dorën, - Ledi Smiana.

- Ledi Smiana, - u paraqit, pa luajtur vendit.

E njëjta pamje, veshje, grim. I vetmi ndryshim duart kryqëzuar prehrit në dallim prej të miave ndehur mbi gjunjë. Filli i jetës sime dukej se ishte endur e prerë bashkë me të sajën.

- Tallesh?
- Aspak.
- S’më kujtohet.
- Më ke pranë çdo çast.
- Çudi!

Më pa ngultas pa kurrfarë mëshire. Në sy nuk shqova mëri, as inat. Vetëm kërshtëri të egër.

- Sa e pacipë!
- Mbaj gojën!

Errësira, mbështjellë mantel rreth nesh, e mbrojt.

- Jam vetja tënde e pastër, - hungëriu.
- S’më dukesh, po nejtë. Ç’kërkon prej meje?

Zëri u kthye normal.

- Burrë, fëmijë, tani të dashur. Ku të shpie mushka? - buzët e shtrënguara, mjekra gur e fortë, sytë...

Më luajti mendsh!

- Në qejf të saj, - u zbaza.

- Nuk mund t’i hapesh askujt si mua, askujt, ngulite!

- T’i hapem vetes sime?
- Të gjithë e bëjnë, sa herë e kanë pisk.
- Unë s’e kam pisk.
- Që çke me të. Deri ku do të shkosh?

S’i shmangesha dot, ngjitur me mua në të gjitha orvajtjet, të mira e të liga.

- Sapo kam filluar, - pranova.
- E dashuron?
- Sigurisht! Duhet ta dish, je vetja ime.
- Jo e tëra, pjesa e ftohtë, ajo që lidhet me trurin.

- Pjesa ime lidhet me zemrën, ftohtësia

jote s’mund ta kuptojë çfarë ndje.

- Si do të përfundojë?

- Nuk do të përfundojë.

- Thua të mos e kuptojë burri? Nuk do

t’ua shtjerë në vesh dikush, dikur, vajzave,

prindërve, të afërmeve?

- S’e besoj.

- Je e sigurt?

- Them se po.

- Atëherë nuk mbush. Sado i mirë, qoftë

edhe më i mirë se burri yt, je e detyruar të

arsyetosh. Ke detyrime.

Përçartje e pastër.

- Ndaj vetes nuk kam detyrime?

U pamë sy më sy, si dy shemra, secila

në llogoren e vet.

- E dua burrin, fëmijët, jetën do ta jepja

për ta, po ti e di boshllëkun që kam pasur

përbrenda, e di sa më ka vrarë monotonia,

të njëjta gjëra çdo ditë, pa ndryshuar asnjë

herë të vetme. Im shoq është bashkëshort

i mirë, baba, familjar, po nuk mjafton.

Vite të tëra e detyruar të kapesha pas një

jete që nuk ishte imja, doja të ndjehesha

përsëri grua. U shfaq ky burrë dhe ma

mbushi shpirtin. Nuk janë argumente të

mjaftueshme për të jetuar vitet e mbetur?

- Nuk mund të jetosh dy jetë njëherësh.

- Vetëm një femër e dashuruar e ndjen

veten grua. Ti jo e jo.

- Edhe me Aurelin re në dashuri.

- Njëzet e gjashtë vjet më parë dhe

adoleshente.

- Historia përsëritet.

Qesha për të fshirë aforizmen idiote.

- Gratë do të kërkonin me qiri burrë si

Mikeli.

Kjo po, ishte e vërtetë.

- E di, - i thashë.

- Çfarë ka më shumë shkrimtari?

- I gjallë, i paparashikueshëm, plot

frymëzim, më ka falur diçka që dikur as e

ëndërroja se ekzistonte.

- Mosha?

- Arsye me tepër pse rashë në dashuri.

Ia ngula sytë. Pamja e jashtme nuk

shprehte kurrëgjë. Mbase nuk dëgjonte!

- Po të jetonit bashkë, përditshmëria do

ta shpartallonte lidhjen, do ta bënte hi në

pak kohë.

Goditje poshtë brezit, po s’e dhashë

veten.

- Nuk e di, as dua ta di.

- Budallaqe e mjerë! Më dhimbesh. Kur

të zgjohesh do të kuptosh çfarë po bën.

Zgjoju sa nuk është vonë!

Zgjoju!

U zgjova. I hodha sytë kolltukut,

celularit. Të dy në vendet e tyre. Kuverta

rozë më merrte frymën.

Si dreqin u ndodh sipër meje!

Ah, Mikeli!



Një roman i bukur, një histori e parë në sytë e pafajshëm të një djali, në prag të jetës, kurioz dhe i zgjuar, dhe që, në narrativën e tij, na përndrit një jetë të marginalizuar kufitare, -Shqipëri, Serbi, Maqedoni, Bullgari dhe të vetë Kosovës...- qysh prej një nate të kohëve thuajse të zanafillës, të evokuara nga një plakë vizionare dhe të ditur, që kujton ose intuiton gjithçka, por pa e pretenduar një gjë të tillë. Majka dhe Mësuesi i romanit janë dy përmbledhësit e kujtesës historike të një fshati dhe të një krahine, që gjithëherë ka qenë toka e një ikjeje të paskaj, që nga bogomilët e mesjetës; Majka tregon pikëvështrimin e saj legjendar dhe të pakohëshëm, por që evokon në përpikëmbëri të kaluarën e largët të pushtimit otoman dhe fatin, gjithnjë dramatik, madje tragjik, të njerëzve të kësaj krahine të humbur në kohë dhe gjeografi, të goranëve dhe goraneve, njerëz të GORËS. Ndërkaq, Mësuesi përpiqet të tregojë nëpërmjet një linje më moderne dhe racionale, por po aq kritike dhe, në një mënyrë a tjetrën, po aq e vërtetë. Kështu, pra, tregimi irreal i Majkës, i bazuar në legjendat që përcillen nga stërgjyshërit e saj, dhe madje edhe më tej thellësive të kohëve, është një e vërtetë tragjike që të emocionon me barrën jetësore që rëndon mbi çdo individ të asaj krahine të harruar, kryesisht barrën e luftërave e të dëbimit, të perceptuar së poshtmi, në lëkurën e çdo individi. Dhe midis këtyre dy kujtesave dhe dy narrativave, djali 13 vjeçar që është protagonist dhe rrëfimtari i romanit, vjen duke krijuar një qartësi të asaj çka ka ndodhur e po ndodh, për më tepër nis të kuptojë se çfarë po ngjet për rreth tij, nën një regjim stalinist, në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar. Në një farë mënyre, pra, është tregimi i fillesës dhe kuptimi i botës që e rrethon. Një nga shembujt më të mirë të përbashkimit të dy rrëfimeve në mendjen e fëmijës, shfaqet në faqet 42-43 (të botimit spanjisht), që po e rimarrim në vazhdim, lidhur me bogomilët, trashëgimtarët, në një farë mënyre, të zoroastrizmit ose mazdeizmit...Ja edhe tregimi i Mësuesit dhe reflektimi i tij në kujtimet e lashta të Majkës:

“Para 800 vjetësh, në Ballkan lindi një herezi që nuk pajtohej me dogmat e atëherëshme të kishës zyrtare. Heretikët mohonin mëkatën e zanafillës dhe i shpjegonin punët e botës duke shpallur ekzistencën e dy Zotëve, dy krijuesve, dy parimeve për të gjitha gjërat. Si mund të bëjë qaq shumë të këqia në këtë botë një Zot që ka bërë aq shumë të mira? -pyesnin ata. Prandaj, sipas tyre kishte dy, një Zot të së mirës dhe një Zot të së keqes...Kjo herezi shkretoi shumë vende e fise, por edhe Ilirinë tonë, për vite me radhë. Maneu, krijuesi i kësaj herezie, qe rrjepur i gjallë me urdhër të mbretit të Persisë. Edhe perandori Dioklecian i dogji të gjallë udhërrëfyesit kryesorë. Po kështu bëri edhe Roberti, mbreti i Francës. Murgun Bazil, udhëheqësin e bogomilëve heretikë, e dogjën të gjallë në Kostantinopojë...Erdhën deri këtu, në krahinat tuaja, ku i quajnë torbeshë, të përzënë e të bredhur gjithë jetën me torbë në krahë...”

Papritur, Mësuesi mbylli librin, më pa me habi dhe tha:

Shënime për romanin e Namik Dokles "Vajzat e mjegullës", botuar në Spanjë, përkthyer nga Maria Rocés Gonzales

Tregimi i fillesës dhe kuptimi i botës që e rrethon

Nga EMILIO SOLA
shkrimtar, historian, studiues i letërsisë,
veçmas i veprës së Servantesit.

Shkrimi është marrë nga "Archivo de la frontera", botim i Qendrës Europiane të Publikimit të Shkencave Sociale, Spanjë.



“Ti i dije? Ke dëgjuar edhe herë të tjera?”

“Jo, i thashë, nuk i dija, por një herë Majka më ka treguar për një gjysh, apo stërgjysh të saj që e ka kapur mbreti i bullgarëve. Njerëzit e tij i dogji në zjarr, të tjerët i vdiq në tortura, ca i përzuri zbathur e pa bukë nëpër botë, kurse stërgjyshit të saj i preu gjuhën që të mos fliste më, sepse nga fjalët e tij mbreti kishte frikë. Kështu tregonte Majka. Dhe ashtu, gjuhëprerë, ai brodhi male dhe bjeshkë, derisa erdhi e zuri rrënjë në këto anët tona.”

Strapacimi i të përzënëve dhe i të ikurve, në kujtesën e njerëzve linte atë hidhërsirë të herëshme, e cila, nën regjimin stalinist të viteve pesëdhjetë, e nxiste Majkën që të thoshte se “pulitika,- siç e deformonte ajo fjalën politikë,- ka binjake hajninë” (fq. 65) Dhe gjithashtu, në ditarin e Xhaxhait të protagonistit, në të cilin mbledhte ditë për ditë ngjarjet e fshatit, shfaqet i njëjti perceptim negativ për politikën, në shprehjen: “O Zot, bashkoje atë që politika e ka ndarë!” (fq. 177) Politika prej së cilës fshati vuan, pa përfituar

asgjë, shprehet edhe në një proverbë të thënë nga njera prej gjysheve të rrëfimtari të romanit: “Me ujin, me zjarrin dhe me qeverinë mos u kap!” (fq. 200)

Gjithashtu edhe koha e pushtimit otoman, në kujtesën e njerëzve është e mbushur me tmerr, ashtu si islamizimi i largët, apo xhamia e djegur në mes të fshatit, që dikur kishte qenë krenaria e tyre si vepër e Sinan Pashës të Kallabakut. Një biografi sintetike e një pesonazhi, mes reales dhe mitikes, si gjithçka që tregojnë pleqtë kujtimbartës, si vetë

NAMIK DOKLE

Las hijas de la niebla



Padre e bija en Okol, en el valle de Shala, Giuseppe Massani (1940)

TRADUCCIÓN: María Rocés González
TÍTULO ORIGINAL: *Vajzat e mjegullës* (2015)
EDITADO POR: 2Sicilias Reino Editorial y Botimet Toena
ISBN: 978-84-125482-0-4
D.L.: AL 3196-2022
THEMA: FBA



Majka, e jep tonin e kujtesës kolektive: “...Hizri ishte nga anët tona. Sinan Pasha e mori ushtar. Pastaj i dha grada. Pastaj përsëri dhe përsëri. Sa më shumë që vriste, aq më shumë grada i vinin. Njëlloj siç bënte Sulltani me Sinanin. Ferrat rriten prej shiut, gradat prej gjakut.” (fq.81)

Krahina e Gorës, është e copëtuar dhe e diskutuar mes disa kombeve dhe grupeve tribale, “edhe pse jemi i njejtë popull, na kanë ndarë për shumë kohë me kufirin, sikur të ishte muri kinez, jemi jetimë në Gorën tonë...”

Një temë përshkuese e krejt romanit dhe një nga motivet kryesore, në mos kryesori, është ajo e grave të fshatit, gëzimi më i kthjelltë i atij realiteti të ashpër, janë Vajzat që këndojnë në shtatë portat dhe janë pjesëtarët e padiskutueshme të festës së Shën Gjergjit, të pranëverës së plotë. Jo rastësisht titulli i romanit të Namik Dokles u referohet atyre: “ Vajzat e mjegullës”. Pavarësisht kësaj, që nga rrëmbimet martesore, përgjatë jetës dhe vuajtjes së përditëshme pas martese, nuk u ikin vështirësive edhe pse keqtrajtimi nga burrat është i njohur nga të gjithë. Të gjithë këtë jetë fatkeqe, privimet, pasojat dhe gjurmët e saj të pashlyeshme, plaka e ndritur Majka i sintetizon me thjeshtësi, duke na dhënë një mësim të veçantë të historisë, sa lokale, aq edhe universale:

“ Gjithë jetën, e keqja na është vënë nga prapa me bukë në anxhik. Ne ik e ajo ndiq...Përndjekja e parë qe ajo e stërgjyshërve tanë bogomilë. Pastaj erdhi dita e përndjekjes së dytë, kur e vunë priftin mbi zjarr, për ta pjekur të gjallë si kec! Në të tretën e bënë shkrumb Xhaminë e Sinan Pashës! Nga të tri Ditët e kiametit, e katërta është më e keqe. Kur të vijë ajo, gur mbi gur nuk do të mbetet...” (fq.280)

Kohë të herëshme që kthehen në ditët aktuale me ngjarje tashmë tepër të njohura, apo në ferrin e tragjedi të një regjimi politik ekstrem, me jehonë biblike të represionit dhe vuajtjes. Dita e katërt e kiametit, të cilës i referohet Majka, në mendjen e saj është e tashmja e regjimit politik të Enver Hoxhës dhe të represionit të tij, të cilën djali e ndesh në rrjedhën e romanit dhe përpiket ta kuptojë.

Ka edhe shumë momente poetike në rrjedhën e romanit, si ai kur shqiponja e futur në kafaz nuk ha ushqimet që i hedhin dhe vdes aty (fq.248), skenë kjo e mbushur me simbolizëm për djalin protagonist, apo edhe dita e festimit me dhurata për njerin nga gjyshërit që ka vendosur të lerë mjekër, gjë që Majka ia shpjegon shumë thjeshtë djalit të vogël: “ Kur një burrë vendos të lerë mjekër, ai ka nisur të kuvendojë më shumë me qiellin se sa me tokën” (fq. 202)

Dhe ja, në fundin dramatik të romanit,- pushkatimi i Mësuesit,- ky i fundit, duke u bazuar në një artikull të “Zërit të Amerikës”, për të cilin e përndjek sigurimi i frikshëm, apo policia politike e Hoxhës, arrin t’i tregojë djalit se nga vijnë të parët e tij: “ Nga mjegulla vijnë, në mjegull e kalojmë jetën. Jemi jetimë në shtëpinë tonë!”

Shënime për romanin “BU - Si nuk u bëra anëtar i Bibliotekës Universale” të Virgjil Muçit

MAKTHI I PRITJES SË PAFUNDME

Nga Namir Lapardhaja



Pritja njerëzore e ka një kufi. Kur ajo thyen çdolloj parashikimi, shndërrohet në një proces absurd, që mund të zgjasë pafundësisht. Rrëfimi i Virgjil Muçit në romanin “BU, si nuk u bëra anëtar i Bibliotekës Universale” është manifestim i kësaj pritjeje, pa rezultate konkrete, për t’u anëtarësuar në një institucion kulturor dhe që, pas procedurave burokratike dhe formale, do duhej të ishte çështje rutinë, me një afat konkret, të përcaktuar.

Motivi i pritjes është i vjetër në historinë e botës dhe të letërsisë. Dhjata e Vjetër rrëfen pritjen e gjatë të popullit izraelit në shkretëtirë, të përndjekur nga Faraoni, në kërkim të Tokës së Premtuar. Plot 40 vjet ende dhe vuajtje. Penelopës tek “Odiseja” i duhet të presë Uliksin 10 vjet gjersa përhumbet në aventura brigjeve të Mesdheut derisa mbërrin në shtëpi. Vladimiri dhe Estragoni tek drama e Beketit i duhet të presin Godonë, që nuk vjen asnjëherë. E njëjta pritje e Gjeomterit K tek “Kështjella” e Franc Kafkës, të cilit i duhet të presë një letër për t’i lejuar futjen në Kështjellë. Madje, siç ka treguar Maks Brodi, Kafka, nëse do kishte mundur ta përfundonte romanin, do ta kishte çuar absurdin edhe më tej: letra e pranimit për në Kështjellë, do t’i vinte K-së ditën e vdekjes.

A nuk është jeta njerëzore një pritje e gjatë? A nuk është njeriu në një rendje të vazhdueshme drejt së panjohurës? Personazhit të “BU-së” i duhet të presë 20 vite për t’u anëtarësuar në Bibliotekën Universale. Në 5 vitet e fundit ka marrë statusin e kandidatit dhe sërish asgjë, në vend numëro. Asnjë hap përpara. “Kam ndjesinë sikur historia e anëtarësimit tim në BU është shndërruar në një narrative biblike...” – deklaron ai. Paradoksi është se gjithçka duket në rregull. Ka udhëtime dhe ftesa, vizita të ndërsjella, dreka dhe konferenca të përbashkëta për shtyp, fjalë të mira dhe premtime shpresëdhënëse, por sërish pritje dhe procedura të reja që bëhen të ditura vetëm në takimin pasardhës. Pavarësisht

këtij absurditeti, pritejeje të gjatë dhe të pashpresë, “...duke i këqyrur gjërat në perspektivë, nuk kemi alternativë tjetër, veç anëtarësimit në atë institucion. Jo për hir të një ndjenje vaniteti, por për faktin e pakundërshtueshëm se, në thelb, i përkasim kulturës dhe qytetërimit që mishëron e përfaqëson BU-ja. Ashtu siç ajo na përket neve, po ashtu i përkasim edhe ne asaj. Natyrshëm...”. Selia qendrore e BU-së ndodhet në qytetin evropian B. Aty do të dorëzohet edhe ‘Pyetësori i 1001 Pyetjeve’, ku çdonjë prej Kapitujve, që përkonte me një prej Pyetjeve, “i ngjante një molloku guri 80 ton, ashtu si gurët e Piramidës së Keopsit që skllëvërit kishin mbartur para pesë mijë vjetësh për të ndërtuar një prej mrekullive antike”. Akronimi BU dhe shumë shenja tekstuale të tjera, na orientojnë tek pritja e gjatë e shqiptarëve për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Kemi lojën mes fjalëve BU-BE. Sipas asaj që ndërton shkrimtari, ky anëtarësim përpara se të jetë politik dhe burokratik, do duhej të ishte kulturor. Është Don Alberto, një personazh i ngjashëm me Virgjilin e Dantes tek “Komedia Hyjnore”, ai që e shoqëron protagonistin në udhëtimin në Fondet e BU-së, i cili më së miri përcjell mesazhin autorial: “Është e trishtueshme kur sheh se me çfarë efikasiteti Burokracia është e zonja të vrasë ëndrrat e njerëzve. Anëtarësimi në Bibliotekën Universale... është manifestim i një ideali, një aspirate fisnike dhe jo një praktikë burokratike që endet pafundësisht e më pas ngec në ingranazhet e disa temave teknike: tranzicion, reformë, kritere e standarde...”

Romani i Virgjil Muçit është më shumë se një alegori politike dhe një pamflet për integrimin evropian. Kemi një vepër dystopike, por jo një traktat politik. Materia letrare e bollshme, loja autoriale, ndërthurja e personazheve dhe e ngjarjeve, bëjnë të mundur që romani herë të marrë karakter thriller, herë të tjera të shfaqen në të nuanca të realizmit magjik. Protagonisti kryesor

kalon me një lehtësi të habitshme sa në këtë botë ashtu edhe në të përtejmen, çka shpeshherë vështirëson lexuesin për të kuptuar situatën në është duke ndodhur vërtet apo është një shajni e radhës e personazhit kryesor. Ai nuk ka emër, nuk identifikohet, si për të treguar që në këtë univers jemi të gjithë qenie të paidentifikueshme, në një botë të madhe, ashtu siç janë të paidentifikueshëm nga shenjat e gishtrinjeve edhe personazhet e tjerë. Në faqet e romanit vihet re kultura e gjerë, dijet e thelluara dhe të larmishme të shkrimtarit, të cilat shërbejnë si petale kolorite për pasurimin e mëtejshëm të veprës letrare. “BU, si nuk u bëra anëtar i Bibliotekës Universale” merr një rrjedhë tjetër kur protagonistin heq dorë nga anëtarësimi dhe ia beson atë “mision të shenjtë” Hermesit, asistentit të tij. Është kjo tërheqje dhe rendja e tij pas dashurisë së Moll-it, ajo që hap një perspektivë të re rrëfimtare dhe krijon një atmosferë fantazmagorike me “flutura të zeza me dy pika të verdha te flatrat” apo duke rihapur nën fakte të reja çështje të së kaluarës së tij familjare. Kjo lojë narrative dhe këto gërshetime situatash dhe ngjarjesh e mbajnë veprën fort në shinat e letraritetit, duke bërë që ajo të lexohet me kërshtëri nga fillimi në fund. Ky roman ka një stil të veçantë përsa i përket gjuhës së përdorur, që është e përkorë, por edhe strukturës rrëfimtare që ka në dispozicion dhe që krijon e portretizon me mjaft mjeshtëri personazhe, që nyjëtohen në ngjarje dhe situata të befasishme. Ashtu sikurse ka rrjedhshmëri fraze, leksik dhe sintaksë të përzgjedhur me kujdes.

Me këtë vepër, Virgjil Muçi duket se na fton për të reflektuar thellë për shoqërinë dhe civilizimin tonë, në të cilin njerëzit duhet të jenë të barabartë. Në të e gjithë historia shfaqet si një shpalosje e një vizioni njerëzor, për ta parë dhe konsideruar tjetrin kulturalisht ashtu siç kishim dashur ta shihnim vetveten përpara pasqyrës.



Dhe buzët e mia mbartin mëkatin tënd
Romeo dhe Xhuljeta,
Akti I. Skena V

Askush s’e pat menduar që Mark Marubi Ado të zhdukej për dhjetë vjet nga qyteti i Shkodrës. E kishin vënë re që profesorin e letërsisë botërore në universitetin “Luigj Gurakuqi” kohët e fundit nuk e shihnin më si ngaherë te kinema Republika, madje as të shëtiste mbrëmjeve. Të fundmen herë që mendohej se kishte qenë andejpari duke bërë shëtitjen e tij të vonët vetmitare, ai kishte pasur një pamje të çuditshme, të heshtur e zymtane, gjë që dukej e pabesueshme për të gjithë, se nuk ishte i tillë Mark Marubi, prandaj duhej të qenë të vërteta hamendjet se ai, kohët e fundit kishte rënë keq në dashuri, siç bien poetët, se përndryshe do të ishte bërë i gjallë burri i botës.

E panë njëherë të dilte nga ndërtesa e heutesisë, mirëpo për çudinë e të gjithëve, ai nuk u pa më me vite e vite me radhë derisa pas një dekade u pa të lëvizte si hije nëpër qytet dhe më vonë u bë përsëri profesor por kësaj radhe me flokë të zbardhura dhe pa gjetur asnjë nga kolegët e dikurshëm të departamentit. U mor vesh se ishte burgosur, por askush nuk mundej të vinte një lidhje mes dashurisë së Mark Marubit dhe qelive. Asgjë nuk kuptohej, edhe pse nën të thuhej se kishte dashur të arratisë, mirëpo se me kë nuk qe e sigurt, po me të dashurën se me kë tjetër, komentohej nën zë. Dashuria e tij paskësh qenë kaq e madhe sa nuk e kishte nxënë qyteti ynë.

E harruam Mark Marubin ne studentët sepse na erdhi si zëvendësues, një “Mark” i ri, por mua m’u kujtua një natë pa hënë, dhjetë vjet më vonë, kur një burrë i panjohur u dëgjua të ngjtiej në katin e dytë të shtëpisë tonë. Sapo kishim ndërtuar shtëpinë e re dhe në katin e dytë nuk kishim vënë akoma dyer. Ishte qetësi dhe terr. Burri i panjohur kishte ndenjur do kohë në katin e epërm dhe, pasi nuk kishte gjetur ndokënd, ishte mbështetur i lodhur në derën e dhomës së Arbërit, vëllait tim oficer, duke përgjuar se mos pipërinte ndonjë zë njeriu. Arbi qe zgjuar, dhe kishte mënjanuar pak perden e dritares për të parë jashtë, por nuk kishte dalluar asgjë në atë errësirë të plotë. Burri i panjohur me të dëgjuar kërcitjen e sustës së krevatit i kishte rënë derës fort dhe i ishte afruar për të dëgjuar ndonjë zë nga brenda shtëpisë. Arbi, duke çuar gjithfarë gjërash në mendje, i vuri pistoletës fishekun në gojë dhe iu afrua derës. Mes tyre u zhvillua ky dialog.

Arbi: - Kush je?

Burri i panjohur: - Kush jeni ju?

Arbi me zë të sertë - Kush je ti?

Burri i panjohur - E kujt është kjo shtëpi? Kush jeni ju?

Arbi- E jona. Kush jeni ju?...qetësi.... bërtet: largohuni në fund të shkallëve!

Burri i panjohur - Të largohem unë?...Bën dy hapa prapa...Ja u largova.

Heshtje. Ai pyet: - Ju nuk më njihni mua? Ndërkohë, unë kisha dëgjuar gjithçka

në dhomën tjetër sepse atë natë nuk po më zinte gjumi ndaj zgjova menjëherë Ermalin, vëllain tjetër, dhe i thashë se Arbi po zihej me dikë dhe se duhej të dilnim jashtë të shihej se ç’po bëhej. Dolëm të tre jashtë, dhe si u bëmë tre vetë, e rrethuam duke u munduar ta njohim se kush ishte dhe në të njëjtën kohë edhe për ta frikësuar, por atij për çudi nuk i luajt asnjë nerv i fytyrës.

- Këta janë vëllezërit e mi - i tha Arbi, por as ai as ne nuk po shihnim dot gjë sepse atë natë. I panjohuri vazhdonte të pyeste:- E kujt është kjo shtëpi? Ku jam?

- Në Shkodër - u përgjigja unë duke vrarë mendjen se ku e kishte dëgjuar atë zë. Ai, duke e lëshuar veten në një karrige që solli Ermali, tha se në Shkodër kishte shtëpinë.

-Po mirë, kush jeni ju? - pyeta unë.

- Ju nuk më njihni mua?- më pyeti ai.

- Po si të të njohim në mes të natës, në këtë terr - ndërhyri Arbi i revoltuar që i ishte prishur gjumin gjithë anëtarëve të familjes së tij prej dikujt që kishte ardhur dhe vetëm pyeste se e kujt ishte kjo shtëpi dhe se

kush ishte ai, nëse e njihnim apo jo dhe gjëra të tilla pa kuptim.

I panjohuri nuk foli për pak kohë...u mendua dhe kërkoi një qiri. Diçka e tillë i kishte vajtur ndërmend sime mëje e cila ia dha menjëherë të shoqit. Ai e ndezi menjëherë dhe duke ia afruar pyeste veten pa zë a e njoh? Nuk dinte ç’të thoshte për atë fytyrë nëse e kishte parë ndokund por zëri i dukej i njohur megjithatë duke mos qenë shumë i sigurtë iu drejtua personit përballë me një shprehje habie: -Ti qenke përgjakur!

Ai, sikur t’i kishin kujtuar diçka të harruar, u shkund nga përhumbja ku kishte rënë, psherëtiu i lehtësuar e, duke ngulur vështimin në një pikë të pacaktuar, rënko i me trishtim: - Unë.... shyqyr që jam gjallë.

E pyetëm nëse e mbante mend se ku kishte qenë mbrëmë, por ai duke folur ngadalë tha se nuk e mbante mend mirë. Dinte se e kishin hedhur në një kanal mbi trungun e një peme të rrëzuar. E pyetëm se mos i kishin vjedhur gjë, duke menduar se mund ta kishin plaçkitur natën, por duke na befasuar gjithmonë, tha se e mbante mend fort mirë se çfarë kishte humbur dhe kur e pyetëm sërish se çfarë, pasi heshti pak duke u menduar foli solemnisht: -Kam humbur rininë.

I bëmë një kafe që të mblidhte veten. Tregoi se ishte Mark Marubi, ish profesori i letërsisë në universitetin “Luigj Gurakuqi”, djali i doktor Marubit. E dinte që të atin ia kishin pushuar menjëherë nga puna pas zhdukjes së tij nga qyteti dhe burgosjes së mëpasme. Na tha se kishte dhjetë vjet që nuk kishte qenë në shtëpi. Mbrëmë e kishin nxjerrë nga burgu dhe, pasi e kishin transportuar me një makinë ushtarake nga Burreli, e kishin hedhur në një kanal të qytetit, afër një peme të rrëzuar. Kishte qenë një kumbull e njomë e se i vinte shumë keq që rrënjët i kishin dalë mbi tokë por hamendësoi se menjëmend duhej të kishte mbajtur një kohë e keqe.

-Shi dhe stuhi - ishte përgjigja jonë.

Piu kafënë dhe meqë ishte duke zbardhur unë dhe Ermali e përcollëm për në shtëpi. Rugës na pyeste nëse ishin gjallë prindërit dhe kur ne i thamë “po” dhe nisëm t’i flisnim për ta, ai pohonte me kokë dhe shtonte përherë një “të fortë paskan qenë” me mëdyshje. Pastaj na rrëfeu se nuk kishte qenë e vërtetë që e kishin arrestuar ngaqë kishte protestuar në Bibilotekën e qytetit që kryevepra e Uollt Uitmanit “Fije bari” ishte futur në skedarët e librave për bujqësinë. Ai, Mark Marubi për të cilin qytetarët thoshin se kishte rënë në dashuri, ishte e vërtetë, kishte rënë në dashuri me një vajzë me emrin Xhuljetë, si te drama e Shekspir, dhe ata në fakt kishin bërë stërvitje dhe përgatitje që të arratiseshin për në Mal të Zi...bashkë....por s’mund t’ua rrëfej gjithçka na ndodhi, tha ai, dhe ngjante sikur po bënte të pamundurën të mos shkruhej në lot.

Ne nuk e pyetëm më tej, pas dhjetë vjetësh në burg, ai po kthehej në shtëpi. Kjo kishte rëndësi.

Kur na hapën derën te shtëpia e tij pamë fytyrat e plakura të prindërve dhe vëllezërit me sopata në duar, pasi kishin kujtuar se mos qe ndonjë nga komshinjtë me të cilët ishin grindur për punë toke. Fytyrat e tyre ndyshuan aq shpejt sa nuk e besova që fytyra që më parë kishin qenë kaq të egërsuara mund të fshihnin një mirësi të tillë njerëzore. I përqafoi të gjithë dhe më pas thanë se kishte hyrë në studion e tij dhe nuk kishte dalë prej saj për tri ditë dhe tri net. Kishte qarë, kishte prekur me radhë të gjitha librat e studios duke mos e besuar që ishte kthyer. Ishte ngjuar brenda prej mallit për librat. Mandej ishte shfaqur në godinën e universitetit ku jepte mësim dikur dhe pas shumë rropatjesh kishte rinisur të jepte mësim aty.

Në burg kishte mësuar gjuhën angleze dhe shumë shpejt përgatiti një tekst të letërsisë botërore, një monografi për Dikensin, një studim për autorët e botës anglishtfolëse që kishin shkruar për Skënderbeun, dhe nisi të merrte pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare në Angli, SHBA, Gjermani,



Spanjë, Francë, Danimarkë, Norvegji.. Profesor Marubi sikur po rendte në kërkim të kohës së humbur. Një ditë në auditor, pasi u recitoi studentëve përmendësh monologun nga Jul Çezari me refrenin “And Brutus is an honorable man!” një student e kishte pyetur për për historinë e tij të arratisjes, dhe ai s’u tregoi, vetëm nxori një fotografi që e mbante në xhep të portofolit dhe ua tregoi. Ishte një djalosh me flokë të zezë kaçurrelë, djalosh i hijshëm, shumë bukurosh, dhe u tha se tani i kishin rënë të gjitha flokët, por i ri, ai kishte qenë i bukur dhe kishte pasur kaq ëndrra të bukura të cilat i ishin djegur bashkë me rininë e tij. Por vetëm kaq, Pastaj profesori ishte bërë i zymtë dhe u kishte kërkuar leje që të vazhdonte me shpjegimin por të gjithëve u mbeti në mendje ajo fotografi. Por ata e dinin se profesori nuk kishte krijuar familje, ishte tip i vetmuar dhe shumë herë e shihin në Kafë të Madhe me profesorë të huaj të cilëve u fliste me krenari për vendlindjen e tij.

Në një seminar ndërkombëtar të letërsisë ai lidhi miqësi me shkrimtarin e shquar anglez Brajan Oldis. Në fund të majit 1990 ai erdhi në Shqipëri dhe profesor Marubi mbajti frymën te Hotel Dajti. Brian-i ishte një burrë i gjatë, i bëshëm, me sy të kaltër, të gjallë e inteligjentë, me flokë gështenjë, të shkrutër e të rralluar. Mbante syze pa ngjyrë me skelet të hollë floriri. Kishte zë melodioz, të plotë. Ishte energjik, i shpenguar, i përzemërt, i thjeshtë, me një sens humor i të hollë tipik anglez. Gjatë disa mbrëmjeve Profesor Marubi dhe Brajan Oldis biseduan për shkrimtarët anglezë që Brian-i admironte, më së shumti për Përsi Shellin, i cili kishte ndikuar kaq shumë tek ai, duke shkruar romanin “Frankeshtajnin e çliruar”. Biseda e tyre ishte përqendruar shumë të Shellët, tek e shoqja që kishte refuzuar ftesa për martesë nga Hogu, shoku i ngushtë i Shellit dhe po ashtu edhe nga nga poeti amerikan Washington Irving, si për tregimin me motive

shqiptare “Syri i keq” që profesor Marubi e kishte përkthyer dhe botuar te gazeta “Drita”.

Profesor Marubi i rrëfeu se si ndërsa Shell kishte vdekur aksidentalisht një muaj para se të mbushte të tridhjetat, kur kishte qenë në burg, ai kishte kuptuar sakaq se edhe ai ishte nisur për t’u arratisur me të dashurën e tij të zemrës. Xhuljetë B, volejbolliste e klubit të volejbollit “Vllaznia”, pikërisht një muaj para se ai vetë të mbushte të tridhjetat. Pastaj i rrëfeu historinë e tij të arratisjes dhe kur kishte parë se Brian-i kishte heshtur duke dëgjuar gjithë vëmendje ai i kishte rrëfyer si si një natë, ai dhe Xhuljetë B kishin shkuar në bregun e liqenit të Shkodrës, kishin hequr të gjitha rrobat e trupit, që të lyheshin me graso për të mos depërtuar uji në trup, dhe atë mbrëmje, para se të lyheshin, ajo kishte dashur që t’i jepeshin njëri-tjetrit para se të niseshin drejt të panjohurës, sepse ndoshta do të kapeshin dhe përfundonin në burg, për gjithë jetën, ndoshta do të dilnin matanë dhe të fitonin lirinë dhe të krijonin familje bashkë, ndoshta do të mbyteshin, i kishte thënë ajo. Kishin bërë dashuri dhe pastaj, ai e kishte lyer së pari trupin e saj të bardhë me graso, ngadalë, me një lloj zemërimi që për të fituar lirinë duhej të lyeje le graso trupin e një femre të bukur si ajo, dhe pastaj kishte lyer trupin e vet.

Pasi kishte rënë errësira, pasi kishin përgjuar frymën e njëri-tjetrit fshehur në disa shkurre me frikën se mos i pikaste kush, ata ishin zhytur në ujë e me krye të fshehur në një kamerdare të cilën po ta shihje për së largu të jepte përshtypjen se po e lëviznin dallgët të braktisur nëpër liqen, ishte nisur për të kaluar kufirin e liqenit. Rastësisht e kishte pikasur një nëpunës i Shtetit, i cili e kishte bërë zakon të tradhëtonte gruan në ato anë, dhe njëqind metra pa kaluar telin me gjemba i kishin kapur me motoskaf. Por kur profesor Marubi dhe Xhuljeta kishin ndërë zhurmën e motoskafit, ata ishin zhytur thellë nën ujë, dhe kapur dorë-për dorë, si të kishin vendosur një pakt të menjëhershëm ata vetëm zhyteshin, dhe në mes të kësaj zhytje drejt fundit të liqenit ai kishte kuptuar se po bënin vetëvrasje. Po sikur zhurma që kishin dëgjuar s’kishte qenë zhurma motoskafi por një hamendje e tyre, kishte pyetur veten. Pastaj s’e kishte përballuar dot idenë e vdekjes së saj. E kishte shtrënguar fort dorën dhe u kishte dhënë këmbëve përpjetë por kishte kuptuar se ajo po bënte të kundërtën. Ajo donte që të rrinte përgjithmonë nën ujë, kishte menduar sakaq ai dhe ndërsa i jepte si i çmendur duarve dhe këmbëve për të dalë mbi ujë i ishte ndërmenduar fjalët e saj pas dashurisë ndërsa ai po ia lyente trupin lakuqir me graso: Nëse do të vojnë të na kapin, unë më mirë të vdes. *Nëse vijnë me na kap, kjo ka me kenë nata e martesës martesës dhe dekës teme.* Dhe ai nuk e dinte se sa gjatë ishte përpjekur të dilte mbi ujë, vetëm mbante mend se kur kishte nxjerrë kryet sipër syprinës së liqenit gati duke iu marrë fryma dhe kur ndjeu se po e linin fuqitë, ai mbante mend se kishte pak kohë që në duar mbante një trup të vdekur, një Xhuljetë të pajetë. Kur dritat e prozhektorëve kishin rënë mbi fytyrën e saj, ai kishte vënë re i tmerruar se dukej e lumtur, kishte dhënë shpirt me një si buzëqeshje në fytyrë, një lumturi e brendshme që i kishte thënë se ndjente para se të nisej me të.

Ia rrëfeu këto Brajanit dhe ai e dëgjonte i çuditur fuke mos e besuar se ky rrëfim nuk ishte trillim i mendjes së profesorit i cili tani i thoshte se kishte nisur ripërkthimin e dramës së Shekspir “Romeo dhe Xhuljeta” pasi ai e kishte mësuar përmendësh të gjithë tekstin e saj, dhe këtë e kishte bërë si homazh jo për Shekspirin, autorin e tij të parapëlqyer, jo për Xhuljetën, personazhin e tij të paharrueshëm, por si përsëritje për Xhuljetë B, të dashurën e tij të vdekur. Mandej, kishin kaluar gjashtëdhjetë vjet që nga përkthimi i parë, rreshtat me aluzione erotike ishin hequr nga teksti origjinal, dhe historia tragjike e dy dashnorëve nga Verona ishte shumë e ngjashme me historinë

tragjike të dy dashnorëve nga Shkodra, me ndryshimin e vetëm se ai ishte gjallë.

Kishte përfshirë poshtëshënime shpjeguese për ngjyresat dhe nënkuptimet erotike dhe seksuale që mungonin në tekstin në gjuhën shqipe si dhe 46 rreshta që mungonin plotësisht. Por më e padurueshmja për të ishin fjalët e Xhuljetës që ishin përkthyer krejt ndryshe nga origjinali: “My only love, sprung from my only hate!/ Too early seen unknown, and known too late!/ Prodigious birth of love it is to me,/ That I must love a loathed enemy”. Këto vargje ishin përkthyer shumë larg origjinalit: “Nga kjo urrejtje e vetme, për çudi/M’u ngjallka sot imja dashuri!/E pritura më duket se s’do vijë./ Më parë e papritura do mbërrijë!/Ç’e marrë dashuri që më ka hyrë,/të dashuroj kështu një armik të ndyrë”. Kurse profesor Marku e kishte përkthyer krejt ndryshe: *E vetmja dashuri që kam, si për çudi./E ka burimin tek e vetmja hasmëri!S’e njihja kur e pashë, e njoha vonë! Kjo dashuri është ogurzezë për mua/Që një hasëm t’urryer unë të dua.*

Në fund i ishte kujtuar se edhe Shekspiri kishte qenë afër të tridhjetave kur e kishte shkruar dramën dhe kishte kuptuar se ai kishte shkruar edhe më larg me përkthimin, të gjitha fjalët e Xhuljetës së Shekspirit ishin zëvendësuar me fjalët e Xhuljetë B, dhe gjatë përkthimit ai në të vërtetë kishte ringjallur atë kohën e vogël të shkurtër të atyre të dyve si dashnorë dhe gjasat ishin që përkthimin të mos e botonte kurrë.

Para se ai të largohej nga Shqipëria, profesor Marubi i kishte folur për lidhjen e veçantë të Edith Durhamit me Shqipërinë dhe Shkodrën, në mënyrë të veçantë. I kishte treguar për bastunin e saj ruajtur si amamet për shtatëdhjetë vjet nga familja Shantoja si dhe për lulen e majit, e cila në anglisht quhet “honeysuckle”, por që shkodranët e quajnë “lule-durham”, në shenjë respekti për miken angleze. Në darkën para nisjes ai i kishte dhuruar një tufë lule durham dhe profesor Marubi e kishte bërë zakon që çdo dhjetor t’i telefononte për t’i uruar ditëlindjen. Çdo dhjetor familja e tij priste telefonatën e Markut i cili ishte bërë si i shtëpisë, ai së bashku me të bijën Uendin, e kishin pjesë të ritualit të festimit të ditëlindjes teleofonatën e tij, dhe kur zilja binte dhe receptori ngrihej, ata e dinin se profesor Marubi do të derdhte mbi ta një lum fjalësh të ngrohta për të të dhe të bijën. Ai ishte arsyeja pse Brajani tani mendonte shpesh për fatin e vendit të mikut të tij dhe dëgjonte aq shumë histori nga ai dhe ishte zhytur në leximet historike për këtë vend të çuditshëm duke u bërë “si i Shqipërisë”. Në telefonatën e fundit, më 2007, Brian-i i lexoi një paragraf nga një libër i Noel Pollack, që titullohej “Shqipëria e qenies time” dhe ishte pjesë e librit “Perde e kuqe, njerëz blu” (1985): “Unë do të ik nesër.... Nuk kam qenë gati të përjetoj një valë të tillë emocionesh njerëzore. Asgjë që kam përjetuar në kolegji, madje as në darkimin me dy presidentë, s’më ka bërë të kem një përjetim të tillë. Qaj pa zë dhe lutem për popullin e këtij vendi të pushtuar prej pikëllimit, dhe për veten time”.

Kohët e fundit Brajani i kishte dërguar një letër letër ku i thoshte se kishte bërë një tregim me titull “Ne anën tjetër të liqenit” ngjarjet e të cilit zhvillohen pikërisht në kufi me Shqipërinë, në anën tjetër të liqenit. Ai vetë kishte qenë në anën tjetër të Liqenit të Shkodrës kur e kishte shkruar. Pastaj kishte shkruar Maqedoni dhe ishte ulur në bregun e përtejme të liqenit të Ohrit duke soditur me orë të tëra pamjen përtej liqenit që nanuriste mallshëm qytetin e Pogradecit dhe Malin e Thatë. Kishte shkruar në Mal të Zi dhe i ulur në bregun e andejmë të liqenit të Shkodrës, këqyr me orë të tëra qytetin e zhytur në drita dhe, duke mos mundur të hyj brenda tij, bluan me mendje se ç’është ky vend kaq i vogël, i heshtur dhe i mbyllur në guaskën e vet. Në fund, i shkruante Brajani Markut, personazhi e kupton që i vetmi faj ishte që e kishte dashur këtë vend në një kohë të nëmër.

2001-2021

(Ismail Kadare, “Sorkadhet e trembura”, Synops për një tjetër art, Vepra 20, f.517)

DRAMA LINDORE E MIQËSISË PERANDORAKE

Nga Kosta Nake



Fati i grave të ish-kampit socialist që u martuan me burra të huaj është temë e njohur jo vetëm në letërsinë shqiptare, por edhe brenda Veprës së Kadaresë. E reja qëndron në gjininë letrare që ka zgjedhur ta bëjë këtë, një miksim i skenarit të filmit me dramën. Vendosja e fatit të Ljuba Marinovës në tri kohë: në fillim viteve ’60 kur dashuria e sjell nga Moska në Tiranë: në vitin 1968 kur ndodhej në burg dhe pas ndryshimit të sitemit politik, ka bërë që të përdoret thyerja kompozicionale me alternime të shpeshta të skenave të ngjarjes, me një shkrirje të kufijve mes ëndrrës dhe zgjëndrrës.

Ljuba është vajza ruse që, për shkak të moshës dhe mjedisit propagandistik, kthehet në një flutur që vjen nga dimri rus në një vend të ngrohtë, me portokalle dhe afër kufirit me Perëndimin. Vajza që humb shumë nga Moska për të marrë diçka nga Tirana, kthehet në një zog të lirë që gjen ngrohtësi jo vetëm nga mjedisi natyror, por edhe ai shoqëror. Por ajo vjen në Shqipëri në kohën më të papërshtatshme për të vjelë kokrrat në pemën e dashurisë, pasi fillon acarimi i marrëdhënieve mes dy shteteve që zgjerohet si ftohje e Shqipërisë me gjithë kampin socialist. Ka vetëm dy zgjidhje, të dyja të dhimbshme: ndarja si çift me fëmijët që mbeten pa një krah ose ruajtja e familjes së vogël dhe ndarja pa kthim me familjen e madhe.

Bashkudhëtare në fatin e përzishëm të ndarjes ka dhe gra të tjera, si Nadja, Kristina, kontesha, etj. që rritin përmasat e rolit represiv të shtetit. Po faqja e butë e dashurisë së pastër e të paqme të Ljubës mbështetet mbi faqen e ftohtë të aviatorit Arian Shkreli që për shkak të raportit të veçantë që ka me token poshtë tij, është dhe mbetet një atdhetar i palëkundur. Ai humb vendin e punës sepse është martuar me një të huaj, nga ana tjetër është i gatshëm ta sakrifikojë dashurinë, t’i vërë zemrën një gur dhe ta lejojë Ljubën të kthehet në Bashkimin Sovjetik.

Ajo që po ndodh përcillet fillimisht midis grave përmes grimcave të dyshimit dhe shikimit të filxhanëve, pastaj vjen një ditë që dielli nuk mund të mbulohet me shoshë. “S’ka më flamuj sovjetikë. S’dëgjohen më këngë ruse.” (f.560)

Përmasat e dramave familjare bëhen tronditëse sepse barra kryesore vihet mbi shpatullat e brishta të grave, e shprehur në fjalët e Nadja Gracovës, bashkëshortes së Rudianit: “Jemi të pambrojtura midis kthetrave të tyre... Do të na shqyejnë.” (f.562)

Që në titullin e figurshëm të veprës autori e ka bërë këtë veçim, por do ta rimarrë në fjalët që vendos në gojën e diplomatit të parë: “Kjo botë që ne e quajmë Lindje dhe me të drejtë quhet mbretëria e së keqes dhe e mërzisë, ka një thesar që ende nuk njihet: gratë.” (f.552) Duke qenë student në Moskë, duke njohur vajzat ruse diplomati bëhet zëdhënës i Kadaresë dhe metafora e sorkadhes shpreh jo vetëm delikatesë, por edhe dhimbshuri për fatin e tyre tragjik.

Ndryshe nga romani “Dimri i vetmisë së madhe”, këtu tregohet represioni e shtetit ndaj të vetëve dhe shtetasve të huaj, duke krijuar një hapësirë që sa vjen e shtohet, madje ftohet për të hyrë në lojë edhe “Pallati i ëndrrave” me fjalët e shefit të kundërzbulimit: “Dyshoj se po fillon ajo që i trembem më shumë: zona e errët e paranojës.” (f.572)

Sofika e filxhanëve, dhe jo vetëm, futet në mekanizmin e egër të zbulimit të kompleteve për vrasjen e udhëheqësit. Qytetarët e zakonshëm dhe ata të piramidës së lartë të shtetit përfundojnë në hetuesi, ulen në fron me peshën e fajësisë vetjake të paracaktuar, por duhet medoemos të tregojnë dhe bashkëpunëtorët. Në një mbledhje në ministri, një nëpunës i lartë thotë: “Autokritika e shokut ministër është e pamjaftueshme. Thellohu, shoku ministër. Lehtëso veten. Ndhimjoje Partinë.” (f.580) Janë formulime të njohura tashmë që kanë dalë në dritë pas hapjes së pjesshme të arkivave.

Një karakter mjaft i realizuar, edhe pse në plan të dytë, është Blendi, vëllai i Arianit, që bëhet mik i vërtetë për Ljubën, me atë inskenimin e errësirës për të parë RAI-n dhe me deklaratën e

rezikshme: “Shqipëria do të bëhet vend perëndimor.” (f.532) Figura e tij merr një përndritje të re duke i dalë për zot Ljubës në çastin e arrestimit. “S’e prekni dot! Jam kunati i saj.” (f.581)

Tension të lartë dhe intesitet të veçantë, frymëmarrje të pezullit kanë orët e largimit të Ljubës drejt aeroportit; as hipja në avion nuk mjafton për të shpëtuar nga hetuesia dhe burgu.

Natyra e kësaj zgjedhjeje e kufizon ndërhyrjen e autorit, por ai është romancier dhe, ashtu si në jetë dhe në krijimtari, i thyen trinat kufizuese për të bërë atë që e ndjen së brendshmi dhe s’mund ta mbajë vetëm për vete. Kur Ljuba paraqitet për të filluar punë në uzinë, ajo bëhet pre e “vështirimit dyshimtar-kureshtar-epshor të shefit të kuadrit.” (f.527) Ka një prezantim të pazakonshëm të një personazhi në sfond: “pusht Lfteri, horri i njohur i uzinës.” (f.529) Një ndalesë më të gjatë si autor bën te tabloja e gjahut: “Si një tufë sorkadhes të kapura në një rrjetë-kurth, ato ia kaluan njëra-tjetrës panikun, ndërsa rendnin sa në një drejtim në tjetrin, për t’i shpëtuar rrethimit. Kështu provonin të gjenin një të çarë, një dalje nga ajo rrethojë, nëpër porta ambasdash të ndryshme: çeke, hungareze, polake, rumune, e sidomos sovjetike. Por pengesat ishin kudo... (f.562)

Prej vitit 2019 është shkruar për një film ruso-shqiptar që merrte shtysë nga ky skenar.

E vendosur në fund Veprës 20, e paraprirë nga dy refleksionet e gjata “Nga një dhjetor në tjetrin” dhe “Pesha e kryqit”, vepra ka fatin e madh të ketë një parathënie të gjatë nga vetë autori.



N.E: Duke qenë se ne në Maqedoni jemi rritur me “atdhe të munguar”, a mendoni se kjo na ka bërë që Shqipërinë ta shohim gjithmonë me një lloj idealizmi?

L.O.: Mund ta hidhni si raport për shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë nga situata e qasjes historike, por çka keni në përmbajtje të konceptit të idealeve?! Apo çka shohin ideale shqiptarët brenda kufijve të Shqipërisë?

N.E: Sigurisht, kur fillojmë të krijojmë ne nuk e dimë se çfarë rrjedhe do të marrë vepra që po zhvillojmë, por më pas është përgjegjësia që na jepet për atë që kemi krijuar. Në rastin tuaj, pesha e kësaj veprë është ditur që në momentin e krijimit të saj. Por, a e mban mend çastin kur ju lindi ideja e krijimit të kësaj grafike?

L.O.: Koha kur e kam krijuar këtë grafikë, nuk ka qenë aspak e lehtë. E them aspak e lehtë, duke përfshirë këtu shumë rrethana në të cilat ndodheshim atëherë. Pra, ishte koha e protestave në Kosovë, viti 2012. Pastaj, në atë kohë z. Albin Kurti kishte takim me intelektualët shqiptarë në Maqedoni. Kaluam nëpër sheshin e qytetit të Shkupit, ndaj u ndalëm te shtatorja e Skënderbeut. Ishte momenti kur ajo shtatore dha një reflektim ideal për një artist kur sheh kuadro të ndryshme nga ajo që e rrethon dhe fotografia ta jep shumë qartë faktin në heshtje. Nga ajo shkrepje e momentit të figurës së Skënderbeut në Shkup lindi koncepti për ta trajtuar edhe në grafikë e dizajn. Më pas filloi të marrë rrugën e vet gjatë trajtimit me kohën.

N.E: Veprën në fjalë a e prezentuat menjëherë në publik, apo i dhatë kohë përpara se ta shfaqni?

Luran Osmani, autori i grafikës:

NË NJË ÇAST MEDITIMI TE SHTATORJA E SKËNDERBEUT NË SHKUP, LINDI KJO GRAFIKË

Bisedoi Nurie Emrullai

Artisti ka rol kyç në shoqëri sepse atij i duhet të mbajë gjallë kujtesën historike. Përcjellja e vlerave kombëtare duhet të jetë dhe interesi kryesor në ditët e sotme. Ndonëse arti merr suaza të ndryshme, në varësi të vendit që krijohet, ne si shqiptarë duhet të jemi me këmbë në tokë, të vetëdijshëm për historinë që përfaqësojmë. Për këtë biseduam me Luran Osmanin, njërin nga këta artistë, i cili ka mbetur deri më tani, fytyra anonime që fshihet pas realizimit të grafikës së Skënderbeut.

L.O.: Jo, sigurisht që nuk e prezentova menjëherë. Madje mendoj se vepra e puna e bërë me trajtesën e sinjeritetin e duhur e tregon vetë momentin e kohës së shfaqjes sepse është si moment çlirimi, ekspozimi dhe ai moment ndodhi në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Për mua një rishikim në trajtesë historike dhe gjesti im modest për respektimin e vlerave tona historike nga fusha ime si artist.

N.E: Thonë që artistët vijnë me vonesë. Pra, nuk i takojnë kohës ku jetojnë. As nuk i marrin lavdet në kohën që veprojnë. Artisti ndonëse shikon realitetin e kohës, koha nuk e lejon që t'i pranohet kjo e vërtetë. Ju, Luran, si e ndjeni veten si artist në vendin ku jetoni e veprojnë?


L.O.: Të jetosh si artist kur e sheh se has në shumë forma të okupimit në vendin tënd, ke përplasje, domosdo je i distancuar prej institucioneve, të



mungon përkrahja që duhet ta kesh. Por, të jesh i shtypur, nuk do të thotë që duhet të jesh edhe i nënshtuar. Pa i marrë parasysh rrethanat, artisti ia del në jetë sepse ai jeton me vërtetësinë e jetës. Artisti i mirëfilltë e do punën dhe e krijon, pavarësisht të gjitha barrierave të cilat shpesh herë dhe nuk janë aspak të lehta.

N.E: Me sa e di unë, vepra në fjalë është shpërndarë shumë, është shumëfishuar, madje shumë njerëz edhe e bëjnë tatuazh. Ndaj, po pyes, sa përkrahje emocionale keni nga njerëzit që e vlerësojnë punën tuaj?

L.O.: Kjo është magjia e artit, vepra është pëlqyer, është shpërndarë shumë edhe është kopjuar nga institucione komunale pa lejen apo dijeninë time dhe kjo nuk ka qenë aspak e hijshme dhe profesionale nga ana e tyre, aq më keq kur je institucion. Por, Skënderbeu nuk është i imi, është i yni dhe qëllimi



është të mos harrohet, të mbahet gjallë në një formë a një tjetër. Ndërsa, sa i takon kthimit të grafikës në tatuazh, nuk mund të jem i sigurt se sa njerëz e kanë përjetësuar në trup, por nuk janë të paktë ata që më dërgojnë fotografi çasti të tatuazhit të tyre dhe kjo më bën që ta rikujtoj faktin se fusha e artit në këto kohëra ku humb kuptimi i vlerave dhe zëvendësimi i saj me jo vlera, duhet ta mbajë qëndrimin e duhur sepse arti na ka treguar në histori të njerëzimit se është ushqimi më se i nevojshëm.

N.E: Për këtë dizajn a mund të thuash se është më i miri që ke realizuar deri tani?

L.O.: Nuk mund të them nëse është më i miri në realizim, por mund të them që është dizajni më me vlerë që kam bërë duke u nisur nga shumë aspekte, si historike, kulturore dhe kohore por, mendoj se gjurmët do të mbesin, se e tillë është vetë historia që mban.

N.E: Ndoshta është një pyetje jo shumë e preferuar për artistët, por çfarë pret një artist nga arti që krijon?

L.O.: Nuk mund as nuk dua të pres gjë. Nuk do të bëja art asnjëherë nëse do të kisha menduar për përfitimet që mund t'i kem, por çka bëjmë ne për artin apo në emër të artit? Këtu kemi shumë gabime. Ne duhet ta kuptojmë si artistë, se fusha e artit duhet të jetë reflektim i realitetit, e jo instrument i fushave tjera. Të kontribuojë në ngritje të vlerave, gjërat duhen të jenë të definuara në funksionin e rolit që kanë apo që duhet të kenë, e jo në qasje të interesave grupore personale. Mënyra si funksionojnë ministritë e kulturës në raport me fushat e artit e kanë polarizuar politikisht gjendjen artistike dhe kështu arti humb rolin dhe kuptimin, e kjo e bën që rrethet artistike të mos jenë në lidhshmëri funksionale... Me fajësime nuk arrihet në ndonjë zgjidhje, por mendoj që të gjithë të jemi së pari vetëkritikë në raport me shumë probleme dhe të paktën mos të mohojmë e arsyetojmë gabimet. Arti për mua është thjeshtë dëshirë dhe sakrificë, sidomos në një vend ku nuk vlerësohet arti e ku mungon avangarda. Artisti nuk duhet t'i takojë asnjë partie politike, duhet të jetë i lirë...

N.E: Çfarë do kishit dashur ju të jetë ndryshe në shoqërinë tonë?

L.O.: Për mua ndryshimi është proces. Gjërat nuk mund të ndryshojnë brenda një gjenerate, sepse çdo ndryshim është proces i cili kalon jetët njerëzore. I rëndë është fakti se ne kemi tri Akademi Shkencore, por kemi mungesë të librave profesional. Këto janë mangësi që duhet zhbërë sa më parë. Por nëse duam të dimë ku është çelsi i suksesit, sigurisht që vetëm puna dhe përkushtimi janë ata që bëjnë dallimin. Nuk duhet gënjyer veten në forma të tjera.

Tetovë, ditën e 555 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut
17 janar 2023

Pasi iu rikthye pronarëve të ligjshëm, shtëpinë e Doktor Dajtit, siç e quanin ende tiranasit e vjetër, e mori me qira një shoqëri sigurimesh. E ndërtuar në kohë të mbretërisë dhe e shpronësuar fill pas luftës, shtëpia e doktorit kish shërbyer si zyra për institucione të ndryshme, njëzet e shtatë vjetët e fundit për të përditshmen e dytë më të madhe në vend. Gazeta u shpërngul në një apartament të ngushtë parafabrikat, diku te tregu elektrik, në rrekte me mbijetue si e pavarur, pa i shkuar ndër mend se bash kjo përpjekje do ta rrenonte përfundimisht: të gjithë ata që mund t'ia jepnin dorën, ia kthyen shpinën. Shoqëria e sigurimeve i riparoi zyrat nga e para, i suvatoi e i leu, vuri dyer të reja dhe dritare me xham të dyfishtë, nëpër balkone vari mbajtëse me hekura të kthyer, për vazh me lule. Çudi si ka shpëtuar kjo ndërtesë pa marrë flakë, me tërë këto lidhje e tela të kalbur, tundi kryet inxhinieri që drejtoi punimet elektrike.

Zonja Dalmata S., që merrej me marketingun, hyri në zyrën flakë të re dhe çeli dritaren. Sikur vjen era duhan, tha. Mbështeti gjoksin mbi parvaz dhe zgjati qafën përjashta. Njëzet e katër mimoza, në rresht për një, shpupurisnin kokat e verdha mbi trotuar. Gjinjtë e saj e ndien erëmirën e tyre, që u turr brenda me ajrin e bormë të shkurtit. Po zhduken mimozat në Tiranë, mblodhi buzët Dalmata S., kanë qenë pjesë e identitetit të qytetit. Mbjellin gjithfarë drurësh që kushtojnë sa dreqi, mimoza jo. U kthye te shkrimorja, duke kënduar nën zë një këngë të viteve shtatëdhjetë *Ku ta gjej mimosën, vallë ku ta gjej/ Ajo çel veçse një herë...* E kam nga mamaja, ajo e këndon, sidomos kur gatuan. Uf, u ndal papritmas, përnjëmend këtu vjen era duhan. Mos kanë hapur ndonjë klub duhanxhinjësh përfund nesh?

Bar-kafeja më e afërt ishte ndonja njëqind metra më tej, matanë barnatores *Topuzi*. Ja, tha, këtu është një shtëllungë tymi. E shikoni?

- Mos qenke shtatzanë, moj vajzë, ndien erë ku s'ka.

Drejtoresha e personelit i shqiptoi këto fjalë butësisht, me dorën te supi i saj. I kish marrë zyrat me rend, duke i uruar punonjësit, si po ju duket, keni nevojë për ndonjë send.

- Syri besoj nuk mund të jetë shtatzanë, tha Dalmata S. Ja, nuk është lëpë tymi kjo që është ngulur lart, në tavan? Këqyre ç'formë ka marrë, si fytyrë burri.

I gdhendur nga një dorë e fshehtë në shtëllungën e krehur të tymit, një burrë me kasketë herë hollohej e mekej, herë spikatte me tipare të thekshme, si në gur. Portreti i tymtë shkeli syrin dhe qiti gjuhën, por këtë Dalmata S. nuk ia tha kujt.

Në derë ia behu pastruesja me një teknik kondicionerësh, që se ç'deshi me këqyrë dhe vari kryet te dritarja. Sa shpejt qenkeni dendur me duhan, tha pasi mbaroi punë, duke marrë erë me ndërpreje. Do ta thithin perdet e muret, s'ka zot që e heq pastaj. Po kësaj i bën gjë kondicioneri? Drejtoresha e personelit bëri shenjë nga lëmshi i mbledhur duq mbi krye, në qiellzanë. Qenka si skulpturë në shkëmb, tha tekniku dhe shtypi telekomandën. E qëron ky fët e fët.

Një gjysmë ore më vonë tymi prapë njësoj, i lidhur në qiellzanë si rrëshem blete. Nuk qe shprishur as holluar, ani pse kondicioneri punonte vu e vu. Njeriu me kasketë brenda shtëllungës lëshonte mjekër ose zbulonte tullën, sipas rastit, tërë ditën e lume pa u zhbërë.

Kush ka punuar në këtë zyrë, moj bijë, tha pastruesja me kryet ulur, duke lënë me kuptue një mendim të pathënë. E pëshpëriti pyetjen, sikur fliste vetmevete. E njoh unë, tha shoferi i drejtorit, që u dha në derë me një zarf me shumë vula në dorë. Këtu ka qenë zyra e Bejto Syçit. Më kërkonte ndonjë ndihmë të vogël për motorin, kam qenë shofer në komunale, ja aty, matanë

KTHIMI I GJENERALIT

Tregim nga
Mehmet Elezi



farmacisë *Topuzi* ka qenë komunalja. Mbanim kasketa të ngjashme.

Para se me u ngritë në përgjegjësi në Tiranë, si shef i redaksisë së informacionit në të përditshmen e dytë më të madhe në vend, Bejto Syçi kish qenë mësues fshati dhe korrespondent vullnetar, më pas korrespondent zyrtar për katër rrethe jugore. Me çizme lëkure e pantallona me kilota si oficerët, binte në sy qysh larg. Edhe xhaketën e qepte si ushtarakët, me xhepa jashtë. Me të njëjtin stof të errët si xhaketa, kasketa qe disi e veçantë, rrumbullake, me strehë përpara. Nuk e hiqte kurrë. Sa herë ulej e zbriste nga motori, nën xhaketë zgjatej e fshihej përrëshqit një tytë e zezë metalike. Revolen *parabel*, prodhim i hershëm gjerman, s'e ndante prej vetes.

Kasketat njësoj i kishim, por jo gradat, qeshi shoferi i drejtorit. Atij i thërrisnin *gjeneral*.

- Kish qenë ushtarak?

- Jo, ç'ne. Veshja. Dhe koburja e madhe, si këmbë lope. Burrë i këndshëm, s'i bënte keq kujt.

Kur i thërrisnin *gjeneral*, Bejto Syçi nxirrte parzmin përpara, tundte kryet dhe rrotullonte sytë e rrumbullakët gjithë qejf, sikur donte me u shfaqësue e po ç'të bëjmë tashti, kështu po më thonë. Gjithmonë me një cigare në buzë, me një tjetër në vesh të gatshme me e ndezë dhe një të tretë në dorë, duke e dredhur. I mbështillte cigaret me ndihmën e një kutie metalike. Zyra e tij terrohej prej një reje të përhimët, të lidhur nyje, hapi sa të duash dritaret. Mos mendo se do të bëhesh mbret, i thoshte Dyrrri, korektori i vjetër, i njohur për guajtjet e holla. Vetëm Ahmet Zogu pinte njëqind cigare në ditë, si ti. Bejto Syçi rrotullonte sytë me kënaqësi e qortim. Jo, faleminderit. Me mbretin s'kemi punë, ka vdekur me kohë. Më mjafton *gjenerali*, qeshte. Vdekjen e mbretit e shqiptonte qartazi.

Shpesh fluturonte vetë i dytë mbi motor. Kish ndonjë shok ose të njohur, nuk përtonte me iu gjetë për ndonjë hall. Vetëm një herë e kishin parë me një hije të hollë pas vetes. Motori shkonte plumb nëpër muzg, në rrugën e plazhit të vjetër, nën degë pishash. Hija e ulur mbrapa kish flokë të gjatë. Flokët e gjatë të hijes mbrapa i merrte era. Herë lëshonin fishkëllimë pishnaje, herë përcillnin ushtimë të largët deti. Shpërhapnin erandë halash të thata dhe bari të njomë.

- E hëngri kot i ziu, tha shoferi i drejtorit, pasi qe harruar tymnaja mbi kokën e hijshme të Dalmata S., në zyrën e marketingut. Jo për

mustaqet e Çelos. Për mustaqet e qepës!

Shoferi i drejtorit tha se kishte një marrëveshje xhentëlmenësh ndërmjet gazetarëve, kur lavdërohej nga lart ndonjë shkrim, autori qeraste me kafe. Dhe atë ditë Bejto Syçi pati arsye me i ftue shokët për kafe. Jo vetëm kafe, është rasti të *mobilizohemi*. Pa tjetër, tha Bejto Syçi buzëgaz, duke hapur duart e shtrira me shuplakat kthyer dhe duke rrotulluar sytë e rrumbullakët. *Mobilizimi* qe zhargon, nënkuptonte një a dy gota fernet ose konjak *Skenderbeg* për secilin, bashkë me kafën. Fernetin e hidhnin në gota arançate, mos me u marrë vesh se gazetarët pinë, aq më keq në orar të punës. Gazeta qe lavdëruar atë mëngjes për shkrimin e Bejto Syçit. Vetë kryeministri e kish përmendur në një takim. Dhe kurrkush s'e priste, qe një vëzhgim i vockël, faqosur në cep, mezi vihej re. Me një titull si mahi: *Ku qepa, ku tigani!* Në qytetin Gj. kujdesi për shërbimet ndaj familjeve duhen shtuar. Shitoret e perimeve janë të rralla, amvisat duhet të vrapojnë njëzet minuta të mira për të blerë një qepë, ndërkohë që kanë vënë tiganin në zjarr. Kaq.

Mobilizimi me gota të mëdha arançate qe në kulmin e vet, kur te dera u dha Alekoja astmatik, që rrinte në paradhomë të kryeredaktorit. Eja një cikë, *gjeneral*, tha gishti i tij në trajtë grepi të verdhë. Sa herë shfaqej Alekoja dihej, kërkon shefi i madh për diçka të madhe. Ndonjë telefonatë tjetër? Po të presim këtu, shkallë e re *mobilizimi*. Zërat e kolegëve, të ngrohur nga alkooli, qenë bërë më tingëllues. Ta kemi ndjellë, do të bëhesh gjeneral përnjëmend. Domethënë i madh. Hej, mos na harro kur të bëhesh ministër.

Bejto Syçi ndjeu një farë mpirjeje, ftohje në parzëm. E përmbysi një parandjenjë e akullt.

Vërtet paskesh qenë një telefonatë tjetër.

Ndërsa dihatte duke ngjitur shkallët e redaksisë, gazmendi i kolegëve te bari u mek e u mbulua me hi, mbi fjalë breroi brymë, pa e kuptuar pse. Ç'është ky shkrim, ky zotëria dashka që për dy koqe qepë të hapim dyqan në çdo oborr?, paskesh thënë udhëheqësi. Dyqanet nuk prodhojnë të mira materiale. Shitësi i merr shoqërisë, paguhet prej saj, nuk i jep. Pse, kapitalizëm do ta bëjmë?

Dhe Bejto Syçi nuk u pa kurrë më në atë zyrë. Deri atë ditë që u kthye papritmas, mbështjellë me renë e tij të tymit të duhanit. Në qiellzanë, mbi kryet e bukurshes Dalmata Sh., që erëmonte lule mimoze.

Tiranë, 17 nëntor 2019

Në të gjitha stinët, veçanërisht në vjeshtë, kur në muzg nis të bjerë shi, dal dhe eci rrugëve të Tiranës. Sapo ndjej pikat e para të shiut në dritare, vishem, zbres me nxitim shkallët e katit të fundit të pallatit ku banoj, eci ngadalë në trotuarin e rrugës, nën rrapet, tashmë të rritur dhe pasi ndjej që më janë qullur flokët e supet, vetëm atëhere hap çadrën. Kam dëshirë që ta ndjej mirë në trup shiun e Tiranës... Me pëlqen edhe kur bije i qetë, edhe i vrullshëm apo shoqëruar me erëra. Dimrit, kur nata vjen shpejt dhe bije shi, nxitoj të dal në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”. Mrekullohem me shiun që bije nën kurorën e pishave dhe pasi kaloj urën e madhe të Lanës, eci pranë godinës së Kryeministrit e më pas te hotel “Rogneri”, kapërcej rrugën e dal në trotuarin pranë Presidencës, te Akademia e Arteve, Garda e Republikës e pastaj qëndroj buzë liqenit, duke parë shiun që bije mbi të. Kur vjen pranvera dhe shirat janë të shpeshta, kaloj në rrugën e Elbasanit dhe ngjitem rrugës që të çon te Gjeologjiku. Atje eci ngadalë, shumë ngadalë, pa çadër, ndërsa shiu bie i qetë mbi selvitë, që lëkundën lehtë-lehtë, duke lëshuar ca si ofshama qiellore...O Zot, them me vete. O Zot. Ç’janë këto ofshama apo zëra shpirtërash? Dhe më duket sikur nga hapësira mbi selvitë e qullura nga shirat e natës, po zbresin shpirtrat e të afërmve të mi apo miqve e shokëve që kanë ikur nga kjo botë...

Kam vite e vite miqësi me shirat e Tiranës, por ajo që më ndodhi mbrëmjen e vonë të fundvjeshtës së parë, nuk do ta harroj kurrë. Kishte më shumë se dy javë që nuk binte shi dhe e kisha ndërë aq shumë mungesën e tij, sa që u gëzova si fëmijë, kur nga ballkoni pashë pikat e para të tij, që trokitën në xhama.

U vesham me nxitim dhe zbrita me shpejtësi poshtë dhe pas pak dola në rrugën e Dibrës... Do të dal në Sheshin Qendror dhe pasi të qëndroj në gungën e tij, do të kaloj në mesin e Rrugës së Kavajës, mendova. Do ta shijoj atje shiun e vonuar të vjeshtës së parë, thashë gati me zë, që bije nën kurorat e kumbullave të kuqe. Po lagesha mirë dhe në momentin që u bëra gati të hapja çadrën, vura re siluetën e një gruaje të gjatë, që ecte ngadalë në trotuar, para se Rruga e Dibrës të kryqëzohej me atë të Barrikadave ose më saktë rrugicën “Sokaku i të marrëve”. Paksia e kërrusur, me një çantë që e mbante nën sqetull, hapat e saj ishin aq të ngadalta, sa që dukej sikur i vinte keq për pllakat që shkelte. Ju afrova dhe e futa në çadër. I thashë se binte shumë shi e se moti ishte freskuar dhe mund të merrte ndonjë ftomë. Vura re që nuk reagoi nga fjalët që i thashë dhe vazhdoi me të njëjtën ecje të lehtë e delikate. Edhe kur u ulëm përballë njeri-tjetrit në ca kolltukë të rëndë e të lartë, ajo qëndroi e heshtur, me një vështrim të përhumur, sikur shihte në boshllëk. Vura re që kur u ul, m’u duk pa eshtra. Krejt pa eshtra. Fytyra e zbehtë, me një ngjyrë prej meiti, sytë e thellë e të trishtuar, krahët e gjatë dhe gishterinjtë gjithashtu të gjatë e të hollë, me ca thonj të tejzgatur dhe gjithçka tjetër e saj, ishin pa eshtra.

Kamarjeri solli kafenë, që ajo e piu menjëherë, si e babzitur, sikur kishte kohë pa e vënë në gojë lëngun e zi...Pastaj hodhi vështrimin përreth, si të shihte në boshllëk dhe seç tha nën zë.

-Përse kaq dritë e dobët?-tha me një zë të butë, që i doli nga kraharori pa eshtra.

- Është më romantike, – thashë unë –Lokali është për të rinj. Për të rinj që dashurohen.

- Errësira nuk ka asgjë romantike, – tha ajo. -Asgjë romantike.

- Varet, - thashë unë - Ka njerëz që u pëlqen errësira ose ndriçimi i këtushëm. Edhe shiu i natës – shtova.

Ajo heshti për pak çaste e pasi m’i nguli sytë mirë, recitoi në gjuhën frënge katër vargje të Rembosë për shiun e Parisit dhe vetminë.

-Përse më solle këtu? –pyeti duke më vështruar me sytë e përhumur – Përse? Përse? Kam vite që edhe natën nuk e shuaj dritën. Më tmerron errësira. Sidomos pas asaj që më ndodhi. Edhe këto perde janë shumë të rënda. Shumë të rënda dhe e pengojnë

dritën... Përse u ulëm këtu ?

-Jashtë bie shi, – thashë - Ju ishit qullur... Jeni në moshë dhe mund të ftoheni... Nuk kishit as çadër. Apo jo ?

-Më pëlqen shiu, – tha – Më pëlqen të dal kur bije shi. Sapo ndjej pikat e para në xhamat e dritares, dal. Kur studioja në Paris, më pëlqente shiu i natës atje. Eh. Shi u Parisit...Atëhere isha e re...

Fjalët e fundit i tha disa herë, shoqëruar me ca psjerëtima të lehta, që i dilnin nga kraharori pa eshtra.

-Ju jeni shumë xhentil. Shumë i sjellshëm dhe xhentil. Sapo më patë që po ecja nëpër shi, m’u afruat me çadër... Askush nuk ma ka bërë deri tani këtë. Kam vite që dal netëve me shi. Ai më qetëson. E dini? Asnjëherë nuk jam sëmure edhe kur jam qullur e tëra... I mban mend shirat e majtë dhe rrebeshet e befta në muzgjet e Tiranës? Në një nga këto muzgje, rrebeshi i shiut më zuri para hotel “Tiranës”... Njerëzit vraponin ca me çadra e të tjerë pa çadra, por askush nuk m’u afrua për të më mbrojtur nga rrebeshi i shiut...Askush...

Ndiqja me vëmendje të folurën e saj dhe lëvizjet delikate të duarve. Me siguri, në rini duhet të ketë qenë shumë e bukur, mendova duke parë sytë blu të hapur apo gojën e vogël dhe dhëmbët, që kur fliste, dukeshin jo të vënë. Flokët i kishte prerë si të modës të viteve ’60 dhe më kujtonin aktoret e filmave francezë, që i shihja atëhere në kinema “Partizani”.

-Edhe juve ju pëlqen shiu që bije natën?

Dhe pa pritur përgjigjen time, befas u ngrit në këmbë, mori çantën që e kishte lënë në kolltukun ku ishte ulur dhe me duart që i dridheshin, e vuri mbi tavolinë. E hapi, nxori që andej syzet dhe me të njejtën dridhje të duarve i vuri ato. Hapi një nga pjesët e brendshme të çantës. U ul dhe kërkoi me ankth, duke futur druart me gishtërinjtë e gjatë.

-Ah! Sa u tremba! Sa u tremba. Thashë mos më kishin humbur...- tha e lehtësuar, duke nxjerrë një tufë me zarfa, brenda të cilave ishin letra të shkruara.

Ato i vuri mbi tavolinë, ashtu siç i nxori, rrëmujshëm. E mbylli me shumë kujdes çantën, hoqi syzet dhe tha :

Përse kjo dritë kaq e dobët?...Përse?...

Letrat e hedhura rrëmujshëm, pasi i pa një nga një, i vendosi njëra pas tjetrës, sipas një radhe që e dinte vetëm ajo. Ndoshta janë letrat e rinisë, mendoja duke parë kujdesin që tregonte në radhitjen e tyre. Ndiqja me vëmendje veprimet e saj, gishtërinjtë që mernin zarfat me letra, shoqëruar me ca fjalë që nuk i merja vesh kuptimin e tyre, herë në shqip e herë në frengjisht,që më tingëllonin si përkëdheli. Me siguri janë letrat e dashurisë së saj të hershme, mendova. Dhe kur po bëhesha gati ta pyesja, ajo pasi i mbuloi ato me pëllëmbët e duarve, afroi kokën pranë tyre dhe tha :

-Ah! Ja kështu. Kështu janë mirë. Çdo mbrëmje kur kthehem në shtëpi, pas shëtitjeve që bëj në shi, gjëja e parë që bëj nuk është heqja e rrobave të qullura, por nxjerrja e këtyre letrave nga çanta e vendosja sipas radhës mbi tavolinë.

-Janë letrat...

-Janë plot 34 të tilla djalosh, - më ndërpreu ajo. - Të gjitha i lexoj sipas muajit e vitit. Të gjitha me radhë. I lexoj nga fillimi në fund me zë. Dhe pasi lexoj të fundit, qetësohem. Vetëm kështu më zë gjumi... – shtoi.


Unë i thashë se të gjithë kujtojmë vitet e rinisë tonë, dashurinë e parë apo letërën e parë që i kemi shkruar të dashurës, se edhe brezi im para viteve ’90, shkruante letra si në romanet që lexonim e se brezi Juaj zonjë, që keni studiuar edhe në Paris, padyshim i keni të shtrenjta kujtimet e rinisë...

Ajo m’u drejtua prap me fjalën “djalosh”, ndonëse jam thuasje i thinjur, por në moshë shumë më të re se ajo.

-Djalosh xhentil. Nuk janë letra dashurie. Edhe nga ato kam në shtëpi. Shumica shkruar kur studioja në Paris. Keni qenë në Paris djalosh ? Jo në Parisin e sotëm, por në Parisin e rinisë time e kam fjalën...

-Aha- thashë jo pa habi pas fjalëve të zonjës.

-Këto letra i kam shkruar dhe i shkruaj për të vdekurit e mi djalosh. Atyre u shkruaj



unë. Kam vite që u shkruaj të vdekurve...

U drodha ngadalë dhe instiktivisht mora gotën me ujë dhe e piva menjëherë. Para meje, të vendosura pranë njera-tjetrës, si ca arkivolë të vegjël, ishin jo pak, por 34 letra. Drita e zbehtë që binte mbi to dhe gishterinjtë e gjatë të zonjës, që nisi t’i hapte më krijuan në fillim një si turbullim e më pas marramëndje. I thirra kamarjerit të më sillte një gotë tjetër ujë. Mendova të ikja nga ajo tavolinë mbuluar me letra për të vdekurit, por ndjeva dorën e majtë të zonjës mbi supin tim, ndërsa me dorën tjetër hapi zarfin e parë. -Këtë letër e kam shkruar për nënën time të ndjerë...E keto tri të tjerat...I shikon këto zarfe të verdhë me pulla të çuditshme? Janë shkruar për babain tim, që ndërroi jetë dy vite pas nënës...

Heshti për pak çaste, rregulloi syzet, që iu varën nën hundë dhe mori zarfin e rreshtit të dytë e pasi e hapi, nxori prej saj një letër nga ato të bukurshkrimit të shumë viteve më parë, e afroi pranë syzeve dhe me një zë ankues, tha :

-Sa dritë e dobët! Sa dritë e dobët!

O Zot, mendova duke parë orën.Ndoshta do të më mbajë këtu gjithë natën për të dëgjuar letrat, që ajo kishte shkruar për të vdekurit.

-Aha. Të gjeta! Të gjeta! Nuk ke ku të fshiheh. Të gjeta ! Këtë letër e kam shkruar për atë. Ja lexoje emrin e tij. E lexon djalosh xhentil? Epo si mund të lexosh në këtë dritë kaq të dobët. Afrohu të lutem që ta them në vesh!

U ngrita në këmbë dhe afrova kokën pranë saj.

- Afrohu më shumë...! Më shumë! Vepropa siç më tha zonja dhe dëgjova emrin e një mashkulli, që nuk e di pse ajo donte të ma thonte jo me zë të lartë, për të mos e dëgjuar një çift i ri në tavolinën pranë, që ishin përqafuar pa e patur mëndjen tek ne.

-Është im shoq, që ka vite larguar nga kjo jetë... Ah sa dritë e dobët...! Po të kishte më shumë dritë, do ta kisha lexuar këtë letër. E dini kur e kam shkruar? Vetëm tri ditë pas vdekjes së tim shoqi...Eh more djalosh xhentil ç’na solle në këtë lokal pa drita si në burg...

U ula dhe piva edhe një gotë tjetër me ujë. -Ku e kam çantën? Ku e kam çantën? - dëgjova zërin e saj të alarmuar.

- Ma vodhën çantën...

Djaloshi pranë tavolinës sonë, u ngrit menjëherë dhe e qetësoi zonjën duke i thënë :

Ja zonjë... Në krahun tënd të djathtë e keni.

Ajo e mori çantën, e vuri mbi tavolinë dhe futi duart pa eshtra, duke kërkuar në ndarëset e shumta brenda saj. Dhe prap u ankua për ndriçimin e dobët të lokalit.

Pashë orën. Po afronte mesnata, ndërsa jashtë shiu binte më vrullshëm. Do ta shoqëroja për në shtëpinë e saj zonjën, që u shkruante letra të vdekurve të saj, ndërsa ndiqja fytyrën e zbehtë dhe duart që kërkonin ndonjë letër tjetër brenda çantës.

Djalosh xhentil. E gjeta edhe këtë letër? E kam shkruar para një jave. Është e dhjeta letër që shkruaj për të. Dhe e dini kur e kam shkruar këtë letër të fundit djalosh xhentil? Kur ai mbushi pesë vite që ka shkruar. E kam shkruar në një dhomë hoteli, nga ku shihet deti. E shkrova për djalin tim. Për djalin e vetëm që u mbyt në detin Jon, kur anija e vogël...Në det u mbyt. Në det...Letrat për të ia shkruaj detit...Më dëgjon? Detit ja shkruaj.

Ajo heshti. U përhumur në kolltukun ku qëndronte. Ndoshta po dremiste. Kishte hapur krahët e gjatë pa eshtra dhe vështronte si në boshllëk lart. Le të dremisë, mendova. Do të paguaj dhe më pas do të largohem. Le të qëndrojë në këtë lokal me ndriçim të dobët zonja e moshuar pa eshtra, me letrat e radhitura mbi tavolinë. Do t’i lutem kamarjerit që kur të zgjohet zonja ta përcillte për në shtëpinë e saj. Ose do t’i lija lekët për taksi. Më mirë kështu, mendova. Le të shkonte me taksi zonja në shtëpinë e saj. Po ku e ka shtëpinë ajo? E takova në fund të rrugës së Dibrës, në trotuarin pranë rrugicës “Sokaku i të marrëve”, si në Gjirokastër... Ndoshta vinte nga Medreseja ose lagja e vjetër tiranase, ku akoma kishin mbetur në këmbë shtëpitë e vjetra me qerpiç. E ndërsa po bëhesha gati të ngrihesha, dëgjova zërin e zonjës pa eshtra :

-M’i mblidh të lutem letrat djalosh xhentil !

I mblodha me kujdes letrat dhe i thashë të më jepte çantën, që e mbante pranë vetes. Zonja u ngrit në këmbë me një lehtësi të çuditshme dhe po me të njejtën lehtësi, mori çantën dhe ma zgjati atë me duart e holla dhe të gjata pa eshtra.

-Vendosi këtu, – tha me zërin e butë. - Në këtë anë...

Hoqi syzet e vogla dhe me delikatesë i vuri në çantë. Unë i thashë se shiu kishte pushuar e se kishte kaluar mesnata dhe se do t’i telefonoja një taksie që ta çonte në shtëpi. -Ah, - tha ajo- Kjo është e tepër. Jeni shumë i sjellshëm dhe xhentil, djalosh. Ju falenderoj. Merci beaucoup, shtoi. Merci beaucoup.

I thashë se ishte vonë, se ndoshta shtëpinë e kishte larg e se mund t’ja niste prap shiu, se nuk kishte as çadër dhe se ...Të paktën mund të njoftoja një taksi.

-Jo, - tha ajo prerë kur dolëm jashtë – Jo.

Frynte erë dhe ndihej freskia e vjeshtës.

Dhe kur i thashë se mund të merrte çadrën time, ajo më shtrëngoi fort krahun, sikur donte të mbështetej apo të më lutej për diçka.

-Të lutem! - tha- Të lutem! Unë jetoj vetëm. Prej vitesh jetoj vetëm.Dhe pasi heshti për pak çaste, shtoi :

-Jo, Jo. Nuk jetoj vetëm. Jetoj me të vdekurit e mi. U shkruaj dhe u shkruaj atyre. Pastaj çdo natë lexoj letrat që u shkruaj atyre. Dhe qetësohem djalosh xhentil. Nuk jam vetëm – tha pasi hoqi dorën nga krahun im – Po mua kush do të më shkruaj letra kur të iki nga kjo jetë? Kush do të më shkruaj?

Shtanga nga pyetja e beftë e zonjës pa eshtra. Ajo e përsëriti disa herë pyetjen, ndërsa unë qëndroja i heshtur para saj, pa ditur se ç’përgjigje t’i jepja.

U përkula dhe i putha duart. Pastaj ajo më përqafoi dhe më falenderoi, por kërkoi edhe falje nëse më kishte mërzhitur. Dhe pasi u ndamë dhe unë po ecja me hapa të shpejtë, qëndrova dhe vështrova siluetën e saj, që lëvizte ngadalë, shumë ngadalë... Shi u nisi prap, ndërsa unë ndiqja zonjën pa eshtra, që po qulelej nga shiu i pasmesnatës i Tiranës. Qëndrova gjatë në shi, teksa nga larg, nga trotuari ku po ecte në vetminë e saj, m’u duk sikur dëgjova fjalët e zonjës pa eshtra : “Po mua kush do të më shkruaj kur të largohem nga kjo jetë ?

Kush do të më shkruaj? ...”

STINA E PESTË

Ekziston një natë e gjatë
dhe një stinë e pestë,
përtej të gjitha çudirave,
ku gatuhen ëndrrat,
që serviren në parkun e pritjes.
Sa shumë pyetje pa përgjigje...!
Si shi i rrëmbyer
mjegullojnë rrugën
e trembin zjarrin,
ku mbahen të ngrohta gjithë pendimet.
Kjo natë me dëgjimtarë,
kjo stinë e vetmuar,
digjet brenda vetes.
Të verbër kalimtarët...
Kjo stinë e pazakontë
nuk i bën dyshues,
por ekziston një natë
dhe një stinë e pestë,
ku murosën ikjet.
Shpresat janë skulptura
që zbukurojnë heshtjet,
kurse krijuesit janë të marrë,
ëndërrimtarë të pandreqshëm.

URAT E NDARJEVE

Mbaroi edhe një stinë...
Në ura mbi liqen bëhen ndarjet.
Lamtumirat janë këmbë druri të vjetra
që flenë në ujë,
për të fshehur lotët
e dy dashurive, që zgjasin njësoj
e njësoj mbarojnë
çdo vit,
në kufij të dilemës;
ku erërat, shiu e dielli
puthen me sy,
mbushen me frymë,
mes ditë-natës që ndërron
në një stinë, kur ikën
dhe tjetrës që afron...

MUNGESË...

Koha ciflos çastet me shigjetën e saj.
Të çeliktë janë krahët e sekondave që ikin.
Përsëri në qiell u ndezën yjet,
por ti je larg, më larg se ta.
Je më larg se stuhitë,
më larg se dëshira për të rigjetur frymën,
je aq larg sa sytë prej njëri-tjetrit.
Të kujtohet kur thojë se koha nuk mat largësitë...?!
Unë tani me mungesën tënde numëroj ditët
dhe falë saj, ende flas me ty.
Çdo ditë e më pak trup, më pak dritë,
më pak shpirt...

Babai e prishi shtëpinë, Nënë...

Babai e prishi shtëpinë, Nënë.
Do ndërtojë një tjetër.
Me sytë nga rruga priti
të ishte edhe ti.
Të mblidhje kujtimet;
të na mblidhje ne.
Që kur ti ke ikur,
shtëpia po tretej.
Veç malli për ty
e bënte të re.
Babai e prishi shtëpinë, Nënë.
E shkuli nga themelet.
Rrënuar kur e pashë,
mishtë m'u rrënoqeth.
Gjithë fëmijëria
më kaloi para sysh.
Nuk dija ç'të ruaja;
nuk dija ç'të fshija...
Muret rrëzoheshin
e vitet bashkë me to.
Duart e tua, Nënë,
u shembën përtokë.
Babai e prishi shtëpinë, Nënë.
Do ndërtojë të re.
Nuk di, kur ti të vish,
vallë a do ta gjeshe...?!

Stina e pestë

Poezi nga
Irena Dragoti



PËRKUFIZIMI IM

Unë jam një vijë e gjatë
që përthyer pengesave.
Krijoj kënde trishtimesh
e sërish drejt udhëtoj.
Vij nga epoka kur shkarravitej shpellave.
Kam vite që rend drejt së panjohurës.
Takohem...
Pritem...
Përthihem...
Prej shekujve vij
e drejt dritës shkoj.
Unë jam një vijë e gjatë, e pafundme
me të vetmin rregull;
Nëpër dy pika kaloj...

IKJE...

Ne jemi vetëm ikje...
në një botë,
ku takojmë,
vetëm veten tonë,
në një tjetër formë...

QYTETI U ZGJUA SËRISH

Qyteti u zgjua sërish, në çastin që u fikën neonet.
Punëtorët e pastrimit i mblodhën të gjitha.
Dhe tingullin e fundit të jehonës
të së djeshmes së zhurmshme e të largët,
mbushur me ambalazh e etiketa.
Në asfalt hodhën pak pluhur të bardhë,
si për të zhdukur mëkatet dhe gënjeshttrat.

Qyteti u zgjua sërish në gjysmëzbardhje.
Tek-tuk ndonjë bori zhurmon ajrin e athët.
Ndonjë nënë e pagjumë në ballkon përplas dyert,
teksa lulet vadit pas freskisë së natës.

Qyteti u zgjua edhe sot nga të pagjumët,
nga e lehura e ndonjë qeni, harruar pa vrarë,
qen endacak, emërtuar zyrtarisht,
që bashkisë i fshihet vetëm natën.

Qyteti u zgjua sërish nga pompat e ujit
dhe përkëdheljet e rutinës për në punë.
U zgjua nga ndonjë kros i përgjumur e i zvarrët,
për të hequr ca kilogramë më shumë.

Qyteti u zgjua sërish edhe sot
nga kënga e zogjve, si rruaza renditur mbi kënetë.
Qyteti u zgjua nga gugatja e pëllumbave në kafaz
dhe nga hapi i rëndë i turnit të tretë.

Qyteti u zgjua sërish edhe sot,
si çdo ditë, pa ndryshuar orar.
Veç ca pikave shiu,
ndryshe nga dje
disa gradë ngrohtësi më pak...

STREHA E VJETËR

Më duhet të kthehem tani
te streha e vjetër.
Të pastroj pluhurin me mëngë,
të gjej pak vend në kujtesë.
Edhe mbrapsht kur eci, jam unë
që dua të rritem.
Me të kaluarën e brishtë,
rikthehem në kohë me veten.
Është stinë e çeljeve.
I krahasova dashuritë.
Kjo ishte peshorja e harresës.
Lulet e verës çelën,
të verdha edhe këtë vit,
si atëherë, kur u takuam të dy
me dashurinë...

PRITJE ZEMRE

Të kam thënë që do të shkruaj çdo mbrëmje
e me sytë nga dera do të jem?
Do të duhet të kalosh pafund dete,
do të duhet kohë e gjatë,
kohë që tretet.
Ti e di tashmë ku je.
Unë kam humbur te vetja.
Largësitë i zvogëlon dashuria,
i bën të jetojnë dy jetë,
por unë të kam premtuar
se do të marr me vete,
në zemrën time.
Të kam jetë, shpirt.
Lotët do më vrasin ditët,
por ti do të vish shpejt.
Oqeani është i madh.
Oqeani është i thellë.
Do t'i ter ujërat që na ndajnë,
do të bëhem urë e gjatë
e një ditë do të sjell.

DILEMË...

Nuk të dua aq shumë sa mendon.
Mos beso, kur shpeshherë ta them.
Netëve jam njeriu që ti do,
por ditëve jam e gjitha një dilemë.

Jam e gjitha një enigmë e madhe pyetjesh,
përgjigjet e të cilave nuk i mora dot.
Ndaj, besomë, nuk të dua aq sa duhet.
Nuk do të dua kurrë, sa e meriton.

E di, që kurrë nuk të dhurova
aq lumturi, sa të mos mbetej asnjë shteg
e ti të më besojë se dashuria
nuk është ç'merr, por ajo çka jep.

MOS MË MBULO ME VJESHTË!

Mos më mbulo me vjeshtë!
Veç tokës i duhen gjethet.
Më të lehtë stinë që lajnë shirat,
mos ma shtro.
Nuk ecet mbi pellgje
me hapa të lagur, nuk thuren ëndrrat.
Ndaj, mos më mbulo me gjethe!
Nuk dua të fle me shtrojtë të kaftë
e as të verdhë.
Ti e di çfarë ngjyre më pëlqen
ndaj, hiqma atë çadër të trishtë.
Kërrusur s'më mban kjo stinë.
Pse duhet një hije, një pemë?!
Mos më mbulo me vjeshtë!
Më të lehtë stinë që lajnë shirat,
mos ma shtro...
Nuk ecet mbi pellgje...

Sekreti i Identitetit Tim

Dhoma është bosh,
Dritarja e hapur.

Ime Më

Ime më ishte bishtalec i një tymi të zi.
Ajo më mbarti mua, mbështjellë me pelena, mbi
qytete që digjeshin.
Qielli ishte një vend i paanë por frynte shumë
erë për lodra fëmijësh.
Aty takuam shumë të tjerë si ne. Mundoheshin
të shkonin në mëngët e palltove krahët e tyre
prej tymi.
Qielli natën, në vend të yjeve, ishte plot me veshë
të shurdhër, të veckël, të tkurur.

Mua më Vodhën Ciganët Shëtitës

Mua më vodhën ciganët shëtitës. Prindrit më
rimorën prej tyre.
Ciganët më rrëmbyen prapë. Kjo punë vazhdoi
gjatë. Një minutë unë gjendesha në karvan duke
thithur cicën e zezë të mamasë së re, minutën
tjetër rija ulur në tryezën e lartë të dhomës së
ngrënies dhe haja mëngjez me lugë argjendi.
Qëlloi dita e parë e pranverës. Njëri nga etrit e mi
këndonte në vaskë, tjetri kishte kapur një skifter
të gjallë dhe po e lyente me ngjyrat e një shpendi
tropikal.

Ne Ishim të Varfër

Ne ishim aq të varfër sa mua më duhet të zija
vendin e djathit në çarkun e miut. I vetëm në
qilar, dëgjoja të ecurat në katin e sipërm, shtriq-
jet dhe kthimet në shtrat. “Këto janë ditë terri,
ditë dreqi” më tha njëherë miu kur po më hante
veshin. Kaluan vite. Ime më mbante një jakë me
gëzof maceje të cilën e fërkonte aq shumë sa një
ditë shkëndijat i vunë flakën qilarit.

Lajm i Mirë

Gjysmës së rrugës për në askund—

Mu duk se dëgjova
Kambana kishash
I verbri tek kthesa
Më fliste në emër.

Hotel Pagjumësia

E pata për zemër atë kthinë të vogël
Dritaret i binin nga një mur tullash,
Hyrja përbri kishte një pjano.
Pak mbrëmje çdo muaj
Një plak çalamant luante pjesën
Parajsa Ime e Kaltër.

CHARLES SIMIC

Dyndja e Reve

Përktheu nga anglishtja Gëzim Basha

Poeti Amerikan, Charles Simic, i vlerësuar si njëri prej poetëve bashkëkohorë më esencialë, ka lindur në Beograd, Serbi, në vitin 1938. Në vitin 1955, emigroi në SHBA.

Simic u shqua si poet Amerikan me aksent Sllav, i aftë për evakuime semantike të papritura dhe humor ironik, ku heroi lirik e sheh veten si pjesmarrës aktiv në aktet komike të historisë. Stili i tij minimalist, i bën poezitë e tij lakonike dhe enigmatike. Është fitues i çmimeve letrare më prestigjioze të SHBA-ve, ndër të cilët Çmimin Pulitzer në poezi për librin me proza poetike, Bota nuk Soset, Bursën e Gjeniut nga Fondacioni MakArthur dhe Çmimin e Karrierës, Wallace Stevens, nga Akademia Amerikane e poezisë.

Për vitin 2007, u emërua Poet Laureat i SHBA-ve. Ka shërbyer edhe si Kancelar i Akademisë Amerikane të Poezisë, ndërkohë që për disa dekada, ka punuar si profesor i poezisë në Universitetin e New Hampshire. Simic, vlerësohet edhe si editor, përkthyes, filozof dhe eseist unikal.

Pushoi së jetuari më 9 Janar, 2023.

Të shumtën e kohës ishte fare qetësi
Merimanga e çdo dhome me pallto të trashë
E kapte mizën me një pezhishkë
Prej tymi cigaresh dhe ëndrash syhapur.
Ishte aq errët sa unë
s’shihja dot as fytyrën në pasqyrën e rojes.

Në 5 të agut dëgjoja këmbët e zbathura,
Të fallxhores “jevgë” një kat sipër meje,
Asaj që e kishte shitoren tek kthesa,
Shkonte urinonte pas një nate dashurie.
Njëherë dëgjova ngashërma fëmije.
Mu dukën aq pranë sa për një çast,
Kujtova se isha unë vetë që po qaja.

Gishti im i Madh

Gishti im i madh po nis një aventurë. “Mos,” i
luten gishtat e tjere. Përpiqen ta mbajnë ulur,

por s’mundin. Afrohet një limuzine e zezë. Një
grua fytyrë mbuluar me vel rri ulur në sediljen
e pasme, nuk ka njeri në timon. Kur limuzina
ndalet, gruaja nxjer nga çanta një palë gërshtë
të florinjta dhe frap ma pret gishtin e madh.
Nisemi për Çikago, ajo lyen buzët me gishtin tim
të prerë si të ishte buzkuq.

Një Burrë i Shëndoshë

Një burrë i shëndoshë vrapon pas saj në rrugë.
I flet në emër...i lutet të kthehet. Trasvestitja e
bukur, zezake, me një rrobdesambër klasi prej
mëndafshi të bardhë, pavarsisht dëborës mbi
trotuar, i bën vetes fresk me gazetë.
Kalimtarët ndalojnë të shohin. I dashuri kokër-
ruar, zbathur, pa këpucë, thërret për dëshmitar
Zotin.





Dyndje Resh

Ajo dukej si jeta që ne do të donim
Luleshtrydhe të egra me krem çdo mëngjez,
Drita e diellit hynte lirshëm në dhoma
Ne të dy shëtisnim, të zhveshur, buzë detit.

Prapë kishte mbrëmje kur veten e kapnim
Krejt të pasigurt për çka na priste,
Si aktorët tragjikë të teatrit në flakë,
Zogjtë bënin rrathë sipër kokave tona,
Pishat e zeza qëndronin gatitu,
Mbi çdo gur ku ne shkelnim, gjak i perëndimit.

Pastaj në tarracë rrufisnim verë
Përherë ajo shenja për fund jo të lumtur,
Re me silueta thuajse njerëzore
Dyndeshin përtej, por prape ishte bukur,
Ajri gati i dhemshur, deti krejt i qetë.

Nata binte befas, një natë e payje
Ti ndizje qiririn dhe me të, e zhveshur,
hyje në dhomë, e shuaje me frymë,
Pishat e zeza dhe barërat, gatitu.

Punët

Punët s'qene aq zi sa i bënte dikush. Një fëmijë
bukur veshur me të zeza luante me dy mollë po
aq të zeza. Nuk ishte as vajzë e veshur si djalë,
as djalë i veshur si vajzë. Sidoqoftë, dhëmbët i
kishte te vegjël, të bardhë. Peisazhi jashtë dri-
tares u pat nxirë nga një furçe e ashpër, e rëndë.
Gjithçka dukej krejt teologjike, veç çastit kur
fëmija nxirte jashtë dhëmbëve gjuhën e kuqe.

Tigri

-kujtimit të George Oppen-

Në San Françisko, atë dimër
Pashë nje shitore si kthinë e errët,
Plot me bustet e përgjumura të Budës,
Atë pasdite kur shkela aty,
Nuk doli njeri të më fliste,
Mbeta I vetëm midis kokave të mençura,
Sikur të doja t'u lexoja mendimet.

Njëra qe e stërmadhe e gdhendur në gur,

Shumë te tjera dukeshin sa nje kokë fëmije
Me njolla në ngjyren e gjakut të tharë
Kishte edhe disa të vogla si minj
Dukej sikur dëgjonin.

“Erëra të Marsit, të errëtat erëra,
Erëra kurajoze, “ pat shkruar poeti.

Kur hyri dielli rruga u zbraz
Mbeti vetëm hija ime gjatoshë
Më printe përpara si një gërshtë.
Pashë shtepinë e poetit ku njëherë i rrëfeva
Per ushtarin Rus
Me fytyrë Kinezi.

Lëngonte nga plagët në shtrat të tim eti
Një ditë kur i çova pak ujë dhe ca shkrepese,
Ai më fali nje tigërth fildishi
Egërsisht gojëhapur, larat si vija
I ishin fshirë.

Po atë natë unë ja ngjyrosa
Sytë me te zezë, gjuhën me të kuqe,
Ime më mbante një llambë sipër meje
Me ankth për fatin qe bisha e fildishte
Mund të na ndillte.

Tigri hungërinte në duart e mia
Kur të dy bashkë rinim në terr
Mbështeta veshin tek dera e poetit,
Atë pasdite, por s'ndjeva gjë.

“Erëra të Marsit, të errëtat erëra,
Erëra kurajoze, “ pat shkruar poeti.

Fermeri Plak

Fermeri plak veshur me kominoshe varet nga një
tra i plevicës si pendul. Lopët shohin anash. Gru-
aja plakë, veshur me fustanin e zi të së Dielës rri
ulur në gjunjë poshtë këmbëve të tij lëkundëse
dhe prek dheun me ballë si Muhamedanët.
Jashtë, qielli është mbushur me re si shkumë
sipër një fushe të porsa pluguar. Në fushën e
paanë nuk shihet gjë tjetër.

I Vdekuri

I vdekuri zbret nga skela. Nën sqetull mban
kokën e tij të përgjakur.

Mollët lulëzojnë. Ai mer rrugën për nga taverna

e fshatit dhe të gjithë e ndjekin me sy. Aty, ai zë
një karrige në njërën nga tavolinat dhe porositi
dy birra, një për vete dhe një për kokën. Ime më
fshin duart me përparse dhe i shërben.

Bota është kaq e qetë. Mund të dëgjosh edhe
lumin plak i cili, kur hutohet, harron dhe rrjedh
mbrapsh.

Të Gjithë e Dinë

“Të gjithë e dinë historinë time me Dr. Frojdin,”
thotë im gjysh.
“Të dy patëm rënë brenda me të njëjtat këpucë
në një vitrine dyqani.
Për fat të keq, dyqani e gjeja përherë të mbyllur.
Tabela herë lexonte, VDEKJE NË FAMILJE, herë,
KTHEHEM PAS DREKËS. Pavarësisht pritjeve të
mia të gjata, askush nuk erdhi ta hapë.
Një ditë ndesha aty Dr Frojdin i cili, fare paturpë-
sisht, me sy nga vitrina po admironte të njëjtën
pale këpucësh të zeza.Pamë nga njeri tjetri,
përpara se të iknim në drejtime të ndryshme, për
të mos u takuar më.”

Unë Jam Ushtar i Napoleonit

Unë jam ushtari i fundit i Napolonit. Thuajse dy-
qind vjet më vonë, akoma tërhiqem prej Moskës.
Anës rrugëve ka rradhë mështeknash të bardha
dhe lluca arrin mbi gju. Gruaja me një sy do të
më shesë një pulë, por unë s'kam as rroba në
trup.
Unë dhe gjermanët ecim në drejtime të kundër-
ta. Rusët, nga një krah krejt tjetër, me tundin
duart për lamtumirë. Mbaj në dorë një shpatë
ceremonish. Me të pres flokët e mi, të gjatë mbi
një metër.

Në Vitin e Katërt

Në vitin e katërt të luftës, u rishfaq Hermesit.
Ishte katandisur mos t'ja shtije as sytë! Palltua e
postierit i qe bërë leckë; minjtë i hynin në njërin
xhep dhe i dilnin nga tjetri. Kapela strehëgjere
kishte vrima plumbash. Akoma mbante atë
bastunin e famshëm me të cilin mbyllte sytë e të
vdekurve, por edhe bastuni dukej, vende vende,
i ngrënë Ti ketë lënë të vdekurit të ndukin në të?
Sido që të jetë, s'na binte më letra. “Zot i haj-
dutëve,” i bërtitëm pas shpine, kur ai u largua aq
sa s'mund të na e dëgjonte zërin.


Hyjnia e Teorisë

Ah, Hyjnia e Teorisë! Ajo s'është veçse një copë
lapsi, një copë lapsi e ngrënë, me fshirëse të
harxhuar, përfund një rradhe të gjatë gërmash
dore.

*Këto ditë u nda nga jeta në moshën 95 vjeçare
ylli i kinemasë italiane dhe botërore*

NJË GËNJESHTËR E BARDHË ME XHINA LOLOBRIXHIDËN

Nga Piro Milkani



Në vitin e dytë në Fakultetin e Filmit në Pragë u ngarkova të bëja kamerën në një film dokumentar me titull "Para se të zbardhë dita". Bëhej fjalë për ndërmarrjet dhe jetën e njerëzve që punojnë në turnin e tretë në një metropol si Praga. Shkurt ishim të detyruar të xhironim ose në muzg ose natën. Duke vendosur në parasol një filtër gri të shkallëzuar po xhironim një skenë pranë një stacioni tramvaji ku njerëzit hypnin e zbrisnin nga vagonat. Si kudo në botë, edhe në Pragë, në një skenë xhirimi nuk mungojnë asnjëherë kureshtarët që duan të dinë se ç'po ndodh. Në pritje të momentit më të volitshëm për xhirim qëndroja pranë kamerës të vendosur mbi një stativ. Një vajzë kureshtare më afrohet dhe me zë të ulët me pyet se ç'po bëjmë. I them me dy fjalë se në këtë dokumentar do fiksohen zjarrfiksat që qëndrojnë në gadishmëri, urgjecat shëndetësore, furrat e bukës etj., etj. Po nëse do të dije më shumë për këtë film eja nesër në orën shtatë të mbrëmjes po këtu dhe do t'i tregoj të tjera ndodhi kureshtare rreth filmit të ardhshëm.

Që në shikim të parë më pelqeu. Kishte flokë të zeza korb dhe me shumë kacurela, sy të bukur dhe zë të ëmbël. Pa asnjë hezitim premti se do të vinte të nesërmen në orën e caktuar dhe u largua pa e zgatur shumë.

E dija se të nesërmen nuk isha i angazhuar me xhirime dhe me mendje përpunova itinerarin që do përshkjoja me të. Pas kaq shumë vitesh që kanë kaluar nga ajo mbrëmje nuk më kujtohet se si quhej por më ka ngelur në mendje portreti i saj. Vite më vonë më kujtohej sa herë që shikoja të këndonte në televizionin italian një kënetare me flokë kacurela e të mplekusura si një mullar bari. Quhej Marcela. Kështu i thërisnin edhe vajzat shqiptare që imitonin krehjen e saj.

Nuk kaluan as pesë minuta kur e dallova që po vinte drejt meje. U përshëndetëm dhe nisëm të ecnim andej ku e kisha menduar që më parë se ku do te shkonim. Shetitja nëpër rrugët gjysmë të zbrazura të Pragës vazhdoi rreth gjysmë ore kur morëm të përpjetën e rrugicës që të çonte në kodrinë e Petrzhinës, një kodrinë e mbuluar me shkurre e pemë që qëndronte në zemër të Pragës. Ishte vendi i takimit të cifteve të reja, të cilat, për hir të së vërtetës nuk i bezdiste kush.

Muzgu tashmë kishte rënë mbi qytet dhe lampionet e gazit ishin ndezur dhe në rrugicat romantike të parkut. Deri në atë moment goja ime llafazane nuk kishte lënë gjë pa treguar, jo vetëm për filmin por edhe për vehten time. Ajo tashmë e dinte se nga isha, se në ç'vit të fakultetit studjoja, se ku banoja e

budallallëqe të tjera. Kur lamë lampionin e parë dhe po i afrohem të dytit i vura lehtësisht krahun rreth belit. Për cudi nuk kundërshtoi. Më vonë, kur lampionet filluan të rrallohen dhe të shfaqeshin zona më të errata guxova për më shumë deri sa erdhi dhe puthja e parë. Po në atë moment u prish gjithë poezia e asaj mbrëmjeje. Nga flokët e asaj vajze më goditën nuhatjen të gjithë erëzat e një gjelle pikante. Spec, hudhër e majdanos të përziejera bashkë cartallosën mukozën e nuhatjes time. Nuk mundesha. U largova me delikatesë dhe pas pak e pyeta: - Më fal, po unë nuk të pyeta se çfarë pune bën?

Jam ndihmës guzhinjere. E fillova punën në dy mbasdite dhe duhej ta linja në orën dhjetë por kur i tregova shefes se kam një takim me një kineast pa një pa dy më dha leje, po me një kusht! Do më duhet t'i tregoj nesër se si kaloi takimi i parë. Kineast pa kineast, për mua cdo gjë kishte marë fund. Nuk mund t'i afrohesha më. Po si të shpëtoja

nga kjo gjë tani që jam në mes të pyllit? Normalisht një herë në dy tre muaj i dërgoja letër prindëve të mij në Korçë. Po kohët e fundit e kisha shkelur. Duket se mamaja ishte merakosur ndaj në mëngjes më kishte ardhur një telegram nga Shqipëria. I shkurtër dhe preciz: LAJMERO SHENDETIN. GINA (lexo Xhina). Mamaja ime quhej Mangalina po shkurt, jetë e mot, e thërrisnin Gina. Shpëtimi im do të vinte nga telegrami i mamasë. Aty për aty e pyeta: A e njeh Gina (Xhina) Lolobrixhidën?

- Jekhish Maria! Po kush nuk e njeh yllin e kinemasë italiane?

- Tani do të lutem të mos bërtasësh nga habia....ti do cuditesh.... po unë jam djali i saj.

Buzëqeshi lehte dhe tundi koken si për të thënë: ç'janë këto marrëzira. Nxora nga xhepi i xhakëtës telegramin dhe ia tregova: - A është kjo që mbaj në dorë telegram?

Tundi kokën në shenjë pohimi.

- A shkruhet këtu emri im? Po këtu

poshtë a nuk është emri i saj Gina?

U hutua fare dhe deshi apo nuk deshi nuk tha po si ka mundësi? Ti je shqiptar.

Më duhej ta coja lojen deri në fund.

-Po ti nuk ke si ta kuptosh se çfarë shkruhet këtu. Ajo kërkon që unë ta marr në telefon sa më parë. Dhe unë që e humba toruan nga që kisha takim me ty. A do më japësh leje të shkoj me vrap në postën qëndrore për ta telefonuar?

- Sigurisht! Po me një kusht. T'i bësh të fala ga unë.

- Patjetër. Atëherë nesër takohemi përsëri në të njëjtën orë e në të njëjtin vend.

I putha doren dhe ja dhashë vrapit.

Të nesërmen bindur se nuk ia vlente të shkoja në takim me të qëndrova në dhomë dhe isha shtrirë duke lexuar një roman. Vashku, shoku i dhomës time, kishte shkuar në Brno të shilte nënën e tij te ve. Duhet te ishte ora shtatë e gjysmë kur dëgjoj një trokitje në derë. Hyn një shok çek, konviktor. Futet në mes të dhomës dhe fillon të tundë kokën në formë qortuese. Nuk po kuptoja asgjë ndërsa ai në heshtje vazhdonte tundjen e kokës deri sa e pyeta:

- Si është puna?...

- Mashtrues!... Don Zhuan!...

Gënjeshhtar...

- Po pse gjithë keto epitete?

E kisha vërtet seriozisht se nuk po kuptoja gjë.

- Këtu pas teje, jo më larg se tridhjetë metra, te portinerja, një kacurelse flokëzeze pyet këdo që kalon: Ju lutem a e dini dhomën e Piro Milkani, djalit të Xhina Lolobrixhides? Kisha një takim me të po nuk e kuptoj pse nuk erdhi.

Atëherë u kthellova. Më kishte dalë fare nga mendja dhe kisha harruar që ia kisha dhënë me gojën time të gjithë koordinatat. U ngrita nga shtrati u ula në gjunjë në mes të dhomës dhe me përlulësi ju betova:

-Të jap fjalën ty dhe gjithë shokëve të tjerë se nuk kam për të gënjyer kurrë asnjë vajzë. Vetëm, të lutem, më shpëto. Shko i thuaj se nuk jam në dhomë. Të lutem!

Dhe ashtu u bë. U ula pranë komodinës dhe fillova t'i shkruaj letër asaj që më shpëtoi nga një situatë e pakëndëshme, Gina Milkani. Për historinë me ndihmës guzhinjeren sigurisht nuk u shkrua as edhe një rresht. Po premtimin e mbajta. Nuk më kujtohet se kur kam trilluar ndonjë gënjeshtrë të bardhë. Apo ndoshta asnjëherë...

(Marrë nga libri "E pabesueshme, por e vërtetë", botuar nga Toena.)



Tragjedia “Macbeth,, gjithmonë na ka mahnitur me shumëplanshmërinë e vet, dhe sidomos me gjithëçka që nuk kuptohet, por ndjehet..

M’u kujtua kjo ditën e fundit të Vitit që kaloi , tek shihnja ”Macbeth,-in, në skenën e Teatrit “Globus,, dhe m’u shfaq përnjeherë ay përfytyrimi misterioz që më pushton sa herë që e lexoj veprën Shakespear-iane kur vjen skena e vrasjes së Mbretit Duncan dhe, më vonë, porositja e vrasjes së Bankos dhe të birit të tij, Fleance. Në fakt, nuk është skena e vrasjes, as ai monologue i kalimit të Macbethit nga një njeri që ka ende shkëndijen hyjnore të dashurisë dhe të mëshires, (kur ai është prapë në gjendje të thojë “the gracious Duncan,, dhe më vonë “the damnation of his taking off,,)- në një monster vrasës, dhe nuk janë as dhe vetë tre vrasësit profesionistë- është diçka tjetër-. Janë trokitjet në derë që ndjekin vrasjen e Mbretit Duncan që më mahnisin, që më shtinin një frikë të pakuptueshme adhures, por dhe një kureshtje joshëse të cilën në fillimet e leximeve nuk arrija ta kuptoja nga vinte. Tak-tak. Tak-Tak. Kush është? Kush?... (Macbeth: Who’s there? What ho! Akti i dytë, Skena e dytë; dhe më vonë po në atë vend, prapë Macbeth-Whence is that knocking?). Në skenën e tretë të Aktit të Dytë shfaqet një Portjer i cili brenda një monologu jo shumë të gjatë përsërit 12 herë fjalën- Trokit, troket, trokitje: Here’s a knocking indeed! (Knock) Knock, knock ,knock...E prapë më poshtë: Knock.Knock, knock, knock. Who’s there?.)

Është momenti kur zemra e Macbethit tkurret, ftohet, metamorfizohet; është momenti kur ai duhet të shtiret, të aktojë, të fsheh qëllimin e mrapshtë; është momenti kur Lady Macbeth është quajtur-unsexed- një qenie pa seks, pa gjini, një ish-grua që ka harruar se ka lindur grua; është momenti kur është bërë krimi i tmerrshëm dhe po porositet tek vrasësit profesionistë krimi tjetër,vrasja e Bankos dhe e të birit të tij: Bota, jeta e zakonshme njerëzore duket sikur për një çast është ndalur; çdo gjë duket sikur ka rënë të flejë ose është e përgjumur, e shushatur; vetë bota duket gati një botë ireale, një kohë kur të vdekurit mund të dalin dhe të komandojnë të gjallët. Është koha kur krimi ka pushtet mbi legjitimitetin, mbi pafajësinë; krimi që nuk ndalet para vrasjes së Mbretit Duncan (Mbreti Duncan është mbreti legjitim, është jo vetëm i pafajshëm, por dhe në të drejtën e vet; dhe po ashtu dhe miku i dikurshëm i Macbethit, Banko, dhe i biri,

Impresione nga një shfaqje e tragjedisë "Makbeth" në Teatrin Globus

TROKITJET NË DERË...

Ese nga Rudolf Marku



Fleance, -sidomos ky i fundit-që është vetë personifikimi i pafajësisë). Po të flasim me gjuhën moderne, është koha për të vrarë, është koha e shtirakëve, është koha e krimi në pushtet, është koha e urdhërave për vrasje (Macbethi, menjeherë pas vrasjes së Mbretit Duncan, i porositë dhe i urdhëron vetë, personalisht, vrasësit për vrasjen e Bankos dhe të Fleance-t, po aq lehtësisht sa ç’mund të porosiste on line njeriu modern një pica); është koha e joshjeve për të falsifikuar, për të qënë një njeri tjetër nga ai që je në të vërtetë; është koha e vrasjesve-nuk kanë rëndësi dhe aq mjetet- me thikë, me shpifje, me denigrime, me fushata, me manipulime, me kallashnikov....Nuk ka rëndësi – të djathtë, të majtë, të qendres. Shakespear, për fatin tone të keq, nuk na jep asnjë informacion për këtë.... Pikërisht kur dhe spektatorët shqiptar do të fillonin të hamensonin pozicionin majtas a djathtas të Macbeth-it, pikërisht në këtë kohë fillojnë dhe trokitjet: Tak-Tak,Tak-Tak. Kush është? Kush? (Kadare është shkrimtari i vetëm shqiptar që e ka përdorur tensionin e trokitjeve Macbethiane, përshtatur mjeshtërisht në veprën e vet).

Çfarë duan këto trokitje? Cili është kuptimi i tyre? Trokitja në derë në shfaqjen e Macbethit në Teatrin Globus është një trokitje e lehtë, por që ndjehet më qartë se gjëimi i një rrufeje, sepse është një trokitje që vjen papritur pas një heshtjeje të çuditshme, mistike, të frikëshme, diç-ndjellëse (po që askush nuk e di se çfarë është ajo që ndjell)...Tak-

tak. Kush është? ...Vetë trokitjet në derë paralajmërohen nga një sens hataje dhe njëkohësisht solemniteti...Përnjeherë pas krimi që është kryer dhe pas porosisë së krimi që do të kryhet ndodhë ajo pauzë e shkurtë, plot enigmë, që i mban shpirtat e shikuesve si të varur në një çengel hutimi, shprese (Shpresë? Çfarë shprese?).

Gjenialiteti i bardit të Madh e di se një krim gjykohet nga normaliteti i jetes,edhe atëherë kur nuk duket asnjë gjurmë e normalitetit. Ai e di se shkëndija hyjnore është e shpërndarë tek të gjithë qëniet njerëzore. Ai na paralajmëron se vrasja nuk bëhet vetëm me thikën e Macbethit. Vrasja dhe vrasësit në të kundert janë antinatyra - xhelozitë, mospranimi i tjetri, anilihimi i tjetrit,mundësisht i miqve të dikurshëm, lakmia për të marr çdo gjë që u takon të tjerëve, mashtrimi për të fituar lavdi të pameritueshme me anë të kompleksit të mëshirës, shtirja si hero burgjesh nga askushi i dikurshëm i burgjeve, apo biri që glorifikon babain spiun banal të provincës banale, falsifikimi i shkrimeve pa vlerë që i shkruan në darkë dhe në ditën e nesërme i shet si dorëshkrime burgjesh- gjithmonë në shoqërinë e një Lady Macbethi të pamunguar kurrë; urrejtja, ambicja, hakmmarrja, mpirja e kujteses-dhe, do të shtonim- njohja e varfërisë së tjetrit pa të bërë syri terx, lavdërimi spekulativ dhe i kalkuluar i gangstierit politik, eksodi i njerëzve të pashpresë, vrasja e vetë shpreses, manipulimi dhe tallja me pritshmerinë e asaj që në të vërtetë nuk do të vijë kurrë.

Dhe, menjeherë pas krimi, ja ku vjen dhe trokitja. Tak-tak.

Një trokitje që sikur vjen nga thellësitë e Ferrit, thotë portjeri që sjellë çelësat e Portës. Është ajo trokitje e vetëdijes që dukej sikur nuk ekzistonte, e asaj vetëdijes që duket sikur është asgjësuar. Është pulsimi i jetes, është pulsimi i normalitetit, është pulsimi i legjitimitetit, është pulsimi i frymëmarjes së Mbretit Duncan pas vdekjes së pabesë, por është dhe pulsimi i asaj shkëndijes hyjnore që është shpërndarë tek qënjet njerëzore, përmes zemres, përmes Mirësisë, përmes së Bukures, përmes Artit, përmes librave që shkruhen, përmes forcës së dashurisë që kokëfortësisht nuk pranon që të japë frymë...Trokitja është pauza për të na kujtuar se gjithmonë jo larg nga skena e krimi është pafajësia, është e bukura që e gjykon krimin; jo larg nga fallsifikatorët Macbethian dhe mediokër që marrin çdo çmim të mundshëm dhe çdo titull të mundshëm,- jo vetem titullin e Mbretit-pa patur as dhe një lexues të vetëm, por janë shkrimtarët dhe poetët normal që shkruajnë poezitë dhe romanet normal pa menduar për titujt dhe hosanatë, aq të desheruar prej manipulatorve mediokër!..

Tak- Tak. Kush është? Ajo trokitje të cilën e dëgjojmë çdo ditë në jeten tonë të përditshme, duke na ftuar mirësisht që ta deshifrojmë.

Ja, këto janë disa nga mendimet që më erdhën në kokë ditën e fundit të Vitit që kaloi, tek dilja nga Tetari “Globus,- buzë Tamizit që vazhdon të rrjedh qetësisht, derisa ne të mbarojmë kengën tonë!



Nëse ndihesh sikur do t'i drejtosh Ngishtin e mesit punës apo shkollës, nuk je vetëm. Pinoku, mes gjithë të tjerëve, është në anën tënde. Ai nuk pranon të shkojë në shkollë; shet librin e tij të A-B-C-së për para... Është gati të bëjë gjithçka, të përballet me çdo pasojë, madje edhe të vrasë për të shmangur barrën e jetës moderne. Shoku i tij, Lampwick, u kthye në gomar dhe vdiq nga puna e tepërt. E vërteta është se përralla origjinale mund të lexohet si një histori radikale kundër punës dhe, ka të ngjarë se edhe mund të na mësojë diçka rreth politikave të së sotshmes kundër saj.

Nëse s'është kjo gjëja e parë që ju vjen ndër mend, mund të ndodhë pasi shumë nga interpretimet bashkëkohore të përrallës së 1880 të Carlo Collinos janë zbehur nga natyra rebele e marionetës – veçanërisht animimi tradicional i *Disneyt*. Padyshim, ajo e Pinokut është një histori morale rreth një kukulle të drunjtë që bëhet djalë prej vërteti duke qenë i mirë dhe duke ndjekur rrugën që i paraqitet nga të rritur të përgjegjshëm që ai ndesh. Gjenija e Collinit ishte për t'i dhënë brezave të fëmijëve një shok *biramel* me të cilin mund të identifikoheshin kur përballeshin me botën e të rriturve dhe pritshmëritë e saj. Por kjo është veçse një pjesë e mozaikut.

Në fakt, Pinoku origjinal është gjithashtu rreth vështirësisë për t'iu përshtatur realitetit të ri të një Italie në ndryshimin e shpejtë të shekullit XIX, kohë kur pjesa më e madhe e ndryshimeve politike dhe ekonomike po riformatonin edukimin dhe punën. Ishte e thënë që njerëzit duhet t'i bashkoheshin kësaj ekonomie të re.

Si një marionetë, sikurse mund të imagjinohet, Pinoku gjithashtu kishte për të qenë pjesë, sidomos ngase ai ishte automaton¹, një objekt për t'u drejtuar nga të tjerët. Por Pinoku nuk kishte spango; kishte vullnet të lirë dhe shkolla e puna nuk ishin në krye të përparësive të tij. Kështu që, kush do ta kontrollonte. Do të qëndrojë dot?

S'ka shans! Deri në fund, Pinoku i Collodit refuzon të shkojë në shkollë apo të fillojë një punë, edhe përballë rreziqeve e belave që vijnë si pasojë. Liria dhe sjelljet e tija të fituara magjishëm veçse i dalin në rrugë për hir të rregullave të lojës. Mentorët e tij provojnë me forcë ta bindin të sillet mirë. Bulkthi që flet, për shembull, është një nga zërat kryesorë moral në përrallën e Collodit. "Pse nuk mëson së paku një zanat, që kështu të fitosh një jetë të ndershme?" e pyet pak pasi takohen. Kukulla menjëherë fillon të humbasë durimin. "Mes gjithë zanateve në botë, ka vetëm një që më përshtatet vërtetë," përgjigjet. "Ai i të ngrënit, të pirit, të fjeturit, të luajturit dhe

“Pinoku” origjinal është një histori radikale kundër punës

Nga Alessandro Delfanti

Përktheu nga anglishtja Andreas Dushi



të sorollaturit nga mëngjesi, gjer në darkë.” Teksa bulkthi këmbëngul, Pinoku menjëherë e vret me çekan.

Vizualizimi i ri mahnitës në film stop-motion² i Pinokut nga Guillermo del Toro shfaq një përrallë të errët dhe ironike, e cila duket të jetë pranë disa prej temave që Collodi thuri në roman. Si shumë nga librat për fëmijë të shekullit XIX, *Aventurat e Pinokut* është zbavitës por gjithashtu i dhunshëm, plot vdekje e fatkeqësi.

² Stop motion është një animim në të cilin përfshihet krijimi i personazheve, skenave dhe objekteve në të tillë mënyrë që të mund të lëvizin dhe mandej, fotografimin e secilës prej lëvizjeve dhe ndërldhjen e tyre në skena.

Del Toro është i vërtetë në disa nga veçanësitë e përrallës së vjetër. Për shembull, ai përdor marionetën për të folur rreth marrëdhënies atë e birë dhe e vendos historinë në Italinë fashiste, duke siguruar kështu një kontekst pis-të-zi për shfrytëzimin e Pinokut.

Çfarë mungon është ideja se puna dhe shkolla janë gjëra që Pinoku i refuzon. Përkundrazi, kukulla e del Toros duket të jetë entuziaste për punën. “Tani kemi punë për të bërë” i thotë Xhepetoja Pinokut si arsye pse nuk mund të shkonin te cirku

i sapoardhur në qytet. “Punë? E dashuroj punën!”, përgjigjet Pinoku, ndonëse, për hir të së vërtetës, ai nuk e di ku po shkon. “Papa, çfarë është puna?” shton menjëherë. Në një çast të rrallë autoritar, Xhepetoja përgjigjet “Oh, Pinok, të lutem! Mjaft me pyetje.”

Por pyetje do të lindin. Teksa përmbajtja shpaloset, Pinoku i del Toros fillon të punojë në një shfaqje marionetash dhe cirku që e punëson, dukshëm është duke shtrydhur gjithë ç'mundet nga ky yll në ngritje prej druri. Punëdhënësi bataçki po ngatërrohet aq shumë sa po i vjedh, madje, edhe pagën. Puna e tepërt, të qenurit trokë dhe mungesa e shtëpisë... Pinoku shpejt dhe pashmangshëm zhgënjehet me punën (edhe me fashizmin, por kjo është një tjetër histori).

Kjo mund t'ju ngjajë e njohur, pasi zhgënjimi me punën është sërish në qendër të politikave dhe kulturës sonë. Sërish e gjejmë veten duke u përballur me kriza ekonomike e jo vetëm. Edhe një herë, kuptimi dhe vlera e punës vendoset në pikëpyetje nga masa të tëra punëtorësh, sikurse histori të panumërta rreth *Dorëheqjes së Madhe*³ na janë thënë gjatë viteve të fundit.

Njerëzit punojnë përherë e më të pasigurt nën drejtimin e teknologjive digjitale të krijuara për të shtrydhur çdo vlerë prej tyre, dhe edhe më rrezikshëm, sikurse u vu re prej pandemisë. Edukimi është gjithashtu në krizë, me borxhet e papërmbajtshme të studentëve dhe vlerën e diplomës që bie ditë pas dite. Në këtë kontekst, tundimi për të provuar dhe shijuar një tjetër lloj jete mund veçse të ngrihet.

Në këtë sens, kohët tona nuk janë tërësisht ndryshe nga kohët kur Pinoku ka lindur. Përralla origjinale është botuar seri pas serie mes 1881 dhe 1883. Collodi e shkroi atë në epokën e ndryshimeve të stërmëdha



Pinoku sipas Enrico Mazzanti (1852-1910) - ilustratori i parë (1883) i librit “Aventurat e Pinokut”

¹ Një mjet i lëvizshëm mekanik që imiton një genie njerëzore. (Të gjitha shënimet janë të përkthyesit.)

³ Në anglisht, Great Resignation. E njohur edhe si Ikja e madhe (Big Quit), është një trend ekonomik i dorëheqjeve vullnetare të masave punëtoresh nga puna. Ka kohë që njihet, por po ndikon fuqimisht sidomos që në fillimin e vitit 2021, kur pasojat e pandemisë po ndiheshin përherë e më tepër.

për shtetin e sapolindur kombëtar italian. Duke filluar nga 1876, e Majta Historike erdhi në fuqi, një koalicion mes liberalëve dhe forcave reformiste që do të dominonte politikën italiane për dekada me radhë. Ata trashëguan një komb të ri, ta bashkuar që mbështillej nga rënie ekonomike e stërmadhe.

Për të luftuar depresionin, qeveria e Depretis-it krijoi një program reformash ekonomike dhe sociale të fokusuara te modernizimi i vendit thuajse tërësisht agrar dhe te nxitja e prodhimit industrial. Mes reformave ishte edhe ligji *Coppino* i 1877, i cili kërkonte tre vjet arsim të detyrueshëm për të gjithë fëmijët mes moshës gjashtë dhe nëntë vjeç. Shkolla u bë me detyrim.

Këto reforma nuk ishte thjesht të drejtuar nga idealet progresiste rreth qasjes në edukim – ato ishin një përgjigje konkrete ndaj nevojës së shfaqur prej industrisë për punëtorë të besueshëm. Edukimi në masë ishte i domosdoshëm për ta kthyer popullsinë rurale në një klasë punëtorësh që di shkrim e këndim, duke shtuar edhe aftësinë për t'ju shmangur ciklit të ngadaltë të fermave dhe për t'u bërë pjesë e organizatave të prodhimit industrial: të vinin në orar, t'i bindeshin urdhrave, të lexonin udhëzimet dhe të kapnin ritmin e makinerive të reja. Antonio Gramsci shkroi për “bllokun agrar-industrial” që solli kaq shumë ndryshime, fokusuar te mbajtja në ngritje e ekonomisë kapitaliste të Italisë së porsalindur.

Në këtë kontekst, përrallat e Pinokut është një prej domosdoshmërive kombëtare dhe ekonomike. Ai duhet të mësojë një zanat, duhet të gjej një punë, për kapitalin dhe vendin. Sikurse tensionet e sotshme kundër punës, refuzimi origjinal i Pinokut ishte reagimi ndaj anktheve të industrializimit të shpejtë, ndaj ciklit të shpejtë të punës mbi popullsinë rurale të Italisë, ndaj mënyrës sipas së cilës individët ishin përgjegjës për një krizë ekonomike të gjeneruar nga shkaqe që s'i kontrollonin dot. Po ashtu edhe në kohët tona, njerëzve u thuhet të investojnë në edukimin e tyre, t'i vendosin zotësitë digjitale në shërbim të korporatave *Big Tech*, të bëjnë dy punë, të marrin kredi, të ndalojnë së ankuari. Jemi në një krizë, këtu nuk ka zgjidhje.

Për një çast të shkurtër, Pinoku i Collodit thotë jo dhe në vend të kësaj, kridhet në kënaqësi të çastit. Fatkeqësisht, nuk ja del. Është një pikëvështrim i dukshëm psikanalitik këtu, që në të vërtetë është shqyrtuar nga shumë kritikë e po ashtu, interpretues të përrallës së Pinokut. Libri i Collodit ka qenë përshkruar si një histori rreth përplasjes mes kënaqësisë dhe represionit, sikurse edhe mes jetës dhe vdekjes, një përrallë epike e shndërrimeve dhe rilindjes.

Po ashtu, duke i dalë në krye



Pinoku i Guillermo del Toros

disa vlerësimeve kritike dhe riinterpretimeve bashkëkohore, është ndërgjegjësimi ai i cili, në vend që ta nxisë drejt shpëtimit, e dënon Pinokun ta braktisë lirinë e tij dhe e vendos në një trup të fituar njerëzor, fringo të ri, për të punuar. Për të, të jesh njeri është të punosh, dhe të punosh fort. Ashtu sikurse për të tjerë idnividë rebelë, mbrojtja zë vend në refuzimin e tij. Veç të mendoni Bartleby-n e Herman Melvilles dhe të tijën “Parapëlqej që jo” e cila hap pas hapi e shpie drejt vdekjes nga uria.


Pinoku qartazi është shumë i ri, naiv dhe i izoluar në një botë imagjinare post-punë ku një bashkim i lirë i prodhuesve mund të zëvendësojë mizorinë e punës nën kapitalizëm. Pas të gjithave, 140 vjet më vonë, jemi akoma duke u përleshur me këtë problem. Dhe akoma, jemi vërtetë të dënuar për ta kërkuar shpëtimin dhe emancipimin nëpërmjet punës dhe vetëm punës?

Nëse përgjigja është jo, atëherë duhet të dijmë se çdo mënyrë për të dalë jashtë këtij rebusi është e përbashkët: vetmëvete mund të gjejmë mënyrat tona për t'i rezistuar punës, por kush do t'i vërë në punë ato çka duhet për të na vijuar jeta? Për çdo Pinok që të hajë, të pijë, të flejë, të luaj dhe të sorollatet nga mëngjesi gjer' në darkë, të paktën një Xhepeto dhe një Zanë duhet të punojnë. Në thelb, punëtorë dhe gra, krejt e pritshme.

Collodi nuk ishte revolucionar dhe kurrë s'do të arrinte kaq larg. Në fund të historisë, Pinoku i tij zbutet dhe marioneta bëhet një djalë prej vërteti. Ai mund të ndryshojë përmes dashurisë për të atin, por gjithaq duke punuar dhe ruajtur para. Përmbliidhen këtu shpëtimi dhe dënimi?

Një përgjigje vjen nga kantautori italian Edoardo Bennato. Në Italinë e 1977, një tjetër vend dhe kohë e formësuar nga refuzimi i punës, ai

shkroi një koncept të tërë albumi rreth Pinokut. Në procesin e të bërurit njeri, Bennato këndon se marioneta ka *përfutur* spangot dhe ka humbur përgjithnjë lirinë e tij: “Tani nuk bën një hap nëse dikush nga sipër/ nuk të komandon dhe vë spangot për ty”.



Pinoku i Guillermo del Toros: Regjisori vështron nga ditarja e setit

SHKËLQIM ÇELA

Hotel Bahnhof



OnufriRoman